



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar

Përshtatjet vjetore e të Hyrave të Lejuara Maksimale për
FSHU, OSSH dhe OST

Përgjigjet ndaj komenteve

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

11 prill 2025



Përmbajtja

1	Hyrje.....	4
2	Procesi i përshtatjeve të rregullta dhe kompetencat e ZRrE-së	5
2.1	Përmbledhje e procesit të përshtatjeve të rregullta	5
2.2	Faktorët kryesorë që ndikuan koston e shërbimit.....	5
2.2.1	Bashkërenditja e kostove të blerjes së energjisë së vitit të kaluar	6
2.2.2	Parashikimi i kostos së importit	7
2.2.3	Kostot shtesë të shërbimeve ndihmëse.....	8
2.3	Kompetencat e ZRrE-së për tarifat.....	8
2.3.1	Detyrimi ligjor për reflektimin e kostos në tarifa.....	8
2.3.2	Masat e ndërmarra për rritjen e efikasitetit të operatorëve.....	9
3	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OST.....	10
3.1	Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve.....	10
3.2	Revidimet në kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse	12
3.3	MAR përfundimtar për OST	13
4	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OSSH	14
4.1	Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve.....	14
4.2	Revidimet në parashikimin e obligimeve ndaj OS dhe OT	15
4.3	MAR përfundimtar për OSSH	16
5	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për FSHU	18
5.1	Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve.....	18
5.2	Revidimet në parashikimin e kostove të bartshme për OST dhe OSSH.....	19
5.3	Revidimet në kostot e realizuara të imbalancave gjatë vitit 2024	20
5.4	MAR përfundimtar për FSHU	21
	Shtojca 1: Përgjigje ndaj komenteve.....	22
1	Komentet nga Qytetarët.....	23
1.1	Komente nga qytetarët në kundërshtim të rritjes së çmimit të energjisë elektrike	23
1.2	Komente nga qytetarët.....	24
1.3	Komente nga qytetarët.....	26
1.4	Komente nga qytetarët.....	29
1.5	Komente nga qytetarët.....	31
1.6	Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)	37



1.7	Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)	38
1.8	Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)	39
1.9	Komente nga qytetarët.....	39
2	Komentet nga Shoqëria Civile.....	56
2.1	Komente nga INDEP.....	56
2.2	Komente nga “Organizatat e Shoqërisë Civile”.....	67
2.3	Komente nga Green Energy Kosova.....	69
2.4	Komente nga Federata e Sindikatave të Pavarura Elektro Kosova.....	75
2.5	Komente nga Klubi i Historianëve të Kosovës	77
3	Komentet nga Institucionet e Republikës së Kosovës	78
3.1	Komente nga Presidenca e Republikës së Kosovës	78
3.2	Komente nga Ministria e Ekonomisë	85
3.3	Komente nga Zyra e Deputetit Armend Muja.....	89
4	Komentet nga ndërmarrjet energjetike.....	94
4.1	Komente nga OST.....	94
4.2	Komente nga OSSH	96
4.3	Komente nga Elektroserver	99
4.4	Komente nga FSHU	101
5	Komentet nga bizneset dhe shoqatat e bizneseve	102
5.1	Komente nga Project Office – Gjakova	102
5.2	Komente nga Lidhja e Bizneseve të Kosovës	103
5.3	Komente nga Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës	104
5.4	Komente nga ITBrooklyn Technology	105
6	Komentet nga mediat	106
7	Komentet në lidhje me procesin e liberalizimit të energjisë në Kosovë.....	108



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Përshtatjes së Rregullt të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga kompanitë e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Gjatë përshtatjeve të rregullta, ZRRE bashkërenditë ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të përcaktuesve të të Hyrave Maksimale të Lejuara të cilat mund të ndodhin për arsye që janë jashtë kontrollit të kompanive të rregulluara.

Më 14 mars 2025, ZRRE ka publikuar Raportet Konsultative për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU – KESCO). Raportet Konsultative kanë pasur për qëllim konsultimin e palëve të interesit mbi vlerësimet e ZRRE-së. Ftesës së ZRRE-së për komente i janë përgjigjur 396 qytetarë, 8 OJQ dhe Sindikata, 4 të licencuar, 4 biznese dhe përfaqësues të institucioneve të Kosovës.

Ky dokument paraqet përmbledhjen e komenteve dhe përgjigjet e ZRRE-së mbi to. Dokumenti është strukturuar si vijon:

- Kapitulli 2 ofron përmbledhje të procesit të Përshtatjeve të Rregullta, ndikuesit kryesorë të kostos së shërbimit dhe kompetencave të ZRRE;
- Kapitulli 3 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe raportin përfundimtar për OST;
- Kapitulli 4 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Raportin Përfundimtar për OSSH; dhe,
- Kapitulli 5 paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe Raportin Përfundimtar për FSHU.

Përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të palëve të interesit janë përmbledhur në Shtojcë të këtij dokumenti.

Dokumentet relevante

Rregulla për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OST	https://tinyurl.com/43jkk6nh
Rregulla për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OSSH	https://tinyurl.com/2c8ebhsj
Rregulla për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për FSHU	https://tinyurl.com/yx8av7td
Raporti Konsultativ për të Hyrat Maksimale të Lejuara të OST	https://shorturl.at/YFmbI
Raporti Konsultativ për të Hyrat Maksimale të Lejuara të OSSH	https://shorturl.at/xzgDo
Raporti Konsultativ për të Hyrat Maksimale të Lejuara të FSHU	https://shorturl.at/PPs49



2 Procesi i përshtatjeve të rregullta dhe kompetencat e ZRrE-së

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të procesit të përshtatjeve të rregullta dhe mënyrën se si këto përshtatje sigurojnë që kostot e sistemit reflektohen në hyrave maksimale të lejuara dhe tarifa. Detajet e llogaritjeve të të Hyrave Maksimale të Lejuara janë dhënë në kapitujt respektiv për Raportete Konsultative për MAR të OST, OSSH dhe FSHU.

Ky kapitull i dokumentit është strukturuar si vijon:

- Kapitulli 2.1 ofron përmbledhje të procesit të përshtatjeve të rregullta dhe ndryshimeve në mes të këtij procesi dhe shqyrtimeve periodike;
- Kapitulli 2.2 përmbledhë faktorët kryesor që kanë ndikuar në rritjen e kostos së shërbimit; dhe,
- Kapitulli 2.3 sqaron kompetencat ligjore të ZRrE-së dhe hapat që janë ndërmarrë për rritjen e efikasitetit operativ të ndërmarrjeve.

2.1 Përmbledhje e procesit të përshtatjeve të rregullta

Tarifat e energjisë në Kosovë përcaktohen gjatë proceseve të Shqyrtimeve Periodike dhe proceseve të Përshtatjeve të Rregullta. Këto dy procese janë të ndara dhe kanë qëllime të ndryshme:

- **Shqyrtimet periodike** – ndodhin çdo pesë vite dhe kanë për qëllim përcaktimin e elementeve kryesore të të hyrave maksimale të lejuara të sektorit që nuk ndryshojnë ndjeshëm në mes të viteve. Këtu përfshihen planet investive, shpenzimet operative e të mirëmbajtjes si dhe parametra të tjerë të cilët nuk ndryshojnë gjatë periudhës rregullative.
- **Përshtatjet e Rregullta** – ndodhin çdo vit dhe kanë për qëllim të bashkërendojnë ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara të komponentëve të kostove që mund të ndryshojnë ndjeshëm në mes viteve. Këtu përfshihen, për shembull, bashkërendimi i kostove të blerjes së energjisë me shumicë, vëllimeve të realizuara të energjisë, inflacionit apo kostove të tjera që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të kompanive të rregulluara.

Shqyrtimi i tanishëm i tarifave të energjisë elektrike i nënshtrohet procesit të Përshtatjeve të Rregullta. Krahasuar me Shqyrtimet Periodike, ky proces është më pak i ndërlikuar ngaqë nuk kërkon diskrecion rregullator në masën që kërkohet gjatë shqyrtimeve periodike. Rrjedhimisht, Përshtatjet e Rregullta i nënshtrohen një orari më të shkurtër të shqyrtimeve.

2.2 Faktorët kryesorë që ndikuan koston e shërbimit

Ky kapitull i Raportit Konsultativ ka për qëllim të listojë faktorët kryesorë që ndikuan në rritjen e kostos së shërbimit të energjisë elektrike. Kapitulli nuk ka për qëllim të përsërisë detajet e ofruara në Raportin Konsultativ por të ofrojë përmbledhje të faktorëve kryesorë.

Ky kapitull është strukturuar si vijon:



- Kapitulli 2.2.1 paraqet ndryshimet në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të blerjes së energjisë në vitin e kaluar;
- Kapitulli 2.2.2 paraqet parashikimin e ZRrE për kostot e lejuara të importit për vitin 2025; dhe,
- Kapitulli 2.2.3 paraqet kostot shtesë për balancimin e sistemit të energjisë elektrike.

2.2.1 Bashkërenditja e kostove të blerjes së energjisë së vitit të kaluar


Energjia e furnizuar për të mbuluar kërkesat e konsumatorëve të rregulluar të energjisë elektrike përbëhet nga energjia vendore - e ofruar kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës dhe energjia e prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) - dhe energjia e importuar.

Para çdo viti tarifor, ZRrE bën parashikimin e kostos së blerjes së energjisë me shumicë, duke marrë parasysh vëllimet e parashikuara të energjisë së ofruar nga KEK, BRE dhe energjisë së importuar. Krahas këtyre vëllimeve, kjo llogaritje parasheh edhe çmimet e energjisë nga burimet respektive, duke përfshirë edhe energjinë e importit. Kostoja e parashikuar e importit, si mesatare e ponderuar, për vitin 2024 ishte 97.79 EUR/MWh.

Në fund të çdo viti tarifor, ZRrE bën bashkërenditjen e kostos së blerjes së energjisë për vitin e kaluar tarifor. Këto llogaritje përfshijnë ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të vëllimeve të energjisë nga burimet e furnizimit dhe çmimet e shitjes së energjisë. ZRrE sigurohet që të pranohet vetëm shpenzimet e arsyeshme të të licencuarve. Në rastin e çmimeve, energjia e KEK dhe BRE furnizohet me kontrata afatgjata çmimet e të cilave nuk ndryshojnë brenda vitit. Në rastin e kostos së importit, çmimi i realizuar mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë për FSHU, që përfshinë importin e energjisë dhe kapacitetet transmetuese, ishte 181.34 EUR/MWh.

Ndryshimi në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë nga importi për FSHU në vitin e kaluar është €47.37 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifat e ardhshme të energjisë elektrike.

Figura 1 Ndryshimet në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (FSHU)




Në rastin e OSSH, kostoja e blerjes së energjisë ndikohet më ndjeshëm nga çmimet e importit ngaqë energjia për humbjet në rrjetin e OSSH mund të blihet nga prodhimet vendore vetëm atëherë kur



mbulohet tërësisht kërkesa për konsumatorët e shërbimit universal. Në rastet kur kërkesa e energjisë elektrike i tejkalon parashikimet, siç ka ndodhur për shembull në dhjetor të 2024, OSSH duhet të importojë më shumë energji elektrike ngaqë kapacitetet e KEK ngarkohen me furnizimin e shërbimit universal.

Kostoja e parashikuar e blerjes së energjisë importi për OSSH ishte 96.13 EUR/MWh ndërsa ajo e realizuar ishte 147.15 EUR/MWh. Në kombinim me ndryshimet në vëllimin e energjisë së importuar, ky dallim në çmim ka rezultuar në rritje të kostos së blerjes së energjisë nga importi për OSSH në vlerë prej €37.84 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifat e ardhshme të energjisë elektrike. Një përmbledhje e kostos së blerjes së energjisë së OSSH është dhënë në tabelën në vijim.

Figura 2 Ndryshimet në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (OSSH)




2.2.2 Parashikimi i kostos së importit

Kapitulli 2.2.1 trajton bashkërenditjen në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të vitit paraprak (2024). Përveç bashkërenditjes së kostove të vitit të kaluar tarifor, gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt, ZRRE parashikon edhe kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin e ardhshëm tarifor.

Për nga aspekti i çmimeve të importit, bazuar në trendët e çmimeve në tregje afatgjate (HUDEX), si dhe në rritjen e çmimeve ndërkufitare gjatë vitit 2024 (në krahasim me 2023), ZRRE parashikon që çmimet e importit do të jenë më të larta se parashikimet e vitit 2024, por më të ulëta se realizimet në të njëjtin vit. Njëkohësisht, dalja e blloqeve të KEK në remont gjatë vitit 2025 do të ketë ndikim në koston e blerjes së energjisë pasi që energjia që nuk furnizohet nga KEK duhet të mbulohet nga importi.

Figura 3 Parashikimi i çmimeve të importit për FSHU





2.2.3 Kostot shtesë të shërbimeve ndihmëse

Çdo sistem elektroenergjetik duhet të prokurojë rezerva të nevojshme për operim të sistemit (mirëmbajtje të frekuencës dhe tensionit të energjisë elektrike). Për shkak të kërkesave dhe vërejtjeve nga ENTSO-E lidhur me devijimet ndaj sistemit interkonektiv Evropian, rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga Shqipëria. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e parashikuara për shërbimet aFRR janë parashikuar në bazë të çmimeve të realizuara. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me Palën Ofruese të Shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MW për ngritje dhe -50 MW për zbritje.

Detyrimi për rezervën buron nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit) ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kushteve të tregut mbi të cilat ZRrE nuk ka kontrollë në pajtim me Nenin 13.2 i [Rregullave të Tregut](#).

Ndikimi i kombinuar i kostove të shërbimeve ndihmëse gjatë vitit 2024 është €24.70 milionë në krahasim me vlerën e parashikuar prej €18.17 milionë. Ndryshimi në mes të këtyre vlerave duhet të reflektohet në tarifat e energjisë elektrike.

2.3 Kompetencat e ZRrE-së për tarifat

Ky kapitull i sqaron kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe përgjegjësinë e saj për reflektimin e kostos së shërbimit në tarifat e energjisë elektrike. Kapitulli është organizuar si vijon:

- Kapitulli 2.3.1 paraqet detyrimet ligjore të ZRrE-së për të caktuar çmim që reflekton koston e shërbimit;
- Kapitulli 2.3.2 paraqet masat të cilat ZRrE i ka ndërmarrë për t'u siguruar që edhe kompanitë e rregulluara i nënshtrohen presionit të uljes së kostos së shërbimit; dhe,
- Kapitulli 2.3.3 paraqet procesin e ankimit dhe të kontestimit të vendimeve të ZRrE-së.

2.3.1 Detyrimi ligjor për reflektimin e kostos në tarifa

Kompetencat e ZRrE për tarifat e energjisë elektrike përcaktohen në [Ligjin për Rregullatorin e Energjisë \(Ligji Nr. 05/L-084 i vitit 2016\)](#).

Neni 15 i Ligjit parandalon vendosjen e tarifave që janë nën kosto të shërbimit (Neni 15.4.2):

(15.4) Në rastet kur Rregullatori rregullon çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë ai...

(4.2) siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit të çmimeve për qëllim të sigurimit të shërbimit universal ta reflektojnë koston



Për më tepër, ZRrE nuk duhet të lejojë ndër-subvencionim të tarifave në mes të grupeve të konsumatorëve (Neni 15.4.1)¹:

(4.1) siguron që kategori të ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe mbrojtje, si dhe rregullimi i çmimit të konsumit fundor të jetë në dispozicion vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Ligji parasheh mbrojtje për konsumatorët në nevojë në formë të subvencionimit të tyre, por këtë përgjegjësi ia cakton Qeverisë, përkatësisht Ministrisë përgjegjëse për mirëqenie sociale, që është në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare. Neni 50:

(3) Qeveria, përmes programit të vet të përgjithshëm për kategoritë sociale të shoqërisë adreson çështjen e kategorive sociale të konsumatorëve të energjisë. Ky program duhet të zbatohet nga Ministria përgjegjëse për Mirëqenie Sociale.

2.3.2 Masat e ndërmarra për rritjen e efikasitetit të operatorëve

Qëllimi i modelit të rregullimit ekonomik të aplikuar nga ZRrE është të nxisë kompanitë të përmirësojnë efikasitetin operativ përmes rregullimit të stimujve bazuar në performancë. Instrumentet kryesore të ZRrE-së në këtë aspekt janë faktori i efikasitetit dhe stimujt për reduktimin e humbjeve:

1. **Faktori i efikasitetit (OSSH dhe OST)** – paraqet përmirësimin e pritshëm të kompanive të rregulluara në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes – i vendosur në 1.5% për çdo vit të periudhës rregullative (1.5% zbritje e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për çdo vit në mes të 2023-2027);
2. **Caku i reduktimit të humbjeve (OSSH)** – paraqet trendin e uljes së humbjeve të lejuara mbi të cilat nuk mund të ngarkohet tarifa e rregulluar (ulje e nivelit të humbjeve të lejuara nga 15.1% në 11.1% në periudhën 2023-2027).

¹ Këto kërkesa ligjore përforcohen më tutje në Nenin 45 të Ligjit, që ndalon ndër-subvencionimet e çmimeve.



3 Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OST

Ky kapitull përmbledhë revidimet e bëra nga ZRrE gjatë procesit të konsultimit publik, si dhe propozimin final të ZRrE për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) të OST që duhet të mblidhen nga tarifat e rregulluara. MAR i reflektuar në këtë kapitull merr parasysh përgjigjet ndaj komenteve (Shih Shtojcën 1 për të gjitha përgjigjet ndaj komenteve). Gjatë procesit ZRrE ka reviduar kostot e parashikuara të humbjeve për vitin 2025, dhe kostot e shërbimeve ndihmëse për OST.

Kostot tjera të parashikuara dhe të realizuara të pranuar nga ZRRE për OST nuk kanë pësuar ndryshime nga raporti konsultativ. Arsytet për këto kosto mund ti gjeni në [Raportin Konsultativ të OST për 2025](#), si dhe sqarime shtesë në Aneks 1 – Përgjigjje ndaj komenteve.


Kapitulli është organizuar si vijon:

- Kapitulli 3.1. paraqet revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve;
- Kapitulli 3.2. paraqet revidimet në kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse;
- Kapitulli 3.3. paraqet MAR përfundimtar për OST.

3.1 Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve

Gjatë procesit konsultativ, ZRrE ka reviduar kostot e parashikuara për blerjet e humbjeve, përmes rishikimit të çmimeve në tregun për kontrata avancë HUDEX, si dhe duke rishikuar faktorin e përshtatjes për dallimet në mes të çmimeve në ALPEX dhe HUPEX. Sasitë e parashikuara të blerjeve si dhe profili i blerjeve të energjisë nga KEK dhe nga importi mbeten të pa ndryshuara.

Figura 4. Çmimet në HUDEX gjatë 28 shkurt dhe 04 prill 2025




Për parashikimin fillestar të çmimit për blerjet e OST nga importi në vitin 2025, ZRrE është mbështetur në rezultatet e ankandit në HUDEX të datës 28 shkurt 2025. ZRrE ka përditësuar këto parashikime me rezultatit e ankandit për kontrata afatgjate (muajore dhe tremujore) të datës 4 prill 2025 në HUDEX.

Vlera e përshtatjes për 9.55% gjatë raportit konsultativ është marrë në bazë të dallimeve të çmimeve mesatare mujore në mes të HUPEX dhe ALPEX nga shkurti i vitit 2023 deri në fund të shkurtit 2024.



ZRrE matë korrelacionin në mes të këtyre parametrave për këta muaj, që për periudhën në fjalë rezulton të jetë 98%. Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka reviduar vlerën prej 9.55% dhe e ka ulur në 7.06%. Kjo vlerë rrjedh si rezultat i matjes së ndryshimit në mes të mesatareve të çmimeve mujore për 24 muajt e fundit, vlera e korrelacionit në këtë rast është 97%.

Figura 5. Krahasimi i çmimeve mesatare mujore në mes të HUPEX dhe ALPEX



Pas rishikimit të këtyre dy komponentëve çmimi mesatar i parashikuar i blerjes së energjisë nga importi për OST ka rënë nga 130.67 €/MWh në 121.81 €/MWh. Çmimi mesatar i parashikuar i gjithsejtë blerjeve të energjisë ka rënë nga 105.70 €/MWh në 99.18 €/MWh. Rrjedhimisht kostot totale të parashikuara për blerjet e energjisë nga OST janë reviduar nga €13.971 milionë në €13.111 milionë. Këto të dhëna janë të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Tabela 1. Parashikimi i reviduar i kostove për humbjet e OST

OST	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
REUE _t	GWh	7,553.85	7,553.85
LSSA _t	%	1.75%	1.75%
Humbjet e lejuara totale	GWh	132.17	132.17
WHEA _t	€/MWh	105.70	99.18
Kostot e humbjeve LSSC _t	mil€	13.971	13.109

Ku:

- $LSSC_t$ është Kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t ("allowed cost of losses in Relevant Year t ")
- $LSSA_t$ janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t
- $REUE_t$ janë njësitë e energjisë (MWh) apo (GWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t
- $WHEA_t$ është mesatarja e çmimit me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t



3.2 Revidimet në kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse

Gjatë procesit të konsultimit publik, ZRrE ka kërkuar të dhëna shtesë nga OST në lidhje me të kostot e parashikuara për shërbimet ndihmëse. Në raportin konsultativ, ZRrE bazon parashikimet për shërbimet ndihmëse aFRR në bazë të çmimeve të kaluara të kontraktuara për vitin 2024. Çmimet e marra për aFRR janë 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje. ZRrE ka reviduar këto çmime duke marrë parasysh edhe çmimet për shërbime ndihmëse të vitit 2023.

Çmimet e reviduara mesatare për shërbime ndihmëse aFRR janë 41.3 €/MW për ngritje dhe 35.4 €/MW për ngritje.

Në total kosto e shërbimeve ndihmëse të parashikuara për 2025 është reviduar nga €43.12 milionë në €37.72 milionë.

Tabela 2. Parashikimi i reviduar i kostove për shërbimet ndihmëse të OST

OST	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
Shërbimet ndihmëse	mil. €	43.12	37.72



3.3 MAR përfundimtar për OST

Bazuar në ndryshimet gjatë procesit konsultativ, si dhe analizat e bëra në raportin fillestar, ZRrE propozon MAR përfundimtar për OST në vlerë €88.198 milionë (reviduar nga €94.46 milionë).

Tabela 3. Propozimi i MAR të OST/OT (KOSTT) pas përshtatjeve

Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT	Njësia	Lejuar 2024	Propozimi KOSTT (reviduar)	ZRRE 2025
Parametrat e indeksimit				
Faktori i efikasitetit	%	1.50%	1.50%	1.50%
HICP	%	2.39%		
Euribor	%	3.31%		
Norma e interesit - It	%	9.05%		
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPMct)				
Lejuar -OPMct = OPMct-1 * (1 + CPIIt-1) * (1 – Et)* (1 – Pt)	€m	8.21	7.86	7.86
Përshtatjet e mirëmbajtjes	€m			
Aktuale	€m			
Ndarja e kostove 50/50	€m			
Kostot e zhvlerësimit (DEPct) mil €				
Lejuar - DEPct = DEPct-1 * (1 + CPIIt-1) * (1 – Pt)	€m	14.56	14.49	14.49
Kostot e kthimit (RTNct)				
Lejuar - RTNct = RTNct-1 * (1 + CPIIt-1) * (1 – Pt)	€m	11.02	10.96	10.96
Kostot e humbjeve (LSSct)				
Parashikim				
LSSAt	%	1.75%	1.75%	1.75%
REUEt	GWh	7,938.0	7,552.85	7,552.85
RWMP	€/MWh	66.237	113.145	99.182
Kostoja e parashikuar e humbjeve	€m	9.201	14.955	13.109
Kostot e humbjeve aktuale (LSSct)				
Aktuale				
LSSAt	%	1.75%		
REUEt	GWh	7,430		
RWMP	€/MWh	103.79		
Kostoja e parashikuar e humbjeve	€m	13.49		
Fondi				
Parashikim mil €	€m	11.81	17.34	17.34
Aktuale	€m	7.70		
Korrigjimi i fondit t-1	€m	-4.11		
Shërbimet e ndihmëse				
Parashikim	€m	18.17	49.55	37.72
Aktuale	€m	24.7		
Përshtatjet				
Të hyrat e parregulluara				
Parashikim mil €	€m	-8.31	-8.31	-8.31
Aktuale	€m	-9.337		
Mekanizmi ITC				
Parashikim	€m	-0.397	-0.397	-0.397
Aktuale	€m	1.14		
Përshtatjet për (2022 dhe PR2)	€m	-5.42	-5.42	-5.42
KREvt = (AACat-1 – ARRt-1) * (1+ It)	€m	14.29	0.85	0.85
Përshtatjet e fondit (t-1)	€m	5.64		
Të hyrat nga interesi te faturuara për vonesë pagese				
MAR – të hyrat e lejuara maksimale	€m	78.765	101.878	88.198



4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OSSH


Ky kapitull përmbledhë propozimin final të ZRrE-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) të OSSH që duhet të mblidhen nga tarifat e rregulluara. MAR i reflektuar në këtë kapitull merr parasysh përgjigjet ndaj komenteve (Shih Shtojcën 1 për të gjitha përgjigjet ndaj komenteve). Kapitulli është organizuar si vijon:

- Kapitulli 4.1. paraqet revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve;
- Kapitulli 4.2. paraqet revidimet në parashikimin e obligimeve ndaj OS dhe OT
- Kapitulli 4.3. paraqet MAR përfundimtar për OSSH.

4.1 Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve

Gjatë procesit konsultativ ZRrE ka reviduar kostot e parashikuara për blerjet e humbjeve, përmes rishikimit të çmimeve në tregun për kontrata avancë HUDEX, si dhe duke rishikuar kostot e kapaciteteve ndërkufitare të parashikuara. Sasitë e parashikuara të blerjeve si dhe profili i blerjeve të energjisë nga KEK dhe nga importi mbeten të pa ndryshuara.

Figura 6. Çmimet në HUDEX gjatë 28 shkurt dhe 04 prill 2025




Për parashikimin fillestar të çmimit për blerjet e OST nga importi në vitin 2025, ZRrE është mbështetur në rezultatet e ankandit në HUDEX të datës 6 mars 2025. ZRrE ka përditësuar këto parashikime me rezultatit e ankandit për kontrata afatgjate (muajore dhe tremujore) të datës 4 prill 2025 në HUDEX.

Revidimet në kostot e kapaciteteve ndërkufitare

Për parashikimin e kostove të kapaciteteve ndërkufitare, ZRrE është bazuar në të dhënat mesatare të realizuara për kapacitetet ndërkufitare gjatë vitit 2024 dhe 2023. Pas procesit konsultativ, ZRrE ka vlerësuar se kostot e kapaciteteve ndërkufitare në muajin shtator 2024 ishin jashtë vlerave normale të tregut, dhe janë rishikuar duke u bazuar në interpolim linear mes muajve gusht dhe tetor 2024. ZRrE ka krahasuar këtë mesatare edhe me realizuara në vitin 2022, dhe vlerëson që mesatarja e vitit 2024 dhe 2023 paraqet vlera të prishme të kostove ndërkufitare gjatë vitit 2025.



Figura 7. Çmimet e parashikuara të kapaciteteve ndërkufitare



Pas rishikimit të këtyre dy komponentëve çmimi mesatar i parashikuar i blerjes së energjisë nga importi për OSSH ka rënë nga 147.01 €/MWh në 145.76 €/MWh. Çmimi mesatar i parashikuar i gjithsej blerjeve të energjisë ka rënë nga 96.07 €/MWh në 95.39 €/MWh. Rrjedhimisht total kostot e parashikuara për blerjet e energjisë nga OST janë reviduar nga €86.652 milionë në €86.039 milionë. Këto të dhëna janë të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Tabela 4. Parashikimi i reviduar i kostove për humbjet e OSSH

OSSH	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
REUEt	GWh	6,318.31	6,318.31
LSSAt	%	14.28%	14.28%
Humbjet e lejuara totale	GWh	902.006	902.006
WHEAt	€/MWh	111.93	95.39
Kostot e humbjeve LSSC _t	mil€	86.652	86.039

4.2 Revidimet në parashikimin e obligimeve ndaj OS dhe OT

Llogaritja e obligimeve për vitin 2025 ndaj OS dhe OT bëhet duke u bazuar në tarifat e parashikuara të OS dhe OT për distribucionin, dhe vëllimet e blerjeve të distribucionit për mbulimin e humbjeve.

Gjatë procesit konsultativ, ZRrE ka reviduar MAR për OST (Kapitulli 3), në bazë të së cilave kanë ndryshuar edhe tarifat e parashikuara të OST. Si rrjedhojë edhe obligimet e OSSH ndaj OT dhe OS, janë reviduar.

Këto ndryshime janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 5. Parashikimi i reviduar i kostove për obligimet ndaj OS dhe OT

OSSH	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
Obligimet ndaj OS dhe OT	mil. €	3.585	3.277



4.3 MAR përfundimtar për OSSH

Bazuar në ndryshimet gjatë procesit konsultativ, si dhe analizat e bëra në raportin fillestar, ZRrE propozon MAR përfundimtar për OSSH në vlerë €180.653 milionë (reviduar nga €181.574 milionë).

Tabela 6. Propozimi i MAR të OSSH (KEDS) pas përshtatjeve

Të hyrat e lejuara maksimale (mil€)	Njësia	Lejuar 2024	Propozim i OSSH 2025 (reviduar)	Propozim i ZRRE 2025
Parametrat e indeksimit				
Faktori i efikasitetit	%	1.50%		
Inflacioni - HICP	%	2.36%		
<i>Euribor</i>	%	3.31%		
Faktori - S	%	5.74%		
Norma e interesit - It	%	9.05%		
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes				
Vlerësimi gjatë PRR2	€m	27.848	27.460	21.461
OPMct = $OPMct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 - Et) * (1 - Pt)$	€m	29.376	37.36	28.155
Kostot shtesë të OPEX-it – shërbimet e veriut	€m	0.924	3.46	0.935
Kostot shtesë për OPEX – pagat minimale				0.157
Kostot e zhvlerësimit (DEPct)				
Vlerësimi gjatë PRR2	€m	19.414	21.541	21.541
Lejuar - DEPct = $DEPct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 - Pt)$	€m	20.600	22.634	22.629
Kostot e kthimit (RTNct)				
Vlerësimi gjatë MYT	€m	16.338	17.720	17.720
Lejuar - RTNct = $RTNct-1 * (1 + CPIt-1) * (1 - Pt)$	€m	17.354	18.621	18.616
Obligimet ndaj KOSTT-it				
Obligimet ndaj KOSTT-it -parashikim	€m	2.409	3.585	3.277
Obligimet ndaj KOSTT-it – aktual	€m	2.563		
Kostot e humbjeve (LSSct)				
Parashikim				
LSSAt	%	16.56%	14.28%	14.28%
REUEt	GWh	6,262.24	6,517.72	6,318.310
WHEAt	€/MWh	63.030	121.44	95.386
Kostoja e parashikuar e humbjeve	€m	65.371	97.93	86.039
Aktual				
LSSAt	%	15.78%		
REUEt	GWh	6,258.271		
WHEAt	€/MWh	98.803		
Kostoja e aktuale e humbjeve (faktori ndarës)	€m	97.574		
Përshtatjet				
Përshtatjet PRR2 (ne 2023 i përfshirë $KREV_{t-1}$)	€m	-5.408	-5.408	-5.408
Përshtatjet për 2022	€m	0.089	0.089	0.089
Të hyrat aktuale të parregulluara (KREV)	€m	-5.838		
Korrigjimet te hyrave të parregulluara 2020-2022		3.819		
Taksa e licencës:				
Parashikim	€m	0.018		
Aktual	€m			
KREV – faktori korrigjues i të hyrave				
Faktori korrigjues i të hyrave t-1				
AACT-1 - kostot aktuale për vitin t-1	€m		159.11	152.470
ARRt-1 - të hyrat aktuale për vitin t-1	€m		128.480	128.477



KREVt = (AACat-1 – ARRt-1) * (1+ It)	€m	-13.959	33.41	26.164
MAR – të hyrat e lejuara maksimale	€m	120.592	214.45	180.653



5 Të Hyrat Maksimale të Lejuara për FSHU


Ky kapitull përmbledhë propozimin final të ZRrE për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) të FSHU që duhet të mbledhen nga tarifat e rregulluara me pakicë. MAR i reflektuar në këtë kapitull merr parasysh përgjigjet ndaj komenteve (Shih Shtojcën 1 për të gjitha përgjigjet ndaj komenteve). Kapitulli është organizuar si vijon:

- Kapitulli 5.1. paraqet revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve;
- Kapitulli 5.2. paraqet revidimet në parashikimin e kostove të bartshme për OST dhe OSSH
- Kapitulli 5.3. paraqet revidimet në kostot e realizuara të imbalanceve gjatë vitit 2024
- Kapitulli 5.3. paraqet MAR përfundimtar për OSSH.

5.1 Revidimet në kostot e parashikuara të humbjeve

Gjatë procesit konsultativ ZRrE ka reviduar kostot e parashikuara për blerjet e energjisë përmes rishikimit të çmimeve në tregun për kontrata avancë HUDEX, si dhe duke rishikuar kostot e kapaciteteve ndërkufitare të parashikuara. Sasitë e parashikuara të blerjeve si dhe profili i blerjeve të energjisë nga KEK, BRE me koncesion, BRE me çmim referent dhe nga importi mbeten të pa ndryshuara.

Figura 8. Çmimet në HUDEX gjatë 28 shkurt dhe 04 prill 2025



Për parashikimin fillestar të çmimit për blerjet e FSHU nga importi në vitin 2025, ZRRE është mbështetur në rezultatet e ankandit në HUDEX të datës 06 Mars 2025. ZRRE ka përditësuar këto parashikime me rezultatin e ankandit për kontrata afatgjate (mujore dhe tremujore) të datës 04 prill 2025 në HUDEX.


Revidimet në kostot e kapaciteteve ndërkufitare

Për parashikimin e kostove të kapaciteteve ndërkufitare, ZRRE është bazuar në të dhënat mesatare të realizuara për kapacitetet ndërkufitare gjatë vitit 2024 dhe 2023. Pas procesit konsultativ, ZRRE ka vlerësuar se kostot e kapaciteteve ndërkufitare në muajin shtator 2024 ishin jashtë vlerave normale



të tregut, dhe janë rishikuar duke u bazuar në interpolim linear mes muajve gusht dhe tetor 2024. ZRrE ka krahasuar këtë mesatare edhe me realizuara në vitin 2022, dhe vlerëson që mesatarja e vitit 2024 dhe 2023 paraqet vlera të prishme të kostove ndërkufitare gjatë vitit 2025.

Figura 9. Çmimet e parashikuara të kapaciteteve ndërkufitare



Pas rishikimit të këtyre dy komponentëve çmimi mesatar i parashikuar i blerjes së energjisë nga importi për FSHU ka rënë nga 161.41 €/MWh në 161.28 €/MWh. Çmimi mesatar i parashikuar i gjithsej blerjeve të energjisë ka rënë nga 40.608 €/MWh në 40.601 €/MWh. Rrjedhimisht total kostot e parashikuara për blerjet e energjisë nga FSHU janë reviduar nga €193.064 milionë në €193.030 milionë. Këto të dhëna janë të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Tabela 7. Parashikimi i reviduar i kostove për humbjet e FSHU

Blerjet e energjisë për vitin 2025 - FSHU	GWh	€/MWh	mil€
Sasitë e furnizuara nga KEK	3,875.15	29.5	114.175
Gjenerimi sipas skemës mbështetëse	501.74	67.12	33.675
Tarifat e tregtimit për MWh në ALPEX	-	-	0.049
Gjenerimi në OSSh me kontrata koncesionare	16.25	63.79	1.037
Importi	243.75	161.28	39.312
Jobalancet	-	-	-
Total sasitë e furnizuara	4,636.58	40.608	188.248
Marzha me pakicë 2.54%			2.54%
Kostoja e Margjinës së FSHU			4.782
Gjithsej kostot me shumicë			193.030

5.2 Revidimet në parashikimin e kostove të bartshme për OST dhe OSSH

Llogaritja e obligimeve për vitin 2025 ndaj OST dhe OSSH bëhet duke u bazuar në tarifat e parashikuara të OST dhe OSSH për furnizim, dhe vëllimet e shitjeve të energjisë te konsumatorët e ndryshëm.

Gjatë procesit konsultativ ZRrE ka reviduar MAR për OST (Kapitulli 3) dhe MAR për OSSH (Kapitulli 4), në bazë të së cilave kanë ndryshuar edhe tarifat e parashikuara të OST dhe OSSH. Si rrjedhojë edhe obligimet e FSHU ndaj OST dhe OSSH, janë reviduar.

Këto ndryshime janë paraqitur në tabelën më poshtë.



Tabela 8. Parashikimi i kostove të bartshme për OST dhe OSSH

FSHU	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
Kostot e OST	mil. €	35.088	33.435
Kostot e OSSH	mil. €	141.554	141.204

5.3 Revidimet në kostot e realizuara të imbalanceve gjatë vitit 2024

Gjatë propozimit fillestar ZRrE, në analizën e kostove të realizuara për blerjen e energjisë në vitin 2024 ka marrë si vlerë të realizuar të imbalanceve vlerën €0.292 milionë për vitin 2024. Si rrjedhojë e procesit konsultativ, vlera faktike e realizuar e imbalanceve është €2.92 milionë.

Faktori KREV dhe të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2024 janë përditësuar për të marrë parasysh vlerën e ndryshuar të imbalanceve. Këto ndryshime janë përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela 9. Revidimi i kostove të realizuara të imbalanceve dhe faktorit KREV gjatë vitit 2024

FSHU	Njësia	Propozimi fillestar nga ZRrE	Propozimi final nga ZRrE
Kostot e imbalanceve - 2024	mil. €	0.292	2.92
Kostot e blerjeve të energjisë - 2024	mil. €	227.471	230.465
AACT-1 Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1	mil. €	443.104	446.176
ARRt-1 Të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1	mil. €	411.638	411.638
$I_t = 3.31\% + 5.74\%$	mil. €	9.05%	9.05%
$KREV = (AACat-1 - ARRt-1) * (1 + I_t) - \text{Faktori i përshtatjes së të hyrave}$	mil. €	34.173	37.532



5.4 MAR përfundimtar për FSHU

Bazuar në ndryshimet gjatë procesit konsultativ, si dhe analizat e bëra në raportin fillestar, ZRrE propozon MAR përfundimtar për FSHU në vlerë €435.926 milionë (reviduar nga €434.735 milionë).

Tabela 10. MAR i propozuar për vitin 2025

Propozim i MAR për FSHU	Një sia	Lejuar ZRRE 2024	Aplikimi FSHU 2025 (reviduar)	Propozimi ZRRE 2025
Parametrat e indeksimit				
Faktori i Efikasitetit	%	0%	0.75%	0.75%
Inflacioni - HICP	%	2.36%		
Norma e interesit It	%	9.3%		
Kostot me pakice te furnizuesit				
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.467	6.747	6.712
Zhvlerësimi - $DEPCt = DEPCt-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Pt)$	€m	0.130	0.361	0.134
Zhvlerësimi - Aktual	€m	0.131		
Kostot e bartshme				
Kostot e lejuara OST	€m	31.870	34.830	33.435
Kostot aktuale OST	€m	32.016		
Kostot e lejuara OSSH	€m	121.515	141.733	141.204
Kostot aktuale OSSH	€m	123.754		
Kostot për fondin e BRE	€m	15.388	13.759	13.759
Kostot aktuale për fondin e BRE	€m	15.446		
Kapitali punues (WCLCt)				
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPct + PSTct - NTFrt)$	€m	1.385	2.268	2.224
WCLC -Aktual	€m	2.345		
Kostot për blerjen e energjisë				
Marzha me pakicë	%	2.54%	2.54%	2.54%
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	187.690	196.520	193.030
Kostot aktuale të blerjes së energjisë me shumicë	€m	230.464		
Taksa për licencë dhe ALPEX	€m	0.019	0.019	0.019
Borxhi i keq (BDTA)				
BDTA	%	2.00%	1.80%	1.80%
BDTA-Lejuar	€m	5.501	8.291	8.030
BDTA-Aktuale	€m	8.924		
Përshtatjet e kostove të HC	€m	-0.151	-0.151	-0.151
Përshtatjet e të hyrave për FSHU ADJt				
Përshtatjet e vitit 2023-2024	€m	27.610	43.653	37.532
Të hyrat e lejuara maksimale	€m	446.176	447.989	435.926

Shtojca 1: Përgjigje ndaj komenteve

Konsultimi publik është në thelb të politikave rregullative të ZRrE-së. Gjatë procesit të konsultimit publik në kuadër të këtij procesi tarifor, ZRrE ka pranuar komente nga rreth 400 qytetarë, 8 Organizata Joqeveritare dhe Sindikata, 4 të licencuar, 4 biznese dhe nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo shtojcë paraqet përgjigjet e ZRrE-së ndaj komenteve të palëve të interesit, dhe është e organizuar si vijon:

- Kapitulli 1 ofron Përgjigje ndaj komenteve të Qytetarëve;
- Kapitulli 2 paraqet Përgjigjet ndaj komenteve të Shoqërisë Civile dhe Sindikatave;
- Kapitulli 3 paraqet Përgjigjet ndaj komenteve të Institucioneve të Republikës së Kosovës;
- Kapitulli 4 paraqet Përgjigjet ndaj komenteve të Ndërmarrjeve Energjetike;
- Kapitulli 5 paraqet Përgjigjet ndaj Komenteve të Bizneseve dhe Shoqatave Biznesore;
- Kapitulli 6 paraqet përgjigjet ndaj komenteve nga Mediat në takimin e përbashkët me ZRrE;

Komentet lidhur me procesin e liberalizimit, që nuk janë subjekt i këtij procesi tarifor, janë adresuar në Kapitullin 7.

1 Komentet nga Qytetarët

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka pranuar komente nga rreth 400 qytetarë. ZRrE ka analizuar në detaje të gjitha komentet e paraqitura dhe i vlerëson ato si pjesë e rëndësishme e procesit të konsultimit publik. ZRrE ka pranuar disa komente të ngjashme apo të njëjta nga qytetarë të ndryshëm, në vijim janë paraqitur komentet dhe përgjigjet për secilën nga qështjet e ngritura nga qytetarët.

1.1 Komente nga qytetarët në kundërshtim të rritjes së çmimit të energjisë elektrike

Përmbledhje e komenteve të qytetarëve 1.1.1:

ZRrE ka pranuar komente të natyrës së ngjashme nga 287 qytetarë, të cilat kundërshtojnë rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Qytetarët kanë paraqitur kundërshtime të qarta ndaj rritjes së propozuar të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2025, duke theksuar ndikimin negativ që do të ketë kjo masë në buxhetin e familjeve dhe në standardin e jetesës. Argumentet e tyre përfshijnë vështirësitë ekonomike aktuale, inflacionin, nivelin e ulët të të ardhurave dhe ndikimin zinxhir në çmime të tjera. Qytetarët gjithashtu kanë kërkuar transparencë më të madhe dhe përfshirje më të thellë në konsultimet publike.

Përgjigja ndaj komenteve të qytetarëve 1.1.1: ZRrE kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo thekson se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Procesi i përcaktimit të tarifave është i rregulluar sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht nenet 15, 45, 46 dhe 47 që e detyrojnë ZRrE-në që brenda mandatit të saj të siguroj që tarifat të reflektojnë kosto të arsyeshme dhe të domosdoshme për funksionimin efikas të sektorit, gjithnjë në mbrojtje të interesit të konsumatorit dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

ZRrE ka ndërmarrë masa për të kontrolluar rritjen e kostove duke rishikuar kërkesat e operatorëve dhe duke reduktuar propozimet për shpenzime që nuk janë të justifikuara. Raporti konsultativ për vlerat hyrëse mund të qaset këtu ndërkaq raporti përfundimtar pas përgjigjeve ndaj komenteve mund të qaset këtu.

Sa i përket transparencës dhe konsultimit publik, ZRrE ka zhvilluar takime me palë të ndryshme të interesit, përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe medias. Në përputhje me nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin, procesi i konsultimit ka qenë i hapur dhe gjithëpërfshirës përmes publikimeve në faqen zyrtare dhe ftesave për pjesëmarrje në diskutime.

ZRrE garanton se çdo koment është marrë në konsideratë dhe se vendimi përfundimtar do të reflektojë balancimin e drejtë ndërmjet nevojës për zhvillim të sistemit energjetik dhe mbrojtjes së konsumatorëve nga barrë e panevojshme financiare.

1.2 Komente nga qytetarët

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga disa qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Komenti i qytetarëve 2.1.1: Gjendja ekonomike e qytetarëve dhe niveli i pagave

Në një periudhë ku shumë qytetarë të Kosovës janë të goditur nga pasojat ekonomike të pandemisë, rritja e çmimeve të energjisë elektrike do të përkeqësojë ende më tej gjendjen ekonomike të familjeve. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të adresuar situatën, paga mesatare e qytetarëve kosovarë është ende shumë e ulët dhe nuk mund të përballojë asnjë lloj rritje të mëtejshme të çmimeve të energjisë. Një hap i tillë do të rëndojë më tej qytetarët, duke i detyruar ata të përballen me vështirësi të mëdha financiare.

Përgjigjja e ZRrE 1.2.1:

ZRrE e kupton shqetësimin e qytetarëve për gjendjen ekonomike dhe ndikimin që mund të ketë çdo rritje tarifore në buxhetin e tyre. Megjithatë, sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE nuk ka mandat për të vendosur tarifa mbi baza sociale ose për të llogaritur ndikimin e tyre në mirëqenie ekonomike. Neni 15, 45, 46 dhe 47 i Ligjit të lartcekur përcakton që tarifat përcaktohen në bazë të kostove të arsyeshme dhe të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve cilësore, e jo në varësi të të ardhurave të konsumatorëve.

Komenti i qytetarëve 1.2.2.: Rritja e çmimit të energjisë si faktor i rëndë për krizën ekonomike

Kosova, ashtu si shumë shtete të tjera, po përballlet me një periudhë të pasigurisë ekonomike të shkaktuar nga kriza globale dhe pasiguria në tregjet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, çdo rritje tjetër e çmimit të energjisë do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e inflacionit dhe do të godiste të gjitha sektorët e ekonomisë, duke rritur kostot e jetesës dhe duke përkeqësuar situatën për qytetarët dhe bizneset, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme që janë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve të çmimeve.

Përgjigjja e ZRrE 1.2.2:

Ndikimi makroekonomik i tarifave është jashtë mandatit të ZRrE-së, por komentet janë të vlefshme për institucione të tjera shtetërore që merren me politikën ekonomike dhe sociale. ZRrE, në përputhje me mandatin e saj, ka ndërmarrë hapa për të reduktuar ndikimin e rritjes përmes rishikimit të kërkesave të operatorëve dhe përmes instrumenteve për rritje të efikasitetit, reduktim të humbjeve dhe refuzim të shpenzimeve që nuk justifikohen.

Komenti i qytetarëve 1.2.3: Liberalizmi i tregut dhe heqja e monopolit

Një nga faktorët që pengon zhvillimin e një tregu të drejtë dhe konkurrues në Kosovë është dominimi i një kompanie të vetme në sektorin e energjisë elektrike, i cili krijon një situatë monopoliste. Liberalizimi i tregut të energjisë është një mundësi e rëndësishme për të krijuar kushte më të favorshme për konsumatorët dhe për të zvogëluar çmimet e energjisë. Duke hequr monopolin dhe duke inkurajuar hyrjen e aktorëve të tjerë në treg, mund të krijohet një konkurrencë më e

shëndetshme, që do të çonte në uljen e çmimit të energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Ky është një hap i domosdoshëm për zhvillimin e tregut dhe rritjen e efikasitetit në sektorin energjetik.

Përgjigjja e ZRrE 1.2.3:

ZRrE është e angazhuar në mbështetjen e liberalizimit të tregut të energjisë, proces i cili është duke u zhvilluar gradualisht sipas kornizës ligjore. Megjithatë, liberalizimi është një proces i ndarë nga përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale.

Komenti i qytetarëve 1.2.4: Alternativat e mundshme dhe menaxhimi i burimeve

Në vend të rritjes së çmimit të energjisë, duhet të shqyrtohen mundësi të tjera për të menaxhuar krizën energjetike. Investimi në burime të rinovueshme të energjisë, efikasiteti më i madh në përdorimin e energjisë dhe një menaxhim më i mirë i konsumit të energjisë mund të jenë mënyra më të qëndrueshme dhe të përbalueshme për të trajtuar këtë situatë. Gjithashtu, ka nevojë për një kontroll më të fortë të humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe një ristrukturim të politikave energjetike që do të ndihmojnë në zvogëlimin e varësisë nga burimet e energjisë që janë të shtrenjta dhe të paqëndrueshme.

Përgjigjja e ZRrE 1.2.4:

ZRrE në vazhdimësi e promovon integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë përmes hartimit dhe përmirësimit të kornizave rregullative për licensim, operim dhe mbështetje. Gjithashtu, ZRrE ka kërkuar në vazhdimësi nga operatorët që të përmirësojnë planifikimet e investimeve në rrjetet përkatëse si dhe ka krijuar mekanizma për promovimin e reduktimit të humbjeve në rrjet. Megjithatë, vendimet për investime strategjike dhe menaxhim të burimeve janë përtej mandatit të rregullatorit.

Komenti i qytetarëve 1.2.5: Nevoja për mbështetje dhe solidaritet gjatë krizave

Në këtë periudhë të krizës, është e domosdoshme që politika e energjisë të jetë e orientuar drejt mbështetjes së qytetarëve dhe bizneseve, dhe jo për keqësimin e kushteve të tyre. Qeveria duhet të marrë në konsideratë solidaritetin dhe mbështetjen për ata që kanë nevojë, duke siguruar që qytetarët nuk do të mbesin të pasigurt dhe të privuar nga mundësia për të siguruar energjinë e nevojshme për jetesën e tyre.

Në përfundim, rritja e çmimit të energjisë elektrike në këtë periudhë është një vendim i panevojshëm dhe i dëmshëm për qytetarët e Kosovës. Nuk mund të justifikohet në kushte të tilla të pasigurisë ekonomike dhe me nivelin aktual të pagave. Për më tepër, është e nevojshme të përmbyllet periudha e monopolizmit në sektorin e energjisë dhe të krijohet një treg i lirë dhe konkurrues, i cili do të sjellë përfitime për qytetarët dhe ekonominë. Është koha që politika energjetike të fokusohet në zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme, që do të përmirësojnë situatën e qytetarëve dhe do të mbështesin zhvillimin ekonomik pa rënduar mbi koston e jetesës.

Përgjigjja e ZRrE 1.2.5:

ZRrE kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo njofton se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me

nenin 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe nenin 16, të cilat përcaktojnë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. ZRrE qëndron e hapur për bashkëpunim ndërinstitucional për të asistuar në lidhje me hartimin e skemave mbështetëse për konsumatorë në nevojë.

ZRrE siguron se çdo propozim për rritje tarifore i nënshtrohet një analize të detajuar teknike dhe financiare, me qëllim që tarifat të jenë të bazuara, transparente dhe të qëndrueshme, duke ruajtur integritetin e sistemit energjetik dhe mbrojtur konsumatorët nga barrë e panevojshme.

1.3 Komente nga qytetarët

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga disa qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Komenti i qytetarëve 1.3.1: Kostot Operative (OPEX) – Ulje e pamjaftueshme dhe e paqartë

- a. Kostot operative për vitin 2025 janë parashikuar të jenë 7.86 milionë euro, krahasuar me 8.21 milionë euro në vitin 2024. Kjo përfaqëson një ulje prej 0.35 milionë euro.
- b. Ulja e kostove është minimale dhe e pamjaftueshme, duke pasur parasysh që kompanitë e sektorit të energjisë kanë pasur mundësi reale për kursime më të mëdha përmes optimizimit të proceseve dhe rritjes së efikasitetit.
- c. Mungesa e transparencës është një problem kyç. Raporti nuk shpjegon se cilat kategori shpenzimesh janë ulur dhe në cilat fusha ka pasur kursime konkrete.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.1:

Gjatë çdo shqyrtimi tarifor shumëvjeçar, ZRrE analizon në detaje të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative të paraqitura nga operatorët dhe vendos faktorë të efikasitetit. Në kuadër të shqyrtimit tariforë shumëvjeçar për OST ([PRR3 2023 - 2027](#)), ZRrE ka analizuar të gjitha kategoritë e shpenzimeve dhe ka vendosur një raport efikasiteti prej 1.5%. Kjo reflekton shkurtime të cilat janë vlerësuar si të mundshme pa rrezikuar ofrimin e shërbimit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se disa kosto janë të qëndrueshme dhe të pashmangshme për funksionimin normal të rrjetit.

Sipas rregullave për shqyrtimet tarifore, gjatë përshtatjeve të rregullta, ZRrE nuk analizon kostot e veçanta të OPEX apo faktorin e efikasitetit, por e bën përshtatjen e kostove të lejuara të OPEX në bazë të inflacionit.

Komenti i qytetarëve 1.3.2: Rritja e kostove për shërbimet ndihmëse – E tepruar dhe e pajustificuar

- a. Rritja e shpenzimeve për shërbimet ndihmëse nga 18.17 milionë euro në 43.12 milionë euro është joproporcionale dhe nuk ka analizë të qartë që justifikon këtë rritje ekstreme.
- b. Rritja e kapacitetit të rezervave automatike (aFRR) nga +/- 25 MW në +/- 40 MW nuk është shoqëruar me analiza që tregojnë përfitimet konkrete për konsumatorët.
- c. Po ashtu, mungon transparenca mbi procedurat e tenderimit për sigurimin e këtyre shërbimeve.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.2:

Arsyeja kryesore e rritjes së kostos së shërbimeve ndihmëse vjen nga rritja e kontraktimit të kapaciteteve aFRR dhe mFRR si pasojë e kërkesave të ENTSO-E për përmirësim të balancimit të sistemit. Rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga OST e Shqipërisë. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e marra për aFRR janë 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me Palën Ofruese të Shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MW për ngritje dhe -50 MW për zbritje.

Detyrimi për sigurimin e rezervës buron nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit) ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kushteve të tregut mbi të cilat ZRrE nuk ka kontrollë në pajtim me Nenin 13.2 e [Rregullave të Tregut](#).

Rezerva e obligueshme është reduktuar ngaqë është në një zonë rregulluese me Shqipërinë. Po të mos ishte në të njëjtën zonë rregulluese rezerva do të duhej të ishte më i lartë (265 MW).

Komenti i qytetarëve 1.3.3: Parashikimi i kostove për humbjet në rrjet – Mbivlerësim i paarsyeshëm

- ZRrE ka parashikuar që çmimi për mbulimin e humbjeve në rrjet të arrijë në 13.97 milionë euro, një rritje e konsiderueshme nga 9.20 milionë euro në vitin 2024.
- Çmimi mesatar i parashikuar prej 105.7 €/MWh është i fryrë krahasuar me çmimin e realizuar në vitin 2024 prej 66.24 €/MWh.
- Shtesa prej 9.55% mbi çmimet e tregut HUDEX është e pajustificueshme dhe mbivlerëson koston e humbjeve në mënyrë të panevojshme.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.3:

Rritja e kostove të lejuara për mbulimin e humbjeve vije si rezultat i dallimeve mes parashikimeve të kostos së energjisë gjatë vitit 2024 dhe parashikimeve në vitin 2025. Këto kosto janë jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar. Çmimi prej 66.4 €/MWh është çmimi mesatar i ponderuar i parashikuar për vitin 2024, dhe nuk është çmimi i realizuar.

Çmimi mesatar i ponderuar i blerjeve të realizuara nga OST në 2024 ishte 103.79 €/MWh, ku çmimi mesatar i importit ishte 148.30 €/MWh. Në parashikimin e reviduar për vitin 2025, çmimi mesatar i ponderuar i blerjeve është 99.18 €/MWh, ndërsa çmimi mesatar i importit për OST është parashikuar në vlerë prej 121.81 €/MW.

Çmimi i referencës për humbjet është bazuar në vlerësimet e tregut për vitin 2025, duke përfshirë të dhënat nga bursat si për blerje afatgjate si HUDEX dhe dallimet strukturore të çmimeve në mes të HUPEX dhe ALPEX. Vlera e përshtatjes për 9.55% është marrë në bazë të dallimeve të çmimeve mesatare mujore në mes të HUPEX dhe ALPEX nga Shkurti i vitit 2023 deri në fund të Shkurtit 2024. Korrelacioni në mes të këtyre parametrave për këta muaj rezulton të jetë 98%. Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka reviduar këtë pikë, dhe vlera e re është vendosur përmes analizës së sqaruar në raport.

Komenti i qytetarëve 1.3.4: Rritja e Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) – E pajustificuar

- a. ZRrE ka propozuar një rritje të fondit për BRE nga 11.81 milionë euro në 17.34 milionë euro.
- b. Nuk është ofruar një raport i detajuar që tregon si janë shpenzuar fondet e mëparshme dhe cilat janë rezultatet konkrete në nxitjen e energjisë së gjelbër.
- c. Një rritje e tillë e fondeve është e pajustificuar pa prova që fondet ekzistuese janë menaxhuar në mënyrë efikase.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.4:

Rritja e fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë është bërë në përputhje me kërkesat për përkrahje të skemave ekzistuese të mbështetjes, dallimin mes çmimit referent dhe skemave mbështetëse dhe shtimin e kapaciteteve. Fondi Burimeve të Ripërtërishme përdoret për të paguar diferencën në mes të çmimit referent dhe prodhuesve të energjisë në kuadër të skemës mbështetëse sipas Feed-in Tarifës. OST në vazhdimësi publikon raporte mbi performancën dhe prodhimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë brenda fondit të BRE. Si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm aplikohet një korigjim për kostot e fondit të BRE për vitin 2024 në vlerë prej -4.11 €/MWh, e cila përfshin diferencën mes të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit të BRE për vitin 2024. Ky korigjim është ndaras nga kostoja prej vlerës €17.4 milion.

Komenti i qytetarëve 1.3.5: Të hyrat jo-tarifore – Parashikim i manipuluar

- a. ZRrE ka parashikuar të hyra jo-tarifore prej -8.31 milionë euro, ndërsa në vitin 2024 janë realizuar -9.34 milionë euro. Ulja artificiale e të hyrave jo-tarifore duket se është përdorur për të justifikuar rritjen e tarifave.
- b. Nuk janë dhënë detaje të qarta mbi potencialin e të ardhurave nga tregtia e kapaciteteve dhe mekanizmi ITC.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.5:

ZRrE ka bërë një parashikim të kujdesshëm të të hyrave jo-tarifore për vitin 2025 bazuar në tendencat e tregut dhe të dhënat e realizuara. Në vitin 2024 janë parashikuar €8.71 milionë të hyra jo-tarifore, ndërsa janë realizuar €8.197 milionë. Për vitin 2025 ZRrE parashikon €8.71 milionë të hyra jo-tarifore, pra €0.52 milionë më shumë se të realizuarat në vitin 2024. Të gjitha ndryshimet e arsyeshme në mes të të hyrave jo-tarifore të parashikuara dhe atyre të realizuara përshtaten në vitin pasues.

Komenti i qytetarëve 1.3.6: Faktori Korigjues i të Hyrave – Vendim i paargumentuar

ZRrE ka miratuar një faktor korigjues prej 0.85 milionë euro si rezultat i devijimeve ndërmjet kostove të lejuara dhe të hyrave të realizuara në vitin 2024.

Ky faktor përfshin gabime të mëparshme në parashikim, për të cilat konsumatorët nuk duhet të mbajnë barrën financiare.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.6:

Zbatimi i faktorëve korigjues është pjesë e metodologjisë rregullative dhe reflekton devijimet ndërmjet të hyrave të realizuara të arsyeshme dhe atyre të lejuara në vitin paraparak. Kjo praktikë është

e zakonshme në rregullimin e tarifave dhe siguron balancim të drejtë ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve. ZRrE ka verifikuar të dhënat dhe përlllogaritjet për të konfirmuar saktësinë e tyre.

Komenti i qytetarëve 1.3.7: Ndikimi social dhe ekonomik

Rrezik për konsumatorët Rritja e propozuar do të rëndojë ndjeshëm konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove të jetesës. Kjo pritet të rrisë varfërinë ekonomike në një periudhë kur konsumatorët po përballen me sfida të mëdha ekonomike.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.7:

ZRrE kupton shqetësimin lidhur me ndikimin potencial në konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla. Megjithatë, vlerësimi i ndikimit social nuk është pjesë e mandatit të ZRrE-së sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë. ZRrE vepron mbi bazën e kostove të arsyeshme dhe nuk ka mandat të përcaktojë tarifa në bazë të aftësisë paguese të konsumatorëve.

Komenti i qytetarëve 1.3.8: Mungesa e transparencës – Proces i pakuptueshëm dhe i ngutur

Raporti konsultativ është i paqartë në disa pika kyçe dhe nuk ofron arsytetime të plota për disa nga vendimet më të rëndësishme që prekin tarifat e konsumatorëve.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.8:

ZRrE ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për publikimin dhe konsultimin e raporteve. Raportet konsultative janë të publikuara dhe të hapura për komente. ZRrE gjithashtu ka mbajtur takime me palë të interesit, duke përfshirë OJQ, mediat, Avokatin e Popullit, dhe institucionet e tjera. Vendimmarrja përfundimtare bëhet pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, ku ZRrE ka dhënë sqarime për të gjitha komentet.

Komenti i qytetarëve 1.3.9: Përfundim

- a. Rritja e propozuar e çmimeve të energjisë elektrike është e pajustificuar, e paargumentuar dhe e dëmshme për konsumatorët. Vendimi mbështetet mbi parashikime të fryra dhe shpenzime të paarsyeshme, duke e transferuar barrën financiare te konsumatorët.
- b. Bazuar në argumentet e lartcekura kërkoj nga ZRrE të rishikojë propozim për rritje të çmimit të energjisë dhe të publikojë një analizë më transparente dhe të drejtë mbi nevojën e rritjen e tarifave.

Përgjigjja e ZRrE 1.3.9:

ZRrE siguron se shqetësimet janë shqyrtuar me kujdes dhe se vendimi final do të jetë i bazuar në të dhëna objektive dhe parime rregullative, në përputhje me mandatin ligjor.

1.4 Komente nga qytetarët

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga disa qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Komenti i përgjithshëm nga qytetarët

Rritja e propozuar prej 15% e tarifave të energjisë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) është e pajustificueshme dhe e rrezikshme për ekonominë dhe shoqërinë kosovare. Ky vendim, ndonëse teknikisht i strukturuar, është ekonomikisht dhe shoqërisht i papranueshëm.

Komenti i qytetarëve 1.4.1: Efekt zinxhiror në inflacion dhe standard jetese

Ky është vendimi i tretë për rritje të tarifave brenda pak viteve, në një kohë kur inflacioni i dekadës së fundit ka përgjysmuar fuqinë blerëse të qytetarëve. Nëse tarifa e lartë rritet në 15.28 cent, ajo përfaqëson një rritje prej 126% krahasuar me vitin 2021, e papërbalueshme për shumicën e familjeve dhe bizneseve.

Përgjigjja e ZRRë 1.4.1:

ZRRë e kupton shqetësimin lidhur me ndikimin e tarifave në koston e jetesës, megjithatë vendimet për përcaktimin e tarifave bazohen në kosto të arsyeshme dhe të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve, siç përcaktohet në nenin 15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë. Rritja e propozuar pasqyron trendet e çmimeve në tregjet e energjisë dhe rritjen e kostove të operatorëve.

Komenti i qytetarëve 1.4.2: Kostoja e energjisë raportuar me të ardhurat

ZRRë e justifikon rritjen me faktin se “Kosova ka çmimet më të ulëta në rajon.” Por kur krahasohet fuqia blerëse, energjia në Kosovë rezulton 63.5% më e shtrenjtë se në Mal të Zi. Për një qytetar që merr 500 euro në muaj, një faturë prej 100 euro përfaqëson 20% të të ardhurave mujore, dhjetëfish më e rëndë se për një qytetar të BE-së.

Përgjigjja e ZRRë 1.4.2:

ZRRë përcakton tarifën mbi bazën e kostove të justifikueshme për ofrimin e shërbimit të energjisë elektrike dhe jo mbi bazën e të ardhurave të konsumatorëve. Ndërkohë që krahasimet me vendet e rajonit janë të rëndësishme për kontekstin tregtar, metoda e përcaktimit të tarifave në Kosovë bazohet në analizat e nevojave financiare dhe operative të operatorëve. Politikat sociale për adresimin e përbalueshmërisë nuk janë brenda mandatit të ZRRë-së.

Komenti i qytetarëve 1.4.3: Pa transparencë financiare

ZRRë nuk ka publikuar raportet financiare të KEDS, duke pamundësuar analizën e drejtë të të hyrave maksimale të lejuara. Rritja e kërkesës nga KEDS për 217 milionë euro në 2025 (nga 120 milionë në 2024) është e tepruar dhe në mospërputhje me dokumentin strategjik të vetë ZRRë-së.

Përgjigjja e ZRRë 1.4.3:

Në vlerësimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarve, ZRRë analizon të dhënat e dorëzuara nga të licencuarit për shpenzimet e realizuara, krahas vendimeve të ZRRë-së para çdo viti tarifor. Praktikën kontabël të ZRRë nuk përkojnë me standardet e aplikuar nga të licencuarit prandaj pasqyrat financiare të kompanive, të përgatitura për qëllime statutores, dallojnë nga pasqyrat rregullative. Publikimi dhe auditimi i pasqyrave financiare statutores të operatorëve në Kosovë nuk është përgjegjësi e ZRRë, por e organeve kompetente për auditim dhe publikim.

Komenti i qytetarëve 1.4.4: Shkelje e detyrimeve ligjore

Ligji e obligon ZRrE-në të konsultojë publikun dhe të mbrojë konsumatorët. Në këtë proces, janë anashkaluar organizatat e mbrojtjes së konsumatorit dhe nuk është demonstruar transparencë apo ndjeshmëri ndaj ndikimit socio-ekonomik të vendimit.

Përgjigjja e ZRrE 1.4.4:

ZRrE ka ndjekur procedurën e paraparë me nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për konsultim publik, duke organizuar takime me përfaqësues të institucioneve, shoqërisë civile, mediave dhe sektorëve të ndryshëm. Komentet janë mbledhur dhe shqyrtuar në mënyrë transparente. Ndikimi socio-ekonomik është jashtë mandatit ligjor të ZRrE-së për t'u trajtuar si kriter vendimtar në përcaktimin e tarifave.

Komenti i qytetarëve 1.4.5: Zgjidhje të mundshme pa rritje tarifash

Nëse rishikohen humbjet e lejuara për KEDS dhe investimet për shërbime ndihmëse të KOSTT, si dhe kërkohet një subvencion direkt nga buxheti shtetëror, një shumë që Qeveria e ka dëshmuar se mund ta mobilizojë, rritja e tarifave bëhet e panevojshme. Kjo është një zgjidhje e balancuar, që ruan interesin publik dhe mbron ekonominë.

ZRrE duhet të reflektojë me përgjegjësi institucionale. Rritja e tarifave nuk është zgjidhje teknike, por vendim me pasoja reale në jetën e qytetarëve. Një ekonomi që i nënshtrohet inflacionit për shkak të energjisë shkon drejt pakënaqësisë sociale dhe krizave tjera. Kosova ka nevojë për vendime të mençura, jo për përshkallëzim të barrës mbi qytetarët.

Përgjigjja e ZRrE 1.4.5:

ZRrE ka analizuar në mënyrë kritike kërkesat e operatorëve për investime dhe ka bërë shkurtime aty ku ka munguar dokumentacioni justifikues. Kërkesa për subvencione apo ndihmë buxhetore është jashtë mandatit të ZRrE-së.

1.5 Komente nga qytetarët

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga disa qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Koment i përgjithshëm nga Qytetarët 1.5

Lënda: Kundërshtim ndaj rritjes së tarifave të energjisë elektrike në Kosovë I nderuar Kryetar i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), Si qytetar i Republikës së Kosovës dhe në interesin publik, shprehim shqetësimin tonë të thellë në lidhje me vendimin për rritjen e tarifave të energjisë elektrike, një masë e cila do të rëndojë edhe më tej gjendjen ekonomike dhe sociale të popullatës.

Keqmenaxhimi dhe mungesa e politikave të duhura në sektorin e energjisë kanë çuar në një rritje të here radhazi të përsëritur të çmimeve të energjisë elektrike, duke rënduar ndjeshëm buxhetin e qytetarëve dhe ekonominë e vendit. Mungesa e investimeve strategjike, administrimi i dobët i ndërmarrjeve publike si KEK, si dhe paaftësia profesionale e bordit të ZRrE-së kanë krijuar një situatë

të pasigurt energjetike. Për më tepër, dështimi në realizimin e planeve operative ka lënë sektorin të pambrojtur ndaj krizave dhe pa një strategji afatgjatë për stabilizim.

Këto dështime në politikat e sektorit të energjisë nuk mund dhe nuk duhet të përkthehen në rritje të çmimeve të energjisë në kurriz të qytetarëve. Përgjegjësia për keqmenaxhimin, mungesën e investimeve dhe politikat e gabuara nuk mund t'u faturohet konsumatorëve, të cilët tashmë përballen me një rritje të kostos së jetesës dhe një nivel pagash që nuk reflekton inflacionin. Qeveria dhe institucionet përgjegjëse duhet të adresojnë shkaqet e krizës në mënyrë transparente dhe të gjejnë zgjidhje që mbrojnë interesin publik, në vend që të rëndojnë edhe më tej gjendjen ekonomike të familjeve dhe bizneseve.

Kjo situatë ka përkeqësuar kushtet e jetesës për qytetarët, të cilët tashmë përballen me një rritje të pandalshme të kostos së jetesës, ndërsa pagat mbeten të pandryshuara dhe nuk reflektojnë nivelin e inflacionit. Kategoritë më të prekura, si mësuesit, punonjësit shëndetësorë, policia, shërbyesit civil, pensionistët, kategoritë sociale dhe veteranët e luftës, ndodhen përballë një krize ekonomike që kërkon masa urgjente.

Rritja e çmimeve të energjisë është tregues i qartë i keqmenaxhimit në këtë sektor dhe i mungesës së angazhimit për investime të qëndrueshme. Për më tepër, rritja e çmimeve nuk ka ardhur si një domosdoshmëri e tregut, por si rezultat i vendimeve të koordinuara midis qeverisë dhe kompanive të energjisë, duke e vënë barrën kryesore mbi qytetarët. Ky model i politikës energjetike jo vetëm që rëndon gjendjen financiare të familjeve dhe bizneseve, por sjell gjithashtu një efekt zinxhir në ekonominë e përgjithshme, duke shkaktuar rritje të çmimeve të produkteve baze që edhe ashtu janë rritur dhe kane tejkaluar çdo arsye dhe shërbimeve dhe duke thelluar më tej varfërinë.

Një qasje e tillë është e papranueshme dhe kërkon një rishikim urgjent të strategjisë energjetike për të garantuar çmime të përballueshme, transparencë në menaxhim dhe një politikë investimesh që siguron stabilitet afatgjatë për qytetarët dhe ekonominë.

Koment i qytetarëve 1.5.1: Rritja e propozuar është e pajustificueshme dhe rrit koston e jetesës

- a. Rritja e propozuar prej 15% e tarifave të energjisë është e pajustificueshme, sidomos kur çmimi i energjisë në tregjet ndërkombëtare ka rënë.
- b. Qytetarët tashmë janë përballur me rritjen e çmimit të energjisë tre herë radhazi, duke çuar në një rritje të përgjithshme prej mbi 126% që nga viti 2021.
- c. Kjo rritje do të shkaktojë një efekt zinxhiror në çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tjera, duke përkeqësuar më tej inflacionin dhe fuqinë blerëse të qytetarëve.
- d. Në Kosovë, qytetarët shpenzojnë deri në 20% të të ardhurave mujore për energjinë elektrike, shumë më tepër sesa mesatarja e vendeve të BE-së është shumë më ulët.

Përgjigja e ZRrE 1.5.1:


- a. Gjatë procesit konsultativ dhe në raportin final ZRrE i ka paraqitur të gjitha arsyet që ndikuan në rritjen e çmimit.

Përderisa çmimet e energjisë në vitin 2024 ishin më të ulta se në muajt e parë të vitit 2023, në fund të vitit ato u ngritën përsëri. Në bazë të çmimeve të ulta në fillim të vitit 2024, ZRrE ka parashikuar çmimet e importit për vitin 2024, bazë mbi të cilën ZRrE ka ulur tarifën gjatë vitit

2024. Çmimi i importit gjatë vitit 2022 dhe 2023 ishte pjesërisht i subvencionuar nga Qeveria e Kosovës.

Çmimet e realizuara në tregje ndërkombëtare² në vitin 2024 ishin më të larta se ato të parashikuarat. Gjithashtu edhe kostot për kapacitete ndërkufitare³ janë rritur mbi parashikimet e ZRrE (figurat më poshtë).

Figura: Çmimet e energjisë elektrike në HUPX (majtas) dhe çmimet e kapaciteteve ndërkufitare të realizuara (djathtas)



Parashikimet e ZRrE për çmimin e importit (duke përfshirë kostot ndërkufitare) të vitit 2025, edhe pse janë më të larta se parashikimet e ZRrE për çmimet e vitit të vitit 2024 (mbi të cilat janë caktuar tarifet e vitit 2024), ato janë më të ulëta se çmimet e realizuara (apo reale) gjatë vitit 2024, dhe reflektojnë gjendjen reale të pritshme të tregut.

- b. Llogaritja e rritjes së çmimit të energjisë është e pasaktë. Rritja e përgjithshme e energjisë për konsumatorë familjarë nga viti 2021 nuk është 126%. Komentuesi nuk reflekton çmimin e realizuar mesatar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve si dhe çmimin për 800 kWh e para të konsumit, të cilat ofrohen për secilin konsumatorë. Llogaritja e saktë e çmimeve mesatare është dhënë në Kapitullin 3.8.7 të [Raportit Vjetor të ZRrE për vitin 2024](#). Aty ofrohen edhe tarifet mesatare për konsumatorët shtëpiak që në vitin 2021 ishin 5.60 c/kWh ndërkaq në vitin 2024 janë 7.39 c/kWh. Ky ndryshim është 31%.
- c. ZRrE nuk ka mandat të adresojë drejtpërdrejt ndikimin makroekonomik të tarifave, por shqyrton me kujdes çdo propozim që mund të krijojë barrë të panevojshme për konsumatorët. ZRrE synon të balancojë nevojën për qëndrueshmëri të sistemit me ndikimin e mundshëm të konsumatorët përmes kontrollit të shpenzimeve të operatorëve.
- d. ZRrE e vlerëson rëndësinë e përbalueshmërisë së energjisë për konsumatorët, por përcaktimi i tarifave bazohet në kosto reale të shërbimeve të energjisë. Politikat e mbështetjes sociale dhe përbalueshmërisë janë jashtë mandatit të ZRrE-së dhe trajtohen përmes mekanizmave dhe institucioneve të tjera.

² HUPX - <https://hupx.hu/en/>

³ SEECAO - <https://seecao.com/auctions/>

Koment i qytetarëve 1.5.2: Mungesa e transparencës dhe keqmenaxhimi i sektorit të energjisë

- a. Mungesa e transparencës nga ZRrE, e cila nuk ka publikuar raportet financiare të KEDS dhe KESCO që nga viti 2020, përbën një shkelje të së drejtës së publikut për informim. Kjo mungesë e llogaridhënies ngre shqetësime serioze mbi menaxhimin financiar dhe përdorimin e të ardhurave nga këto kompani, duke lënë qytetarët pa qasje në informacion thelbësor mbi shpenzimet dhe fitimet në sektorin e energjisë. Për të garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri, kërkohet publikimi i menjëhershëm i raporteve financiare dhe një rishikim i politikave të ZRrE-së në raport me informimin publik.
- b. Humbjet e pretenduara nga operatorët privatë nuk mund dhe nuk duhet të përkthehen në barrë financiare për qytetarët. Në një ekonomi të drejtë dhe të lirë, bizneset marrin përsipër si fitimet ashtu edhe humbjet e tyre, pa i transferuar këto të fundit tek konsumatorët përmes rritjes së çmimeve. Rritja e tarifave të energjisë elektrike në emër të mbulimit të këtyre humbjeve është një praktikë e padrejtë dhe e papranueshme, e cila cenon standardin e jetesës së qytetarëve dhe rëndon më tej situatën ekonomike të familjeve kosovare. Autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë që çdo vendim për rritjen e çmimeve të bazohet në analiza të drejta dhe transparente, duke mbrojtur interesin publik.
- c. Është e domosdoshme që Ministria e Ekonomisë, Drejtoria për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Bordi i ZRrE-së, Bordi dhe menaxhmenti i KEK-ut, si dhe akterët e tjerë në sektorin e energjisë të japin llogari për keqmenaxhimin dhe mungesën e transparencës që kanë çuar në rritjen e padrejtë të çmimeve të energjisë. Këto institucione kanë për detyrë të mbrojnë interesin e qytetarëve dhe të sigurojnë një sektor energjetik të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm. Prandaj, kërkohet përgjegjësi dhe veprime konkrete për të ndaluar abuzimet dhe për të garantuar politika të drejta që nuk rëndojnë qytetarët.

Përgjigjja e ZRrE 1.5.2:

- a. Në vlerësimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarve, ZRrE analizon të dhënat e dorëzuara nga të licencuarit për shpenzimet e realizuara, krahas vendimeve të ZRrE-së para çdo viti tarifor. Praktikant kontabël të ZRrE nuk përkojnë me stardardet e aplikuara nga të licencuarit prandaj pasqyrat financiare të kompanive, të përgaditura për qëllime statutore, dallojnë nga pasqyrat rregullative. Publikimi dhe auditimi i pasqyrave financiare statutore të operatorëve në Kosovë nuk është përgjegjësi e ZRrE, por e organeve kompetente për auditim dhe publikim.
- b. ZRrE përfshin në tarifa vetëm humbjet brenda kufijve të lejuar që janë të përcaktuara në procesin e shqyrtimeve shumëvjeçare (PRR3 2023 – 2027). Humbjet që tejkalojnë kufijtë e arsyeshëm nuk përfshihen në përlllogaritjen e tarifave. Kjo siguron që konsumatorët të mos mbajnë barrën e menaxhimit joefikas. Blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve të lejuara konsiderohen si kosto të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të të licensuarve (OST dhe OSSH).
- c. ZRrE nuk ka mandat të kërkojë llogaridhënie nga institucionet e tjera publike. ZRrE mbetet e hapur për bashkëpunim me të gjitha palët.

Koment i qytetarëve 1.5.3: Mospërputhje me detyrimet ligjore

- a. Ligji e obligon Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZrRE) që të mbrojë interesin publik dhe të sigurojë çmime të përballueshme për konsumatorët. Megjithatë, vendimi për rritjen e tarifave të energjisë duket se favorizon operatorët privatë në dëm të qytetarëve. Kjo qasje jo vetëm që bie ndesh me detyrimet ligjore të ZrRE-së, por edhe cenon stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien e familjeve kosovare. Rritja e çmimeve pa një bazë transparente dhe të arsyetuar rëndon më tej barrën financiare mbi qytetarët, të cilët tashmë përballen me kosto të larta jetese dhe inflacion të lartë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ky vendim të rishikohet dhe të merren masa për mbrojtjen e konsumatorëve.
- b. Procesi i konsultimeve publike, një detyrim ligjor për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje, është anashkaluar në mënyrë të papranueshme. Ky veprim jo vetëm që shkel parimet e qeverisjes së mirë, por tregon edhe një mungesë serioze të përgjegjësisë institucionale nga Bordi i ZrRE-së. Sjellja e këtij bordi ka dëshmuar mungesë profesionalizmi dhe papërgjegjësi në trajtimin e një çështjeje kaq jetike për ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Rritja e tarifave të energjisë, pa një proces të hapur dhe gjithëpërfshirës, minon besimin e publikut dhe cenon të drejtën e konsumatorëve për të marrë pjesë në vendimet që i prekin drejtpërdrejt. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ky vendim të rishikohet dhe të kërkohet përgjegjësi nga ata që kanë neglizhuar transparencën dhe interesin e qytetarëve.
- c. Vendimi juaj për rritjen e çmimit të energjisë bie ndesh me ligjet në fuqi dhe shkel interesin publik, duke favorizuar kompanitë private të përfshira në sektorin e energjisë. Ky veprim jo vetëm që cenon transparencën dhe të drejtat e konsumatorëve, por gjithashtu ngre dyshime serioze mbi mënyrën e menaxhimit dhe ndikimeve në vendimmarrje.
- d. Për këtë arsye, mos u befasoni nëse do të përballeni me padi ligjore dhe hetime të mëtejshme mbi këtë çështje. Ky vendim krijon hapësirë për dyshime të arsyeshme mbi ligjshmërinë dhe integritetin e procesit të rritjes së tarifave të energjisë. Në interes të drejtësisë dhe mbrojtjes së qytetarëve, ju ftojme të rishikoni këtë vendim dhe të siguroheni që veprimet tuaja të jenë në përputhje me ligjin dhe interesin publik.

Përgjigjja e ZrRE 1.5.3:

- a. ZrRE bazohet në ligj për të garantuar një balancë ndërmjet interesit të konsumatorit dhe nevojës për një sektor energjetik financiarisht të qëndrueshëm. Vendimet nuk favorizojnë operatorët, por bazohen në kosto të justifikuarra dhe të verifikuara.
- b. ZrRE ka hapur konsultimet publike përmes publikimit të dokumenteve dhe mbajtjes së takimeve me palët e interesit. ZrRE ka shqyrtuar dhe iu është përgjigjur në hollësi të gjitha komenteve të pranuarra nga palët, duke ofruar sqarime shtesë në harmoni me mandatin e përcaktuar nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë.
- c. ZrRE është institucion i pavarur dhe vepron në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Përcaktimi i tarifave të energjisë elektrike është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore që dalin nga Kapitulli IX i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe nenin 27 mbi Konsultimet.

- d. Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, palët e pakënaqura me Vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në lidhje me tarifave të rregulluara dhe metodologjinë e tarifave mund të iniciojnë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimin të Vendimit.

Koment i qytetarëve 1.5.4: Zgjidhje alternative pa rritje të tarifave

- a. Rishikimi i humbjeve të lejuara për KEDS dhe menaxhimi më i drejtë i investimeve për shërbime ndihmëse të KOSTT mund të shmangin rritjen e tarifave të energjisë. Këto humbje nuk duhet të bien mbi supet e qytetarëve, pasi ato nuk janë përgjegjësi e konsumatorëve, por rezultat i keqmenaxhimit të vetë operatorëve. Ashtu siç kompanitë private nuk ndajnë fitimet e tyre me qytetarët, po ashtu duhet të marrin përsipër edhe humbjet e tyre. Transferimi i këtyre kostove te konsumatorët është i padrejtë dhe cenon parimet e një tregu të drejtë dhe konkurrues. Prandaj, rritja e tarifave duhet të konsiderohet si mjeti i fundit, vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë për përmirësim të brendshëm të menaxhimit dhe efikasitetit të operatorëve.
- b. Qeveria ka përgjegjësinë të ofrojë zgjidhje për krizën në sektorin e energjisë, pasi dështimet e saj në këtë fushë kanë çuar në rritje të çmimeve dhe përkeqësim të standardit të jetesës së qytetarëve. Një nga alternativat më të drejta dhe të pranueshme është subvencionimi i energjisë nga buxheti i shtetit, ashtu siç është bërë edhe në të kaluarën. Ky mekanizëm do të ndihmonte në mbrojtjen e qytetarëve nga kostot e larta dhe do të shmangte barrën e padrejtë mbi konsumatorët, të cilët nuk mund të jenë përgjegjës për keqmenaxhimin dhe mungesën e investimeve në këtë sektor. Për më tepër, qeveria duhet të rishqyrtojë politikën e saj energjetike dhe të zbatojë masa afatgjata për stabilizimin e tregut dhe përmirësimin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike.

Përgjigjja e ZRrE 1.5.4:

- a. ZRrE ka rishikuar dhe ka refuzuar investimet që nuk janë justifikuar me dokumentacion përkatës. Vetëm kërkesat që përmbushin kriteret teknike dhe financiare janë pranuar. Sipas pikës nën 48, paragrafi 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE obligohet që gjatë caktimit të tarifave të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme.
- b. Sipas nenit 50 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE nuk ka kompetencë për të vendosur apo rekomanduar subvencione. Ky është vendim që i takon institucioneve të tjera përgjegjëse për politikën fiskale dhe sociale.

Koment i qytetarëve 1.5.5: Kërkesa jonë

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e mësipërme, kërkojmë me urgjencë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) që të:

- a. Të ndalojë menjëherë kërkesën për rritjen e çmimit të energjisë – Ky vendim është i pajustificueshëm dhe rëndon drejtpërdrejt mbi qytetarët, duke përkeqësuar standardin e tyre të jetesës.
- b. Të publikojë raportet financiare të KEDS dhe KESCO – Të dhënat nga viti 2020 tregojnë një fitim prej rreth 20 milionë eurosh nga këto kompani, ndërsa vitet e tjera janë fshehur pasqyrat

financiare. Ligji e detyron ZRrE-në të sigurojë transparencë mbi të ardhurat dhe shpenzimet e këtyre operatorëve për një analizë të qartë dhe të drejtë.

- c. Të zhvillojë konsultime publike gjithëpërfshirëse – Vendime të tilla me ndikim të madh duhet të përfshijnë qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që të arrihet një vendim i drejtë dhe i pranueshëm për të gjithë.
- d. Të shqyrtojë alternativa të tjera për stabilizimin e sektorit – Rritja e çmimeve nuk është e vetmja zgjidhje. Duhet shqyrtuar opsione të tjera, si subvencionimi nga buxheti i shtetit apo rishikimi i humbjeve të lejuara për operatorët privatë, duke siguruar që barra të mos bjerë mbi qytetarët.

ZRrE duhet të mbajë përgjegjësi për vendimet e saj dhe të veprojë në interes të publikut, duke mbrojtur konsumatorët nga vendime të padrejta që përkeqësojnë gjendjen ekonomike të familjeve dhe bizneseve në Kosovë.

Ky vendim ka pasoja të rënda për ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Prandaj, apelojmë për reflektim dhe vendimmarrje të drejtë, duke mbajtur në qendër interesin e popullit.

Përgjigjja e ZRrE 1.5.5:

ZRrE ka marrë parasysh të gjitha kërkesat e paraqitura në këtë koment dhe i trajton ato në përputhje me mandatin dhe kornizën ligjore që e rregullon funksionimin e institucionit.

Procesi i vendimmarrjes për përcaktimin e tarifave është shoqëruar me shqyrtim të komenteve nga mbi 400 qytetarë dhe palë interesi. ZRrE ka analizuar të gjitha aspektet teknike, financiare dhe rregullative të paraqitura gjatë konsultimit publik. Lidhur me konsultimet publike, ZRrE ka organizuar dhe zhvilluar disa takime me palë të interesit dhe mbetet e hapur për vazhdimin e komunikimit me publikun.

Në lidhje me kërkesën për shqyrtim të alternativave të tjera, ZRrE shqyrton me kujdes çdo propozim të pranuar gjatë konsultimit dhe, brenda mandatit të saj ligjor, vlerëson dhe bashkëpunon me institucione të tjera relevante për zgjidhje që kontribuojnë në një sistem energjetik të qëndrueshëm dhe të drejtë për të gjithë konsumatorët.

1.6 Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga një qytetarë.

Koment nga Qytetari 1.6.1:

Dua të shpreh një koment lidhur me raportin konsultativ të ZRrE-së për vitin 2025. Në raport, nuk u përmendën ndryshime specifike në pagat e punonjësve të OSSH-së, një pikë e rëndësishme për t'u shqyrtuar. Staf i kualifikuar duhet të vlerësohet në mënyrë të duhur dhe të mos lihet pas tregut të punës. Po ashtu, është e nevojshme të merret parasysh një rritje e pagave për të siguruar motivimin dhe stabilitetin e punonjësve në këtë periudhë të konkurrencës dhe ndryshimeve të tregut.

Përgjigjja e ZRrE 1.6.1:

ZRrE përkujdeset që shpenzimet e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes së kompanive të rregulluara të jenë të arsyeshme dhe të reflektojnë kushtet e tregut. Shpërndarja e shpenzimeve të personelit

është jashtë kompetencave të ZRrE-së dhe i takon menaxhmentit të kompanive të rregulluara. Gjithsesi, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike dhe mbeten të pandryshuara gjatë Përshtatjeve të Rregullta.

1.7 Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga një qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Koment nga Qytetari 1.7.1: Krahasimi me vendet e zhvilluara dhe ndikimi në përballueshmëri

Këto vendime të juajat nuk po iu shërbejnë qytetarëve të Kosovës, por kompanive në tregun energjetik, e kjo nuk ka se si të mohohet. P.sh në pretendimin tuaj se energjia elektrike në Kosovë është shumë më e lirë se në vendet e rajonit po ua shkruaj grafikisht krahasimin mes Kosovës Gjermanisë dhe Zvicrrës.

Në Gjermani ku paga minimale është 2,222€, çmimi për kW/h është e mesatarja e konsumit është nën 5000 kWh në muaj, e aty çmimi për KW nuk ndryshon mbi 800, 1000 etj ashtu si po ndryshon në Kosovë. Çmimi për kW në këtë vend është në Zvicërr ku paga minimale është 3425 CHF, çmimi për kW është 0,34c e konsumi mbetet përsëri nën 5500.

Në Kosovë çmimi i kW për orë dallon, e fillon me 0,08c në 800 kW e para, e kjo vetëm se rritet me konsumin që në Kosovë arrin deri në 2700 kW në muaj. Paga minimale!? 350€!!!!

Në krahasim të pagës mesatare; Një familje në Kosovë shpenzon rreth 14.9% të pagës së saj për energji elektrike, ndërsa në vendet si Zvicra, Gjermania, Holanda kjo përqindje është vetëm 2.94%. Në familjen time, me vetëm një të punësuar dhe me persona me sëmundje kronike, fëmijë të vegjël shtrenjtimi i përsëritur i energjisë elektrike do të ishte goditje e rëndë për secilën familje kur dihet se në Kosovë afro gjysma e popullsisë jetojnë në afërsi ose poshtë pagës minimale.

Përgjigjja e ZRrE 1.7.1:

ZRrE e kupton që përqindja e të ardhurave që qytetarët shpenzojnë për energji elektrike, dhe varfëria energjetike është një shqetësim i qytetarëve. Megjithatë, procesi i përcaktimit të tarifave nuk mund të bazohet në nivelin e të ardhurave të konsumatorëve, por në kosto të arsyeshme të operatorëve të licencuar për ofrimin e shërbimeve. Ky është një parim bazë i rregullimit tarifor sipas Ligjit Nr. 05/L-084. Politikat për mbrojtjen financiare, subvencionimet dhe ndihmën për familjet në nevojë nuk janë brenda mandatit të ZRrE-së.

Koment nga Qytetari 1.7.2: Çmimi i rrymës për banorët afër termocentraleve

Shtrenjtimi i rrymës për banorët e komunave që janë afër apo termocentralet gjendet në komunën e tyre do të ishte goditja e tretë fatale për ta, pas dëmtimit të shëndetit përmes ndotjes së ajrit, shtrenjtimit paraprak të energjisë elektrike dhe tashmë këtij të pretenduarit.

Para marrjes së vendimit kujtoni se nuk po i shërbeni fëmijëve tuaj me këtë vendim, po i dëmtoni ata dhe të ardhmen e tyre, e po shkatërroni Kosovën. Energjia elektrike kur shtrenjtohet do shtrenjtohen edhe produktet bazë. Po e mbysni Kosovën, po e zbrazni nga mendjet e ndritura që e dinë të keqen që i vie Kosovës mbas vendimit tuaj.

Përgjigja e ZRrE 1.7.2:

Në bazë të nenit 45 për Ligjin e Rregullatorit të Energjisë, “*çmimet të cilat ngarkohen nga ajo në cilëndo kohë dhe për cilindo konsumator fundor për furnizimin e energjisë të jenë të njëjta me çmimet të cilat janë ngarkuar nga ajo ndërmarrje e energjisë në të njëjtën kohë për konsumatorët e tjerë fundor për furnizimin e krahasueshëm me energji, pavarësisht se ku ndodhen apo banojnë këta konsumatorë fundor.”.* Rrjedhimisht ZRrE nuk mund të përcaktojë tarifën mbi bazën e vendndodhjes së konsumatorit.

1.8 Komente nga qytetari X.X. (e redaktuar)

Komentin më poshtë ZRrE e ka pranuar nga disa qytetarë.

Koment i qytetarëve 1.8.1:

Me këtë email shpreh kundërshtimin e rritjes së energjisë për 15%. E kuptoj se konsumi i energjisë është rritur shumë por kjo nuk duhet të rezultoj në rritjen e çmimit të saj. Grafiku në Trading Economics i shteteve të BE-se për çmimin e energjisë tregon krejt diçka ndryshe me atë që ju po dëshironi ta bëni. Çmimi i energjisë ishte më i lartë në Tetor të vitit 2022, e pas asaj kohe ka rënë çmimi për rreth 11.7% (edhe pse vazhdon të jetë i shtrenjtë). Këto të dhëna i gjeni në linkun në vazhdim: <https://tradingeconomics.com/euro-area/energy-prices>

Prandaj, ju lutem mos vazhdoni me këtë vendim pasi do të shkaktoj shumë dëme tek prodhuesit e shumë më shumë tek konsumatorët.

Përgjigja e ZRrE 1.8.1:

ZRrE e ka ndjekur nga afër zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të energjisë si dhe në kostot për kapacitete ndërkufitare. Rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2022 dhe 2023 mbuluar pjesërisht përmes subvencioneve direkte nga Qeveria e Kosovës. Rrjedhimisht jo e gjithë rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të energjisë është reflektuar në rritje të çmimit në Kosovë. Gjatë vitit 2024 ZRrE duke u bazuar në këto trende ka parashikuar çmim më të ulët të importit të energjisë elektrike, e cila është reflektuar në zbritjen e tarifave. Çmimet e realizuara në tregjet ndërkombëtare në vitin 2024 ishin më të larta se ato të parashikuara. Gjithashtu edhe kostot për kapacitete ndërkufitare janë rritur mbi parashikimet e ZRrE (shih figurat në 1.5 Komente nga qytetarët). Parashikimet e ZRrE për çmimin e importit (duke përfshirë kostot ndërkufitare) të vitit 2025 edhe pse janë më të larta se parashikimet e ZRrE për çmimet e vitit të vitit 2024 (mbi të cilat janë caktuar tarifën e vitit 2024), ato janë më të ulëta se çmimet e realizuara (apo reale) gjatë vitit 2024, dhe reflektojnë gjendjen reale të pritshme të tregut, bazuar në analizën e tregjeve avanc (HUDX) dhe kostot e kapaciteteve ndërkufitare.

1.9 Komente nga qytetarët

Komentet më poshtë ZRrE i ka pranuar nga disa qytetarë. Në vijim, adresohen secila nga pikat e ngritura.

Koment i qytetarëve 1.9.1:

Argumenti kryesor është se ZRrE ka përdorur vetëm një nga shumë opsionet e mundshme, duke mos marrë parasysh të gjitha mundësitë që mund të ishin më të favorshme për kontekstin socio-ekonomik të Kosovës. Ky opsion, megjithëse teknikisht mund të duket i arsyeshëm, nuk është i përshtatshëm për situatën aktuale të vendit, sepse do të provokojë dhe shkaktojë një valë të re inflacioni që do të ketë pasojë të pariparueshme për ekonominë dhe përjetimin e qytetarëve. Një rritje e mëtejshme e tarifave do të rrisë barrën mbi konsumatorët duke cenuar fuqinë e blerjes dhe standardin e jetesës të qytetarëve të Kosovës.

Koment i qytetarëve 1.9.2:

ZRrE ka propozuar zgjidhjen më të përshtatshme teknike, që siguron energji të mjaftueshme dhe merr parasysh kapacitetet gjeneruese, eksperiencat me gjenerim (sidomos tremujorin e fundit), si dhe kërkesat aktuale. Si e tillë, kjo zgjidhje ka për qëllim të rrisë sigurinë dhe furnizimin energjetik gjatë vitit 2025, duke garantuar një përputhshmëri optimale me nevojat e energjisë të vendit.

Koment i qytetarëve 1.9.3:

Derisa zgjidhja dhe propozimi i ZRrE janë teknikisht të duhur, ajo vjen me kosto të jashtëzakonshme për shoqërinë dhe ekonominë. Nëse kostoja e propozimit të ofruar është rritja e çmimit të energjisë, e cila pastaj ka një efekt zinxhiror në të gjitha produktet dhe shërbimet e vendit, kjo kosto është e papërbalueshme për shumicën e qytetarëve dhe bizneset.

Koment i qytetarëve 1.9.4:

Kjo valë e re inflacioni që propozimi i ZRrE mund të shkaktojë, nuk ndodh e izoluar. Ky është vendimi i tretë brenda pak viteve për rritjen e koston së energjisë, dhe ai vjen pas inflacionit më të madh historik në dekadat e fundit, i cili ka gjunjëzuar ekonominë dhe ka përgjysmuar fuqinë blerëse të familjeve dhe qytetarëve. Një valë e re inflacioni ka një ndikim shumë më të madh se një rritje prej 15%, sepse ajo ndodh në majën e një periudhe inflacioni të rënduar që nga viti 2021. ZRrE duhet ta shohë vendimin e saj jo të izoluar në fatura, por si një ndikim real socio-ekonomik dhe dëm që do t'i shkaktojë ekonomisë, bizneseve, prodhuesve dhe qytetarëve të Kosovës.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.1, 1.9.2, 1.9.3, dhe 1.9.4:

Propozimi për përshtatjen e të hyrave të lejuara bazohet në analizat e shpenzimeve kapitale dhe operative, koston së kapitalit, normave të zhvlerësimit dhe përmirësimit të efikasitetit gjatë shqyrtimeve periodike. Neni 48, paragrafi 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, obligon ZRrE që gjatë caktimit të tarifave të të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme.

ZRrE nuk mund të përcaktojë tarifën duke u bazuar në të ardhura individuale apo struktura sociale. ZRrE nuk ka mandat për të përcaktuar politika ekonomike, fiskale, sociale apo subvencione.

Koment i qytetarëve 1.9.5:

Kostoja më e lartë e energjisë në vitin 2021 ka qenë 6.76 cent (tarifa e lartë). Rritja e parë e ka çuar këtë tarifë në 12.52 cent në vitin 2022. Në vitin 2023, çmimi ka shkuar në 14.45 cent, ndërsa në vitin 2024 ka pasur një rënie të lehtë në 13.29 cent. Me rritjen e propozuar prej 15%, tarifa e lartë do të arrijë rreth 15.28 cent, që përfaqëson një rritje prej 126% krahasuar me vitin 2021. Kjo rritje nuk është


në përputhje me standardin e jetesës dhe nuk korrespondon me rritjen e pagave, duke e bërë të pamundur për shumë qytetarë të përballojnë këtë kosto të rritur të energjisë.

Përgjigjja e ZRrE 1.9.5:

Implementimi i bllok tarifave është bërë me synim që të promovohet efienca e energjisë, të bëhet alokim i drejtë për të gjithë qytetarët i energjisë së prodhuar nga KEK, si dhe të reflektohen çmimet e importit tek konsumatorët që shpenzojnë më shumë se sasia e alokuar e kapaciteve vendore.

Analiza e ndryshimeve të tarifave të energjisë duhet të bëhet në tërësi dhe jo në mënyrë selektive. Të gjithë konsumatorëve u ofrohet konsumi i 800 kWh në muaj me çmime që reflektojnë kostot e sistemit të bazuar në gjenerim vendor. Vetëm konsumi mbi energjinë e alokuar faturohet me çmime të afërta me kostot e importit. Përgjatë 5 viteve të fundit (2020 – 2024) çmimi mesatar për konsumatorë shtëpiak është rritur nga 5.67 €cent/kWh në 7.39 €cent/kWh, apo për 31%. Rrjedhimisht është e pasaktë marrja për bazë e vetëm njëres nga elementet e tarifave, dhe mos marrja parasysh e çmimeve për pjesën e parë të konsumit.

Figura: Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorë dhe rritja e çmimit mesatar nga 2020 - 2024



Koment i qytetarëve 1.9.6:

Argumenti se “Kosova ka koston më të lirë të energjisë në rajon” vlen vetëm nëse analizohet në mënyrë të izoluar. Në realitet, kur merret parasysh fuqia blerëse e qytetarëve, të ardhurat mesatare dhe bruto produkti vendor për kokë banori, pamja ndryshon tërësisht. Me rritjen e propozuar prej 15%, Kosova do të ketë një nga kostot më të larta të energjisë jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë. Kostoja mesatare e energjisë do të arrijë në rreth 8.8 cent për kilovat, por kur kjo shifër krahasohet me BPV për frymë, rezulton se Kosova e ka rreth 63.5% më të shtrenjtë energjinë sesa Mali i Zi (pas rritjes). Kur krahasohen çmimet e produkteve dhe shërbimeve, patjetër që duhet të përfshihet edhe kapaciteti real i shpenzimit, fuqia blerëse e publikut.

Koment i qytetarëve 1.9.7:

Kur argumentohet se “Kosova ka energjinë më të lirë në Evropë”, një pohim i tillë del të jetë i pajustificueshëm në praktikë. Nëse paga mesatare e një qytetari evropian është 5,000 euro dhe fatura mujore e energjisë është 100 euro, atëherë kostoja e energjisë përfaqëson vetëm 2% të të ardhurave


mujore. Në anën tjetër, nëse paga mesatare në Kosovë është 500 euro dhe fatura mujore e energjisë po ashtu është 100 euro, atëherë pesha e kësaj kostoje për qytetarin kosovar është 20% e të ardhurave mujore. Ky dallim është jashtëzakonisht i madh dhe i pamohueshëm. Prandaj, kur ZRrE përdor krahasime të tilla (si grafikoni i paraqitur në komunikatën për propozimin e rritjes prej 15%) duhet të jetë më sensitive dhe gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh komponentët e tjerë të ekonomisë, si standardi i jetesës, të ardhurat reale dhe mbi të gjitha, fuqia reale blerëse e qytetarëve.

Përgjigja e ZRrE për 1.9.6 dhe 1.9.7:

Detyra e ZRrE-së është të sigurojë funksionim të qëndrueshëm të sektorit energjetik përmes përcaktimit të tarifave të cilat pasqyrojnë kostot e arsyeshme të operatorëve, të mbrojnë konsumatorët nga abuzimet në treg si dhe nga shpenzimet apo fitimet e pa arsyeshme të operatorëve të rregulluar. ZRrE nuk është përgjegjëse për përcaktimin e politikave të të ardhurave, pagave apo për masat mbrojtëse financiare për grupet në nevojë. ZRrE është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha institucionet për hartimin e programeve për konsumatorët e cenueshëm apo të prekur nga varfëria energjetike.

Në tregje të integruara, siç është tregu energjetik i Kosovës me vendet e rajonit, çmimet e produkteve të njëjta (energji elektrike në këtë rast) kanë tendencë të afrohen. Grafikoni i përdorur nga ZRrE në hapje të procesit konsultativ, si dhe figura më poshtë paraqiten për të treguar që çmimet e energjisë në Kosovë, edhe pas rritjes janë në linjë me çmimet e energjisë në rajon, por dukshëm më ultë se çmimet e energjisë në tregjet Evropiane me të cilat synojmë të integrohemi.

Figura: Çmimi mesatar i energjisë elektrike në Ballkanin perëndimorë gjatë vitit 2024 (pa taksa)



Koment i qytetarëve 1.9.8:

ZRrE ka një detyrim ligjor për të dialoguar me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, sidomos kur hap për konsultim publik raporte dhe propozime për çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, siç është rritja e tarifave të energjisë. Megjithatë, që nga fillimi i këtij procesi, ZRrE ka dhënë shenja dhe indikatorë publikë e zyrtarë që sugjerojnë mungesë interesi real për konsultime dhe për të dëgjuar mendimet e palëve të tjera. Komunikimet zyrtare kanë lënë përshtypjen se vendimi është tashmë i marrë, me qëndrime të tipit: “do të shihet vitin tjetër.” Kjo metodë është jo profesionale dhe nuk përputhet me standardet e transparencës dhe pjesëmarrjes, sepse dekurajon

hisedarët dhe publikun nga pjesëmarrja aktive, ashtu siç kërkohet me ligj, për të dërguar propozime dhe komente mbi vendimin e propozuar.

Koment i qytetarëve 1.9.9:

Tendenca për të dekurajuar publikun nga pjesëmarrja në procesin konsultativ ka ndikim negativ, sepse pikërisht aty mund të gjenden propozime dhe komente të vlefshme që ndihmojnë Rregullatorin të gjejë zgjidhjet më të drejta dhe të balancuara. Një qasje përjashtuese jo vetëm që dëmton legjitimitetin e procesit, por mund të jetë edhe kundërligjore, marrë parasysh që ligji që themelon ZRrE kërkon që ky institucion të jetë transparent, të konsultojë publikun, dhe të ndërmarrë vendime që janë të arsyeshme.

Përgjigja e ZRrE për 1.9.8 dhe 1.9.9:

ZRrE ka përmbushur në përpikmëri obligimet që dalin nga neni 27 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Raportet konsultative me argumente mbështetëse janë publikuar nga ZRrE si dhe janë ftuar të gjitha palët për të dhënë komentet e tyre. ZRrE ka pranuar mbi 400 komente nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sindikatat, bizneset, institucionet vendore dhe deputetët dhe nga të licensuarit. ZRrE e vlerëson lartë kontributin e të gjithë komentuesve në proces dhe të gjitha komentet e dërguara janë shqyrtuar në detaje si dhe janë përfshirë në vendimmarrjen përfundimtare. Rregullatori gjithashtu ka mbajtur takime bilaterale me organizatat e shoqërisë civile, mediat, Avokatin e Popullit, institucionet vendore, dhe të licensuarit. Komentet gjatë këtyre diskutimeve janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtij raporti.

Koment i qytetarëve 1.9.10:

Neni 1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, përveçse përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, e obligon ZRrE-në të sigurojë mbrojtjen e konsumatorit. Rrjedhimisht, çdo rritje e tarifave duhet të analizohet edhe në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe situatës ekonomike aktuale. Një rritje tjetër e çmimit të energjisë elektrike, në një periudhë pas një inflacioni historikisht të lartë, ku çmimet e produkteve bazike janë rritur deri mbi 100%, krijon pasiguri shtesë dhe cenon drejtpërdrejt interesin e konsumatorëve.

Përgjigja e ZRrE për 1.9.10:

Detyra e ZRrE-së është të sigurojë funksionim të qëndrueshëm të sektorit energjetik përmes përcaktimit të tarifave të cilat pasqyrojnë kostot e arsyeshme të operatorëve (Kapitulli IX i Ligji për Rregullatorin e Energjisë), të mbrojnë konsumatorët nga abuzimet në treg si dhe nga shpenzimet apo fitimet e pa arsyeshme të operatorëve të rregulluar. ZRrE nuk është përgjegjëse për përcaktimin e politikave të të ardhurave, pagave apo për masat mbrojtëse financiare për grupet në nevojë. Për më tepër sipas nenit 50 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE nuk ka kompetenca të hartojë apo të implementojë skema të përkrahjes financiare për konsumatorët. ZRrE është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha institucionet për hartimin e programeve për konsumatorët e cenueshëm apo të prekur nga varfëria energjetike.

Koment i qytetarëve 1.9.11:

Neni 13 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë e obligon ZRrE-në të bashkëpunojë me persona apo organizata që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e konsumatorëve. Jo vetëm në këtë proces konsultativ, por edhe në raportet e viteve të kaluara, shihet qartë se ZRrE nuk i ka marrë parasysh rekomandimet dhe nuk ka përfshirë në mënyrë efektive Organizatën për Mbrojtjen e Konsumatorëve, e cila përfaqëson interesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në raport me tarifën dhe shërbimet energjetike. Kjo përbën një mospërputhje me detyrimet ligjore të Rregullatorit dhe dëmton legjitimitetin e procesit vendimmarrës në raport me interesin publik.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.11:

Të gjitha raportet konsultive, komentet e palëve të interesit dhe përgjigjet e ZRrE-së mbi to që nga viti 2007 janë të publikuara në faqen e konsultimeve publike e cila mund të qaset duke klikuar [këtu](#). Në këtë proces konsultativ ZRrE ka mbajtur takim bilateral me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe avokatin e popullit. ZRrE analizon me kujdes të gjitha komentet e palëve dhe në kuadër të kompetencave të saj merr parasysh implementimin e rekomandimeve të arsyeshme.

Koment i qytetarëve 1.9.12:

Neni 15, pika 1.5 e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë kërkon që ZRrE të sigurojë se tarifën e rregulluar për aktivitetet e energjisë janë të arsyeshme. Arsyeshmëria nuk mund të kufizohet vetëm në aspektin teknik apo financiar të operatorëve, por duhet të shtrihet edhe në dimensionin socio-ekonomik, duke marrë parasysh nëse tarifën janë të përballueshme për qytetarët, në përputhje me fuqinë e tyre blerëse, nivelin e të ardhurave dhe bruto produktin vendor për kokë banori. Vetëm në këtë mënyrë tarifën mund të konsiderohen realisht të arsyeshme dhe në përputhje me interesin publik.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.12:

Neni 48, paragrafi 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë thotë që kërkon që gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, Rregullatori do të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme. ZRrE kujdeset që kostot në bazë të të cilave vendosen tarifën e rregulluar të jenë të arsyeshme dhe të drejta. ZRrE nuk mund të përcaktojë tarifën duke u bazuar në të ardhura individuale apo struktura sociale. ZRrE nuk ka mandat për të përcaktuar politika ekonomike, fiskale, sociale apo subvencione.

Koment i qytetarëve 1.9.13:

Neni 10, pika 1.1 e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë përmend qartë detyrat dhe kompetencat e Rregullatorit, duke përfshirë në veçanti monitorimin e konkurrencës dhe transparencës në tregjet e energjisë në Kosovë. Megjithatë, ZRrE nuk i ka publikuar raportet vjetore financiare të OSSH/KEDS, gjë që e bën procesin e konsultimit të vështirë dhe vendosjen e të hyrave maksimale të lejuara të pamundur për t'u kuptuar nga publiku dhe hisedarët. Pa transparencë në këtë aspekt, është e vështirë të vlerësohen humbjet e lejuara apo të kuptohen investimet e obliguara. Mungesa e këtij informacioni dëmton besimin publik dhe reputacionin e Rregullatorit, si dhe të aktorëve kyç në ekosistemin e energjisë të rregulluar nga ZRrE.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.13:

Neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë thotë që Raporti Vjetor i publikuar nga ZRrE duhet të përmbajë (ndër të tjera), analizën e zhvillimeve brenda fushëveprimit të funksioneve, detyrave dhe kompetencave të Rregullatorit, duke përfshirë në veçanti rezultatet e monitorimit mbi zhvillimet e konkurrencës dhe transparencës në tregjet e energjisë në Kosovë. ZRrE

në raportet vjetore i përfshinë të gjitha këto analiza. Publikimi dhe auditimi i pasqyrave financiare statutare të operatorëve në Kosovë nuk është përgjegjësi e ZRrE, por e organeve kompetente për auditim dhe publikim.

Koment i qytetarëve 1.9.14:

Neni 2, pika 1 e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë vendos fokusin tek nevoja për të konsideruar ndikimin socio-ekonomik dhe standardin e jetesës në tërë Kosovën. Ky nen kërkon që zbatimi i masave të jetë i përshtatshëm për përforsimin e kohezionit social dhe ekonomik, që do të thotë se çdo vendim për tarifën duhet të vlerësohet jo vetëm nga aspekti teknik apo financiar, por edhe në funksion të ndikimit real në jetën e qytetarëve, në barazinë sociale dhe në stabilitetin ekonomik të vendit.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.14:

Neni që po i referoheni besojmë është neni 15 pika 2.1. ZRRE rregullon tarifën në përputhje të plotë me Kapitullin IX të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Për të siguruar kohezionin social dhe ekonomik në tërë Kosovën, ZRRE sigurohet që tarifën të jenë jo-diskriminuese, dhe se çmimet të cilat ngarkohen nga operatorët e rregulluar në cilëndo kohë dhe për cilindo konsumator fundor për furnizimin e energjisë të jenë të njëjta me çmimet të cilat janë ngarkuar nga ajo ndërmarrje e energjisë në të njëjtën kohë për konsumatorët e tjerë fundor për furnizimin e krahasueshëm me energji, pavarësisht se ku ndodhen apo banojnë këta konsumatorë fundor.

Koment i qytetarëve 1.9.15:

Neni 15, paragrafi 1.9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë kërkon që të sigurohet balancimi i interesave ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë në mënyrë adekuate, si dhe që të mbrohen konsumatorët në nevojë. Kjo dispozitë e obligon ZRrE-në të vlerësojë ndikimin e tarifave në aspektin socio-ekonomik. Fakti që rregullatori vazhdimisht po rrit barrën financiare mbi konsumatorët, përmes rritjes së faturave, ndërkohë që nuk publikon fitimet reale të ndërmarrjeve, ngre pikëpyetje serioze mbi zbatimin e drejtë të këtij neni dhe mbi balancën reale që ZRrE duhet të ruajë ndërmjet interesit publik dhe atij të operatorëve komercialë.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.15:

Neni 49 i Ligjit për Energjinë elektrike, përcakton qartë kompetencat e Qeverisë dhe ZRrE-së në lidhje me definimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. ZRrE ka bashkëpunuar dhe vazhdon të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjithë hisedarët në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. ZRrE përmes [Rregullës për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë](#), në bashkëpunim me Furnizuesin Universal i mbron konsumatorët në nevojë nga shkyqja për mospagesë të faturave të energjisë elektrike. Neni 47, paragrafi 3, nënparagrafi 3.5 i Ligjit për Rregullatorin e obligon ZRrE-në që të mos e përcaktoj asnjë tarifë nën koston reale të ofrimit të shërbimit.

Koment i qytetarëve 1.9.16:

Neni 15, paragrafi 7.5 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë të institucionit, kërkon që të gjithë shfrytëzuesit aktualë apo potencialë të sistemit të konsultohen në mënyrë të hapur dhe transparente. Kjo dispozitë nënvizon qartë detyrimin për përfshirjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes për tarifën dhe planet e investimit,

duke garantuar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe të kuptueshëm që reflekton realisht interesin publik, dhe jo vetëm nevojat teknike apo financiare të operatorëve.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.16:

ZRrE ka pranuar dhe analizuar në detaje komentet nga mbi 400 qytetarë dhe biznese (shfrytëzues aktual apo potencial të sistemit), organizata jo qeveritare dhe institucione vendore. Për më tepër ZRrE ka mbajtur edhe konsultime bilaterale me të gjitha palët e interesit. ZRrE brenda mandatit të saj dhe në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë ka reflektuar këto komente në procesin e përshtatjeve të rregullta.

Koment i qytetarëve 1.9.17:

Sipas raporteve konsultative, një ndër arsyt kryesore pse po propozohet rritja e tarifave të energjisë lidhet me kapacitetet dhe stabilitetin gjenerues të KEK-ut, sidomos gjatë tremujorit të fundit të vitit, kur rritet nevoja për import nga jashtë, ku çmimet janë rreth pesë herë më të larta. Po ashtu, faktorë shtesë janë investimet në sektor, përfshirë iniciativën për krijimin e rezervave energjetike në kuadër të shërbimeve ndihmëse. Ekuilibri dhe menaxhimi i këtyre tri proceseve, (a) prodhimi i brendshëm, (b) importi dhe (c) investimet, përbëjnë sfidën qendrore që çon në rritjen e kostos së propozuar. Rrjedhimisht, zgjidhja duhet të jetë e matur, e mirëmenaxhuar dhe e përshtatur me kontekstin socio-ekonomik të Kosovës.

Koment i qytetarëve 1.9.18:

Në raportet konsultative dhe në kërkesat e KEDS dhe KESCO, disa herë është theksuar se KEK ka devijuar nga plani i gjenerimit të energjisë, dhe se në momente të fundit, me njoftime afatshkurtra, ka informuar për dështimin në sigurimin e energjisë së planifikuar dhe të dakorduar me palët përkatëse. Roli i KEK-ut është thelbësor në zinxhirin e furnizimit me energji. Megjithatë, duket se ZRrE, në vend që të kërkojë përgjegjësi dhe përmirësim të efikasitetit të KEK-ut, ka hequr dorë nga ky dimension, duke zgjedhur që si zgjidhje të mbështetet në importin e energjisë, dhe kështu e ka zhvendosur barrën financiare te konsumatori. Kjo qasje, përveç që dobëson rolin e prodhimit të brendshëm, rrit edhe varësinë nga tregjet ndërkombëtare dhe çënon qëndrueshmërinë energjetike të vendit.

Koment i qytetarëve 1.9.19:

Në këtë kontekst, duhet pasur parasysh se KEK ka kaluar në një periudhë krize menaxheriale, nën presion publik dhe juridik pas arrestimeve dhe hetimeve që lidhen me zyrtarë të lartë të ndërmarrjes. Kjo situatë ka krijuar pasiguri dhe ka ndikuar që KEK ndoshta të mos jetë menaxhuar me kapacitetin dhe efikasitetin maksimal. Megjithatë, ZRrE nuk duhet të heqë dorë nga përpjekjet për të nxjerrë kapacitetet maksimale të mundshme nga KEK, edhe duke marrë parasysh vjetërsinë e Termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe përqendrimi në zgjidhje të qëndrueshme për furnizim të brendshëm janë thelbësore, në mënyrë që të sigurohet stabilitet energjetik me kosto të përballueshme për qytetarët, pa qenë e nevojshme rritja e re e tarifave.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.17, 1.9.18 dhe 1.9.19:

ZRrE pajtohet që prodhimi vendor dhe blerja e energjisë nga KEK përmes Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë, është një nga faktorët kryesorë gjatë analizës së përcaktimit të tarifave. Megjithatë ZRrE

thekson që sasia e prodhimit, menaxhimi, si dhe çmimi i shitjes nga KEK apo cilido prodhues nuk është subjekt i rregullimit nga ZRrE pas liberalizimit të tregut me shumicë (2017). ZRrE sigurohet që të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike të ofrojnë kapacitetet e tyre në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg, si dhe që prodhuesit e licensuar i përmbushin obligimet që rrjedhin nga Neni 7 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Për më shumë informata ju lutem referojuni [Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut](#).

Koment i qytetarëve 1.9.20:

Kosova ka nevojë të importojë dhe eksportojë energji, por kjo duhet të bëhet duke pasur parasysh barrën dhe koston sociale e ekonomike që kjo sjell për qytetarët dhe për ekonominë e vendit. Gjithashtu, investimet në rezerva energjetike duhet të realizohen vetëm kur kushtet janë optimale, dhe kur ato nuk përkthehen në kosto të larta për publikun. Rritja e investimeve në 43 milionë euro shtesë në kuadër të shërbimeve ndihmëse mund të jetë një strategji e qëndrueshme në parim, por vetëm nëse barra e saj nuk rëndon ekonominë. Nëse ky investim nënkupton rrezikun e një vale të re inflacioni, atëherë vendimi duhet të shtyhet për një periudhë më të përshtatshme, kur ndikimi i tij të jetë më i përballueshëm për shoqërinë dhe qytetarët.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.20:

Sistemi elektro-energjetik në çdo moment duhet të jetë i balancuar në aspektin e prodhimit dhe konsumit. Devijimet si pozitive apo negative, mund të shkaktojnë pasoja të mëdha në sistem prej devijimit të frekuencës, e deri te kolapsimi i sistemit. Shërbimet ndihmëse mundësojnë balancimin e sistemit në periudha të ndryshme kohore.

Arsyeja kryesore e rritjes së koston së shërbimeve ndihmëse vjen nga rritja e kontraktimit të kapaciteteve aFRR dhe mFRR si pasojë e kërkesave të ENTSO-E për përmirësim të balancimit të sistemit. Rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga OST e Shqipërisë. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e marra për aFRR janë 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me Palën Ofruese të Shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MW për ngritje dhe -50 MW për zbritje. ZRRE ka monitoruar këto kosto dhe janë në përputhje me çmimet e tregut për këto shërbime.

Pra vlenë të theksohet që kostot prej €43 milionë për shërbime ndihmëse nuk janë investime, por janë shpenzime të nevojshme dhe kritike për operimin dhe balancimin e sistemit elektro-energjetik në kuadër me kërkesave nga ENTSO-e.

Koment i qytetarëve 1.9.21:

Rritja dramatike e humbjeve në 86.65 milionë euro, si pasojë e rritjes së importit të energjisë, ka pasoja të mëdha për sistemin energjetik dhe për konsumatorin final. Veçanërisht shqetësuese është mungesa e transparencës, pasi publiku nuk ka qasje në raportet financiare të operatorëve, për të kuptuar saktësisht sa janë blerjet faktike të energjisë dhe cilat janë humbjet reale. Kjo mungesë transparence e bën të vështirë vlerësimin objektiv të kërkesave për humbje të lejuara. Kërkesa e KEDS për vitin 2025 në vlerë prej 102 milionë euro, dhe propozimi i ZRrE në 86.65 milionë euro nga 69.69 milionë euro të planifikuara në dokumentin strategjik PRR3 përbëjnë një barrë të lartë që ndikon drejtpërdrejt në

propozimin për rritjen e çmimit të energjisë. ZRrE duhet të kërkojë që humbjet e KEDS të jenë më të menaxhueshme dhe të kërkojë respektimin e planit strategjik të miratuar nga vetë rregullatori, në lidhje me humbjet dhe të hyrat e lejuara maksimale, në kuadër të dokumentit PRR3.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.21:

Gjatë shqyrtimeve shumëvjeçare (PRR3), ZRrE vendosë caqet e reduktimit të humbjeve (Humbjet/Bruto konsumi në nivel të operatorit) për OSSH dhe OST. Këto vlera vendosen duke marrë parasysh planin investiv të të licensuarve, dhe duke konsideruar balancin në mes të përfitimeve nga reduktimi i humbjeve si dhe kostot për investime. Raporti për humbjet e lejuara është i publikuar në ueb-faqen e ZRrE-së dhe i njëjti mund të qaset [këtu](#). Në raport vërehet se për OSSH janë përcaktuar caqe më ambicioze krahasuar me propozimet fillestare të vetë operatorit. Caqet e miratuara janë në harmoni me objektivat e Strategjisë së Energjisë 2022–2031. Ju lutem referojuni [Raportit Konsultativ të OSSH](#), kapitulli 2.1 për nivelin e rishikuar të humbjeve, pas integritit të sistemit energjetik me 4 komunat veriore të vendit.

Tabela:10 Caku i reduktimit të humbjeve për OSSH (2023-2027)⁴

Viti	PRR3					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Humbjet aktuale - parashikimi	16.9%					
Propozimi i OSSH-së (propozimi fillestar)		16.9%	16.9%	15.7%	14.5%	13.3%
Propozimi i OSSH-së (rishikim)		15.1%	15.1%	15.1%	14.2%	13.3%
Propozimi i ZRRE-së		15.1%	14.7%	13.3%	12.1%	11.1%
Caku vjetor i reduktimit të humbjeve		0	-0.4	-1.4	-1.2	-1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve		50%	0%	0%	0%	0%

ZRrE gjatë shqyrtimeve periodike lejon kompenzim vetëm për sasi të humbjeve (në përqindje) brenda caqeve të caktuara në shqyrtime periode. Nëse humbjet nga operatorët tejkalojnë caqet e përcaktuara ato nuk njihen në tarifa dhe kostot i bartë operatori. ZRrE gjithashtu analizon në detaje të dhënat energjetike dhe të dhënat mbi blerjet e energjisë për humbje, dhe sigurohet që këto reflektojnë çmimet e tregut në të cilin operojnë operatorët.

Në këtë shqyrtim periodik, ZRrE përshtat kostot si dhe sasi të blerjeve në bazë të informatave më të reja të tregut që ka për kostot e realizuara të vitit 2024 dhe parashikimet për vitin 2025, por duke ruajtur vlerën e caktuar të aprovar të humbjeve.

Koment i qytetarëve 1.9.22:

Investimet në veri dhe rritja e pagës minimale janë ndër faktorët shtesë që përdoren si arsye në kërkesat dhe propozimet për rritjen e tarifave. Ndërsa rritja e pagës minimale përfaqëson një kosto që nuk mund të injorohet, investimet në veri të vendit, për të cilat ngarkohen qytetarët në rajone dhe komuna të tjera, duken të padrejta dhe jo të përshtatshme. Pse duhet një qytetar që jeton në Kamenicë të paguajë për investime që realizohen në Leposaviq? ZRrE duhet të shqyrtojë me kujdes këto shpenzime dhe investime, dhe të kërkojë mënyra alternative për financimin e tyre, në mënyrë që

⁴ Kapitulli 4.2 i Raportit Përfundimtar për Cakun e Humbjeve: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf

të mos dëmtohet publiku dhe të mos ngarkohet padrejtësisht qytetari që nuk përfiton drejtpërdrejt nga këto projekte.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.22:

Neni 45, paragrafi 1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë obligon ndërmarrjet e energjisë që çmimet të cilat ngarkohen nga ato, duhet të jenë të njëjta për të gjithë konsumatorët, pavarësisht se ku ndodhen apo banojnë këta konsumatorë fundorë. OSSH-së nuk i lejohet të caktojë tarifa të ndara për shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë për rajone të ndryshme të Kosovës.

Koment i qytetarëve 1.9.23:

ZRrE, në këtë kontekst, duhet të angazhohet që mjetet e marra padrejtësisht nga qytetarët e Kosovës për të paguar energjinë e konsumuar në veri të kthehen. Ashtu sikurse rregullatori po angazhohet për të propozuar rritje të tarifave për të mbuluar kostot e operatorëve, po aq duhet të mbrojë edhe interesin dhe të drejtat e publikut dhe konsumatorit. Mjetet që janë marrë në mënyrë joligjore duhet të kthehen sa më parë tek konsumatorët, ose të zbriten nga faturat e tyre, për të siguruar drejtësi dhe balancë në qasjen e rregullatorit ndaj qytetarëve dhe operatorëve energjetikë. Ky mund të jetë një mekanizëm shtesë për të kompenzuar shpenzimet e propozuara, duke ulur barrën mbi konsumatorin dhe duke siguruar që kontributi i qytetarëve të mos shndërrohet në ndëshkim të padrejtë, por në një instrument lehtësimi apo kompensimi real, në përputhje me kostot që po shtohen në sistemin energjetik.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.23:

Kjo është adresuar në vendimin e ZRrE-së konform Vendimit të Gjykatës Kushtetuese ku është vendosur që këto mjete t'ju kthehen qytetarëve. Vendimi i ZRrE-së është apeluar nga KEDS dhe është në proces gjyqësor.

Koment i qytetarëve 1.9.24:

Në parim, arsyeja kryesore pse Rregullatori i Energjisë po propozon rritjen e tarifave për vitin 2025 është rritja e të hyrave të lejuara maksimale për operatorët KEDS, KESCO dhe KOSTT. Rrjedhimisht, kjo është edhe arsyeja kryesore pse po kërkohet rritja e çmimit të energjisë elektrike. Nëse ky është shkaktari kryesor, atëherë pikërisht në këtë pikë duhet të kërkohen zgjidhjet duke analizuar mundësitë për optimizim të kostove brenda operatorëve, rritje të transparencës në shpenzime, dhe bashkëpunim me Qeverinë për forma alternative të mbështetjes, pa e ngarkuar drejtpërdrejt qytetarin.

Koment i qytetarëve 1.9.25:

Në procesin konsultativ, KEDS ka kërkuar të hyra të lejuara maksimale për vitin 2025 në vlerë prej 217.74 milionë euro, që përfaqëson një rritje dramatike krahasuar me vlerën prej 120.592 milionë euro në vitin 2024. Kjo kërkesë është dukshëm më e lartë edhe sesa vlera e planifikuar në dokumentin strategjik afatmesëm të ZRrE (PRR3), ku për KEDS janë aprovuar vetëm 133.075 milionë euro. Rritja e të hyrave të lejuara e propozuar nga vetë ZRrE për vitin 2025 është 36.44% më e lartë se plani i PRR3, ndërsa kërkesa e KEDS është 63.62% më e lartë se sa është parashikuar në dokumentin strategjik të vitit 2023. Këto diskrepanca janë të jashtëzakonshme dhe dramatike, me ndikim të thellë jo vetëm në rritjen e tarifave, por edhe në standardin e jetesës dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës.

Koment i qytetarëve 1.9.26:

Barrën më të lartë të të hyrave të kërkuara nga KEDS e përbën rritja e humbjeve. Sipas dokumentit strategjik PRR3 të ZRrE-së, kostoja e paraparë për humbjet e KEDS për vitin 2025 ka qenë 69.697 milionë euro, ndërsa kërkesa e vetë KEDS është rritur në 102 milionë euro. Kjo përfaqëson një rritje prej 56.95% krahasuar me vitin paraprak, kur kostoja e humbjeve ishte 65.371 milionë euro. Propozimi aktual i ZRrE-së për humbjet e lejuara është 86.652 milionë euro, që është 32.55% më shumë se në vitin e kaluar dhe 24.33% më shumë sesa ishte planifikuar në PRR3. Ka pasur raste të mëparshme në proceset konsultative kur KEDS ka paraqitur kërkesa të larta për mbulimin e humbjeve, por ZRrE ka treguar arsyeshmëri dhe ka vendosur vlera më të balancuara. Ky nuk do të ishte rasti i parë që ZRrE reflekton sensin e përgjegjësisë dhe ndjeshmërisë ndaj situatës ligjore dhe kontekstit socio-ekonomik, duke marrë vendime që mbrojnë interesin publik.

Koment i qytetarëve 1.9.27:

Rritja e humbjeve justifikohet me faktin se KEK nuk pritet të gjenerojë energji në kapacitet të plotë, veçanërisht gjatë tremujorit të fundit të vitit, dhe se kostoja e importit është shumëfish më e lartë. Megjithatë, duhet të theksohet se kostoja aktuale e importit nuk është më e lartë sesa në vitet paraprake, sidomos kur krahasohet me kulmin e çmimeve në vitin 2022. Sipas raporteve të ZRrE, në atë periudhë kostoja kishte arritur deri në 1000 euro për MWh, ndërsa aktualisht çmimi mesatar i importit është rreth 150 euro për MWh që përfaqëson një rënie prej 566.67% krahasuar me nivelin më të lartë historik. Nëse humbjet përbëjnë një ndër faktorët kryesorë të propozimit për rritjen e tarifave, atëherë kjo vlerë duhet të rishikohet, pasi nuk pasqyron realisht gjendjen aktuale të tregut dhe mund të përbëjë një barrë të panevojshme për konsumatorët.


Përgjigjja e ZRrE për 1.9.24, 1.9.25, 1.9.26, 1.9.27: Kostot e humbjeve të OSSH

Gjatë shqyrtimeve shumëvjeçare (PRR3), ZRrE vendosë caqet e reduktimit të humbjeve (Humbjet/Bruto konsumi në nivel të operatorit) për OSSH dhe OST. ZRrE gjatë shqyrtimeve periodike lejon kompenzim vetëm për sasitë e humbjeve (në përqindje) brenda caqeve të caktuara në shqyrtime periode.

Gjatë shqyrtimit të rregullt të vitit 2024, ZRrE ka parashikuar 1,037.06 GWh humbje të lejuara për OSSH. Humbjet e realizuara të lejuara për vitin 2024 ZRrE i konsideron vetëm 987.24 GWh, pjesa tjetër e humbjeve mbulohet nga operatori dhe nuk iu faturohet qytetarëve.


Shtytësi kryesor i rritjes së kostove të humbjeve të OSSH në krahasim me PRR3 si dhe me parashikimet për vitin 2024 është rritja e sasive dhe çmimit të importit. Parashikimet për vitin 2024 në lidhje me çmimet e energjisë elektrike janë bazuar në trendin rënës të çmimeve gjatë vitit 2023 dhe në fillim të vitit 2024 në tregjet ndërkombëtare, çmimet në tregjeve afatgjate (HUDEX), si dhe kostot për kapacitetet ndërkufitare të realizuara gjatë vitit 2023 (shih figurën më poshtë).

Figura: Çmimet e energjisë elektrike në HUPX (majtas) dhe çmimet e kapaciteteve ndërkufitare të realizuara (djathtas)



Çmimet e energjisë në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2024 si dhe çmimet e kapaciteteve ndërkufitare kishin një trend ngritës gjatë vitit 2024, dhe në krahasim me parashikimet kanë rezultuar më të larta, me theks në muajt e fundit të vitit, atëherë kur nevoja për import është më e madhe. Parashikimi i çmimeve të importit për vitin 2025 bazohet në trendet e çmimeve reale në tregje ndërkombëtare ditore dhe afatgjate, si dhe kostot e kapacitetit (mesatare të vitit 2023 dhe 2024 dhe duke eliminuar rritjen jo të zakonshme në shtator).

Figura: Çmimet e importit të parashikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024 dhe parashikimet për 2025 (majtas), sasitë e importit të parashikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024 dhe parashikimet për 2025 (djathtas)



Përderisa parashikimet për çmimet e energjisë si dhe kostot e blerjeve të energjisë nga importi për vitin 2025 janë më të larta se parashikimet e bëra gjatë PRR3 dhe për vitin 2024, ato janë më të ulta se çmimet dhe kostot reale të blerjeve të energjisë gjatë vitit 2024, dhe kështu ZRrE vlerëson se parashikimet për vitin 2025 pasqyrojnë në mënyrë të sakt trendet dhe çmimet e energjisë, në bazë të informatave që ZRrE posedon.

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka rishikuar të dhënat nga tregjet avanc të energjisë, dhe ka përditësuar parashikimet.

Koment i qytetarëve 1.9.28:

Rishikim duhet të ketë gjithashtu edhe në lidhje me investimin e planifikuar prej 43 milionë euro për shërbimet ndihmëse të KOSTT/OST, ku linja buxhetore është rritur me 137.31% — nga 18.17 milionë euro në vitin paraprak në 43.12 milionë euro për vitin 2025. Edhe pse ideja për forcimin e sigurisë energjetike përmes rezervave është e drejtë në kushte normale, kostoja e këtij projekti në kushtet aktuale socio-ekonomike dhe me rrezikun e një vale të re të inflacionit nuk është zgjidhje e përshtatshme për momentin. Kjo linjë buxhetore duhet të rishikohet me kujdes, dhe projekti të shtyhet për një moment më të favorshëm, në mënyrë që të mos rëndohet më tej situata ekonomike dhe financiare e konsumatorëve dhe bizneseve në Kosovë.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.28:

Ju lutem shihni përgjigjen në pikën 1.9.20.

Koment i qytetarëve 1.9.29:

Pas rishqyrtimit dhe rishikimit të linjave kryesore buxhetore, përkatësisht asaj të humbjeve të KEDS dhe shërbimeve ndihmëse të KOSTT, vlera e të hyrave të lejuara maksimale për operatorët do të ulet nga gjithsej 115 milionë euro shtesë të propozuara për vitin 2025 në 72.20 milionë euro. Të hyrat e lejuara për KOSTT do të balancohen në 72.51 milionë euro (nga 94.46 milionë), ndërsa për KEDS do të zbriten në 165.45 milionë euro (nga 186.74 milionë). Ky rishikim ofron një qasje më të matur dhe më të përbalueshme për konsumatorin, duke ruajtur një nivel të arsyeshëm të të hyrave për operatorët, por pa shkaktuar barrë të tepruar mbi ekonominë.

Koment i qytetarëve 1.9.30:

Duhet të theksohet se, edhe pas balancimit të propozuar, të hyrat e lejuara për KEDS mbeten 23.7% më të larta sesa të planifikuara fillimisht nga ZRrE në dokumentin strategjik PRR3 — përkatësisht nga 133.75 milionë euro të planifikuara në 165.45 milionë euro të rishikuara dhe të balancuara. Ky provizion dhe ky rekomandim dëshmojnë se zgjidhja e propozuar ka marrë parasysh edhe interesin e KEDS-it, duke synuar të ofrojë një zgjidhje praktike, kreative dhe të qëndrueshme që reflekton kompromisin e nevojshëm: të gjitha palët përfitojnë, por në thelb ruhet interesi publik dhe stabiliteti ekonomik i vendit. Rritja e tarifave nuk duhet të jetë opsioni i parë, por i fundit. Vetëm përmes këtij parimi mund të mbrohet fuqia blerëse e qytetarëve dhe të sigurohet që ekonomia të mos përballet me valë të reja të inflacionit të panevojshëm.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.29 dhe 1.9.30:

ZRrE vlerëson analizat dhe komentet e bëra nga qytetarët. Për sqarime të hollësishme ju lutem referojuni përgjigjeve më lartë.

Gjithashtu ZRrE thekson se pas çdo viti tarifor, përmes përshtatjeve të rregullta ZRrE rishikon kostot e blerjeve të energjisë, si dhe kostot e shërbimeve ndihmëse të realizuara në vitin paraprak, dhe i pranon vetëm kostot e arsyeshme, për të cilat ofrohen dëshmi se kostot janë shkaktuar nga shkaqe jashtë kontrollit të operatorëve, dhe se procedurat e prokurimit janë përcjellur.

Çdo ndryshim i arsyeshëm mes parashikimeve dhe realizimeve kompenzohet në vitin pasues përmes faktorit KREV. Kjo përfshinë edhe kompenzimin për qytetarët, siç ka ndodhur në vitin 2024 për OSSH, ku kostot e realizuara ishim më të ulëta se ato të parashikuara.

Koment i qytetarëve 1.9.31:

Zgjidhja e propozuar është e thjeshtë dhe praktike. Së pari, duhet të fokusohemi në menaxhimin efektiv të KEK-ut, me qëllim që të sigurohet prodhimi maksimal i energjisë, sidomos gjatë periudhave kritike të vitit, duke garantuar stabilitet në furnizim. Së dyti, është e domosdoshme që të rishikohen humbjet e lejuara për KEDS dhe të respektohen dokumentet planifikuese dhe strategjike të aprovuar nga institucionet përkatëse, duke marrë parasysh kontekstin ekonomik aktual. Të hyrat e lejuara për KEDS duhet të balancohen në 165.45 milionë euro, ndërsa niveli i humbjeve të kufizohet në 65.37 milionë euro, aq sa ka qenë në vitin paraprak. Kjo është e arsyeshme, pasi kostoja e energjisë nga importi nuk është rritur, dhe nuk ekziston një bazë reale për rritje kaq të theksuar të tarifave për konsumatorët.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.31:

ZRrE nuk ka mandat rregullimin e menaxhimit të prodhuesve (duke përfshirë KEK). Në lidhje me kostot e humbjeve të KEDS ju lutem referojuni përgjigjeve më lartë.

Koment i qytetarëve 1.9.32:

Këto dy rishikime buxhetore duhet të realizohen dhe vendimet përkatëse duhet të ndërmerren, edhe nëse kjo nënkupton që Kosova nuk do të ketë siguri maksimale të furnizimit me energji gjatë të gjitha stinëve të vitit. Në kontekstin aktual socio-ekonomik, opsioni i reduktimeve të targetuara për një periudhë të kufizuar kohore paraqitet si një zgjidhje më e mençur, më e matur dhe më e përgjegjshme sesa rritja e tarifave që do të nxisnin një valë të re inflacionare.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.32:

ZRrE është e obliguar të sigurojë furnizimin me energji elektrike, si dhe të caktoj tarifa të cilat i mbulojnë të gjitha kostot e arsyeshme nga operatorët e rregulluar. ZRrE nuk ka mandat të vendosë kufizime në furnizim me energji për konsumatorët. Kufizimi i furnizimit me energji rregullohet në bazë të Ligjit për Energjinë, kapitulli VII, neni 25.

Koment i qytetarëve 1.9.33:

Inflacioni është një nga kërcënimet më të mëdha për ekonominë një "kancer" i vërtetë që sjell pasoja të pariparueshme: çmimet rrallëherë kthehen në nivelet e mëparshme, ndërsa fuqia blerëse e qytetarëve dhe vlera reale e ekonomisë dëmtohen në mënyrë të pakthyeshme. Prandaj, në këtë situatë, një recesion i përkohshëm dhe reduktime të mundshme në furnizim janë një alternativë më e pranueshme sesa rritja e menjëhershme e çmimeve. Nëse ZRrE vendos të ndjekë një plan me reduktime potenciale, duhet patjetër të ketë parasysh interesin e ekonomisë kombëtare dhe të bizneseve, të cilat duhet të trajtohen si prioritet në furnizimin me energji. Ruajtja e aktivitetit prodhues dhe mbajtja e vendeve të punës është thelbësore për të garantuar stabilitet ekonomik dhe për të shmangur një krizë të thellë sociale.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.33:

ZRrE nuk ka mandat të vendosë kufizime në furnizim me energji për konsumatorët. Kufizimi i furnizimit me energji rregullohet në bazë të Ligjit për Energjinë, kapitulli VII, neni 25.

Koment i qytetarëve 1.9.34:

Pas korrigjimeve për humbjet dhe shërbimet ndihmëse, vlera e mbetur e të hyrave të lejuara shtesë për vitin 2025 do të jetë 72.20 milionë euro. Si rezultat, shuma e përgjithshme e të hyrave të lejuara për operatorët KEDS, KESCO dhe KOSTT do të zbrësë në 672.66 milionë euro, sipas përlllogaritjeve të rishikuara nga ana e ZRrE-së. Kjo përfaqëson një rritje prej 72.20 milionë euro krahasuar me vitin 2024, kur të hyrat e lejuara ishin 600.47 milionë euro. Ky fakt tregon se, edhe pas balancimeve teknike, ekziston hapësirë për fleksibilitet financiar, pa pasur nevojë për rritje të mëtejshme të tarifave që do të rëndonin konsumatorët.

Koment i qytetarëve 1.9.35:

ZRrE duhet të zhvillojë dialog me Qeverinë e Kosovës për të arritur një marrëveshje për subvencionim direkt nga buxheti i shtetit në vlerë prej 72.2 milionë euro. Një veprim i tillë do të shmangte ndikimin e drejtpërdrejtë të inflacionit në ekonomi dhe, mbi të gjitha, do ta bënte të panevojshme rritjen e tarifave të energjisë në një moment të ndjeshëm për shoqërinë dhe ekonominë e vendit. Një zgjidhje e tillë do të demonstronte përgjegjësi institucionale, bashkëpunim ndërsektorial dhe përkushtim për mbrojtjen e interesit publik, duke siguruar stabilitet energjetik pa rrezikuar standardin e jetesës së qytetarëve.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.34 dhe 1.9.35:

Politikat e subvencionimit nuk mund të caktohen apo të kërkohen nga ZRrE.

Koment i qytetarëve 1.9.36:

Qeveria e Kosovës ka dëshmuar, së paku në dy raste konkrete, se ka kapacitete buxhetore për të siguruar një shumë të tillë nga buxheti i shtetit, i cili për vitin 2025 arrin vlerën prej 3.6 miliardë euro. Rasti i parë është ai i ndihmave prej 100 eurosh që Qeveria i ka dhënë rreth 700,000 qytetarëve para zgjedhjeve të 9 shkurtit, duke e realizuar këtë masë brenda një afati rekord dhe pa qenë e planifikuar më parë në buxhetin e ministrive apo të shtetit. Ky veprim demonstroi qartë fleksibilitetin buxhetor dhe kapacitetin institucional për të ndërhyrë drejtpërdrejt, kur ekziston vullnet politik dhe kur përparësi u jepet nevojave të qytetarëve.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.36:

Ky koment nuk i adresohet ZRrE.

Koment i qytetarëve 1.9.37:

Gjithashtu, me rëndësi për këtë rast është fakti se në vitin 2022 Ministria e Ekonomisë ka propozuar dhe është zotuar, në emër të Qeverisë së Kosovës, të financojë 75 milionë euro nga mjetet e tatimpaguesve kosovarë për të subvencionuar koston e energjisë. Arsyeja kryesore e dhënë në justifikim të kësaj mase ka qenë zbutja e ndikimit të kostove të larta të blerjes së energjisë në tregjet ndërkombëtare. Në vitin 2025, kushtet socio-ekonomike dhe çmimet e konsumit e të jetesës janë ndjeshëm më të larta sesa në vitin 2022. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë nuk kanë asnjë arsye të mos alokojnë një fond të ngjashëm edhe për këtë vit, me qëllim që të shmanget një valë e re e inflacionit në ekonominë kosovare — një valë që do të kishte pasoja të

drejtpërdrejta dhe të rënda për fuqinë blerëse të qytetarëve dhe për aktivitetin ekonomik të bizneseve vendore.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.37.

Ky koment nuk i adresohet ZRrE.

Koment i qytetarëve 1.9.38:

Përfundimisht, pas rishikimit të të hyrave të lejuara për KOSTT dhe KEDS, ndërkohë që të hyrat e KESCO mbeten të pandryshuara, dhe pas arritjes së një zgjidhjeje me Qeverinë e Kosovës për subvencionimin e shumës prej 72 milionë euro, ZRrE nuk ka nevojë të propozojë rritje të tarifave për vitin 2025. Ky subvencion nga qeveria nuk duhet të reflektohet në faturat e konsumatorëve, por të jetë përkrahje direkte që krijon një mekanizëm mbështetës në formë 'by-pass'-i, i cili siguron që tarifat të mbeten të qëndrueshme dhe që një valë e re inflacioni të mos provokohet nga vendimet e ZRrE. Kjo do të ndihmonte në ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe të fuqisë blerëse të qytetarëve.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.38.

ZRrE është e obliguar të zbatojë mandatin e saj për përcaktimin e tarifave sipas Ligjit të Rregullatorit të Energjisë. Gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, Rregullatori do të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme. ZRrE nuk ka mandat të caktoj apo propozoj politikë fiskale, ekonomike apo sociale. ZRrE është e hapur për bashkëpunim, brenda mandatit të saj me të gjitha palët.

Koment i qytetarëve 1.9.39:

Një nga mjetet shtesë që është diskutuar në publik është mundësia e heqjes së TVSH-së nga kostoja e energjisë elektrike. ZRrE duhet të angazhohet dhe të bashkëpunojë ngushtë me institucionet përkatëse, që kjo masë të merret seriozisht në konsideratë, veçanërisht në raste si ai që po trajtohet aktualisht, por edhe në vitet në vijim. Largimi i përkohshëm apo i plotë i TVSH-së nga fatura e energjisë do të përbente një lehtësim të drejtpërdrejtë për konsumatorët dhe një mekanizëm të efektshëm për të parandaluar rritjen e tarifave, në kohë kur fuqia blerëse është e brishtë dhe ekonomia po përballlet me sfida të shumta. Një masë e tillë do të kontribuonte ndjeshëm në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në një sektor që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e çdo familjeje dhe në konkurrueshmërinë e bizneseve në Kosovë.

Përgjigjja e ZRrE për 1.9.39:

Politikat tatimore nuk janë në kompetencë të ZRrE.

Koment i qytetarëve 1.9.40:

ZRrE duhet të veprojë në mënyrë proaktive dhe të punojë ngushtë me të gjithë hisedarët për të përshpejtuar rritjen e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë, duke e bërë këtë një prioritet kombëtar. Rritja e kapaciteteve të brendshme të prodhimit është themelore për garantimin e çmimeve të qëndrueshme dhe të përballueshme për qytetarët dhe bizneset. Nuk është e pranueshme që opsioni i parë i ZRrE-së të jetë vendosja e barrës mbi konsumatorët dhe ekonominë. Përkundrazi, institucionet duhet të mendojnë në mënyrë strategjike dhe afatgjatë, duke bashkëpunuar ngushtë me Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për të siguruar që investimet në kapacitete të reja të mos vonohen. Çdo

vonesë në këtë drejtim e rrit varësinë nga importi dhe ekspozon sistemin energjetik ndaj rreziqeve të çmimeve të larta dhe të paqëndrueshme në tregjet ndërkombëtare. Vetëm përmes investimeve të qëndrueshme dhe bashkëpunimit ndërinstitucional mund të garantojmë siguri energjetike dhe stabilitet ekonomik për vendin.

Përgjigja e ZRrE për 1.9.40

ZRrE ka rol kyç në krijimin e një kuadri rregullator transparent, të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm, i cili siguron kushte të përshtatshme për investime në sektorin e energjisë elektrike. Përmes politikave tarifore të balancuara dhe procedurave të qarta për licencimin dhe zhvillimin e projekteve, ZRrE inkurajon zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, veçanërisht ato që kontribuojnë në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe uljen e varësisë nga kapacitetet ekzistuese dhe importit. Ndërtimi i kapaciteteve të reja kërkon politika të qëndrueshme rregullative dhe çmime që përcaktohen në nivel që reflekton koston, në mënyrë të qartë, transparente dhe pa ndërhyrje politike. Gjatë vitit 2024, ZRrE ka vlerësuar çmimet maksimale të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë, përkatësisht nga energjia diellore dhe energjia e erës, që do të mundësojnë investime shtesë përmes procesit të ankandëve.

Megjithatë, për të shmangur shtrembërimet në treg, çmimet e energjisë në tregun me shumicë duhet të lëvizin në nivel të çmimeve të tregut ashtu që konsumatorët vendorë të kenë mundësi të përfitojnë nga çmimet më të lira në treg, pavarësisht burimit të saj.

2 Komentet nga Shoqëria Civile

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka pranuar komente nga 3 organizata të shoqërisë civile: INDEP, “Organizatrat e Shoqërisë Civile” dhe Green Energy Kosova. Përgjigjet ndaj këtyre komenteve janë dhënë më poshtë:

2.1 Komente nga INDEP

Koment i INDEP 2.1.1:

Në Raportin Konsultativ, ZRRE ka përcaktuar që kostot operative (OPEX) të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) për vitin tarifor 2025 të indeksohen me një faktor efikasiteti prej 0.75%. Në dokument nuk ofrohet asnjë shpjegim metodologjik apo analizë e qartë se si është përcaktuar ky nivel efikasiteti. Vendimi v_2637_2025, i cili paraqitet si bazë për këto kalkulime, gjithashtu nuk ofron një arsyetim të detajuar lidhur me këtë figurë specifike. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij faktori dhe ndikimin e tij në përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale (MAR), INDEP kërkon nga ZRRE që:

- Të sqarojë në mënyrë transparente metodologjinë dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e faktorit të efikasitetit prej 0.75%.
- Të ofrojë analizë ekonomike mbi realizueshmërinë e këtij faktori duke marrë parasysh kushtet aktuale ekonomike dhe operacionale në tregun e energjisë në Kosovë.
- Të argumentojë qartë nëse është realiste dhe e bazuar në evidenca objektive pritja që FSHU do të realizojë një rritje të efikasitetit prej 0.75%, veçanërisht në kushtet e paqëndrueshme ekonomike dhe energjetike të kohës.

Pa ofruar këto sqarime, vendosja e një faktori të tillë efikasiteti mbetet jotransparente, duke krijuar rrezik për mosrealizim dhe rrjedhimisht transferim të barrës së kostove shtesë tek konsumatorët përmes tarifave më të larta në vitet pasuese.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.1

Faktori i efikasitetit është përcaktuar gjatë procesit të Shqyrtimit të Parametrave Hyrës për FSHU-në. Analiza më e detajuar e metodologjisë së përcaktuar për të reflektuar efikasitetin operativ të kompanive të rregulluara është përcaktuar gjatë procesit të Shqyrtimeve Periodike.

- Raportin Konsultativ për Parametrat Hyrës mund ta gjeni [këtu](#).
- Përgjigjet ndaj Komenteve për Parametrat Hyrës mund t'i adresoni [këtu](#).
- Raportin Konsultativ për Faktorin e Efikasitetit mund ta gjeni [këtu](#).
- Përgjigjet ndaj Komenteve për Faktorin e Efikasitetit mund ta gjeni [këtu](#).

Koment i INDEP 2.1.2:

Në Raportin Konsultativ mbi Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU), kostot e bartshme paraqesin një pjesë të konsiderueshme të strukturës tarifore të propozuar nga ZRrE. Këto kosto, të cilat përfshijnë tarifën e OST/OT (KOSTT), OSSH (KEDS) dhe Fondit të Burimeve të Ripërtëritshme (BRE), janë përcaktuar duke u bazuar në sasitë e furnizimit për konsumatorët e rregulluar dhe duke marrë parasysh efektin e procesit të deregulimit.

INDEP konstaton se Raporti nuk ka sqaruar në mënyrë të mjaftueshme dhe transparente:

- Si janë përcaktuar konkretisht këto kosto bartëse, dhe në çfarë mase është analizuar dhe vërtetuar që ato janë të justifikuar dhe të arsyeshme?
- Si ndikon specifikisht procesi i deregulimit të konsumatorëve në këto kosto, veçanërisht në aspektin e sasive dhe profilit të energjisë së blerë nga FSHU?
- Cilat kategori të konsumatorëve preken konkretisht nga ndryshimet, sa është vëllimi i konsumit të tyre dhe si ky ndryshim reflektohet në nivelin e tarifave për konsumatorët e mbetur në tregun e rregulluar?
- Cili është ndikimi afatmesëm dhe afatgjatë i deregulimit të konsumatorëve mbi këto kosto dhe mbi stabilitetin financiar të FSHU-së, duke marrë parasysh se deregulimi do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme?

Për këto arsye, kërkojmë që ZRrE të:

- Publikojë analizën e detajuar ekonomike dhe metodologjinë e përdorur në përcaktimin e kostove të bartshme për FSHU-në, duke demonstruar se këto kosto janë të justifikuar dhe të bazuara në kostot reale të shërbimeve.
- Ofroj qartë ndikimin e procesit të deregulimit në këto kosto, duke specifikuar qartë cilat të hyra preken, në çfarë mase dhe si këto ndikojnë në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të furnizimit me energji për konsumatorët e rregulluar.

Pa sqarimin e këtyre elementeve, konsumatorët nuk mund të jenë të informuar në mënyrë të mjaftueshme mbi arsyetimin e kostove që mbulohen nga tarifën që ata paguajnë, duke cenuar kështu parimin e transparencës dhe llogaridhënies së detyrueshme ligjore për ZRrE-në.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.2

Kostot e bartshme përbëjnë kosto që janë jashtë kontrollit të FSHU-së dhe që lidhen me shfrytëzimit të shërbimeve të operatorit të tregut, operatorit të sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes. Këto kosto përcaktohen në bazë të Nenit 18 të Rregullës për të Hyrat Maksimale të Lejuara të Shërbyesit Universal. Kjo rregull mund të qaset [këtu](#).

ZRrE nuk ka bërë vlerësim të ndikimit që procesi i derregullimit mund të ketë në nivelin e kostove të bartshme. Megjithatë, derregullimi ka ndikuar në uljen e këtyre kostove pasi që pjesa që bartet në të hyrat maksimale të lejuara është proporcionale me kostot e furnizimit të shërbimit universal. Meqë pas derregullimit një pjesë e konsumit nuk shërbehet nga konsumatorët e kualifikueshëm për shërbim universal, kjo nënkupton që kostot e bartshme për FSHU-në zvogëlohen proporcionalisht.

Koment i INDEP 2.1.3:

Në kapitullin që trajton kostot e blerjes së energjisë me shumicë (WHPC) për vitin 2025, raporti identifikon disa çështje kritike lidhur me përshtatjen e çmimit të energjisë së blerë nga hidrocentralet me koncesion. Dokumenti vetë pranon se palët e përfshira kanë përdorur një qasje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në Marrëveshjen për Shitblerjen e Energjisë (PPA), duke rezultuar në çmime që devijojnë nga propozimi fillestar. Si rrjedhojë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka aplikuar një korrigjim prej -0.45 milionë euro, duke vendosur shpërndarjen e kësaj vlere përgjatë tri viteve (-0.15 milionë euro në vit). Megjithatë, në dokument mungojnë sqarimet e duhura mbi arsyet që kanë çuar në këtë korrigjim, metodologjinë e zgjedhur për shpërndarjen trevjeçare të kësaj vlere, si dhe mbi ndikimet konkrete që ky korrigjim do të ketë në tarifën e konsumatorëve në periudhën afatmesme dhe afatgjate.

INDEP konsideron se:

- Mungesa e transparencës lidhur me metodologjinë dhe arsyetimin e ndryshimit të qasjes për përshtatjen e çmimeve të energjisë nga hidrocentralet me koncesion cenon besueshmërinë e parashikimeve për kostot e blerjes së energjisë.
- Korrigjimi prej -0.45 milionë euro dhe shpërndarja e tij në tri vjet mund të rezultojë në transferimin e kostove shtesë tek konsumatorët, si pasojë e pasigurive dhe pasaktësive në procesin e parashikimit.
- Mosadresimi i këtyre paqartësive në mënyrë transparente dhe metodologjiksht të qartë rrit rrezikun që konsumatorët të paguajnë në tarifën e ardhshme për gabime parashikimi.

Për të adresuar këto shqetësime, INDEP rekomandon që ZRRE:

- Të sqarojë në mënyrë të detajuar dhe transparente pse është devijuar nga marrëveshja fillestare (PPA) dhe të publikojë metodologjinë e plotë që ka çuar në korrigjimin e vlerës prej -0.45 milionë euro.
- Të argumentojë qartë logjikën pas shpërndarjes trevjeçare të korrigjimit dhe të analizojë publikisht ndikimin financiar që ky vendim do të ketë tek konsumatorët.
- Të marrë masa për përmirësimin e proceseve të parashikimit dhe monitorimit, për të shmangur përsëritjen e pasaktësive të ngjashme në të ardhmen.

Në mungesë të këtyre masave, mbetet shqetësues rreziku që konsumatorët të vazhdojnë të mbulojnë në mënyrë të padrejtë barrën e kostove të shtuara për shkak të pasigurive në planifikimin e kostove të energjisë.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.3

Metodologjia për përditësimin e kostove të blerjes së energjisë është konsistente me metodologjinë e aprovuar nga ZRrE që nga shqyrtimet e para të tarifave të energjisë elektrike në 2008. ZRrE mirëpret çdo rekomandim për përmirësim të kësaj metodologjie. Kjo metodologji nuk mund të ndrsyhojë në varësi të rezultatit të procesit të përditësimit të këtyre kostove.

Në lidhje me përshtatjen e kostove të hidrocentraleve, ZRrE thekson se metodologjia e përditësimit është sqaruar në Kapitullin 3.3 të Raportit Konsultativ për FSHU në Përshtatjen e Rregullt të vitit 2024. Ky raport mund të qaset [këtu](#).

Koment i INDEP 2.1.4:

Në Raportin Konsultativ, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka përdorur Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP) të Eurozonës për indeksimin e kostove operative (OPEX), kostove të amortizimit dhe kthimit të lejuar për vitin 2025. Konkretisht, është përdorur shkalla e inflacionit prej 2.36%, e publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës.

INDEP shpreh shqetësimin se:

- Kosova nuk është pjesë e Eurozonës dhe indeksi i inflacionit i Eurozonës mund të mos reflektojë me saktësi realitetin ekonomik lokal.
- Nuk është sqaruar në mënyrë të mjaftueshme arsyeja pse është zgjedhur pikërisht indeksi i inflacionit të Eurozonës dhe jo një indeks që më saktësisht reflekton kushtet ekonomike në Kosovë. ZRRE duhet të sqaroj nëse kjo përzgjedhje mbron interesin ekonomik të konsumatorëve në Kosovë apo jo!
- Përdorimi i një indeksi inflacioni të papërshtatshëm mund të ndikojë drejtpërdrejt në llogaritjen e tarifave, duke shkaktuar mbingarkesë ose nënvlerësim të kostove reale, që në afat të gjatë cenon qëndrueshmërinë financiare dhe transparencën në përcaktimin e tarifave.

Në këtë drejtim, INDEP rekomandon që ZRRE:

- Të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një indeksi inflacioni që pasqyron më saktë realitetin ekonomik në Kosovë, siç është indeksi i çmimeve të konsumit i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).
- Nëse vazhdon përdorimi i indeksit HICP të Eurozonës, atëherë të paraqesë në mënyrë transparente analizën dhe argumentimin ekonomik që justifikon përshtatshmërinë e këtij indeksi për kontekstin ekonomik dhe energjetik të Kosovës.

Në mungesë të një qasjeje më të përshtatshme dhe të argumentuar mirë, konsumatorët mund të jenë duke mbuluar në mënyrë jo të drejtë kosto shtesë të shkaktuara nga përdorimi i indeksit jo-reprezentativ për Kosovën.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.4

Norma e inflacionit e aplikuar nga ZRrE është konsistente me Rregullën për vendosjen e të hyrave maksimale të lejuara dhe është konsistente me praktikën e kaluara. ZRrE pajtohet se norma e

aplikueshme e inflacionit mund të ndryshojë në rastet kur vërehet se ka dallime sistematike në mes së normës së HICP-së dhe normës së publikuar nga ICK.

ZRrE është përgjigjur në këtë çështje në një koment të ngjashëm të dërguar nga FSHU në kuadër të shqyrtimit të vlerave hyrëse për Furnizuesin e Shërbimit Universal (shih Kapitullin 2.1 të [Përgjigjeve ndaj Komenteve për Vlerat Hyrëse](#)). Në analizën e ofruar nga ZRrE në atë dokument, konstatohet se përderisa vlerat e inflacionit mund të ndryshojnë nga viti në vit në bazë të një indeksi apo tjetri, nuk ka divergjencë sistematike në mes të indekseve.

Pavarësisht kësaj, ZRrE pajtohet se mund të ketë raste kur indekset nuk reflektojnë ndryshimet specifike, siç janë për shembull rritja e kostove të personelit në Kosovë përgjatë periudhës 2021-2024. Në këto raste, ZRrE vendosë për normën e inflacionit në bazë të vlerësimeve specifike, si në rastin e vlerësimit të Vlerave Hyrëse në 2024.

Koment i INDEP 2.1.5:

Në kapitullin e Raportit Konsultativ që trajton shërbimet ndihmëse (ancillary services), ZRRE parashikon një rritje jashtëzakonisht të lartë të këtyre kostove për vitin 2025. Konkretisht, krahasuar me shpenzimet e realizuara në vitin 2024 (24.7 milionë euro) dhe kostot e lejuara nga ZRRE për të njëjtin vit (18.17 milionë euro), propozimi i ZRRE-së për vitin 2025 arrin në 43.12 milionë euro, një rritje prej rreth 137%. INDEP vëren se raporti jep disa arsye operationale dhe teknike për këto rritje, por nuk ofron analizë të mjaftueshme ekonomike dhe transparencë në procedurat e kontraktimit të këtyre shërbimeve.

Në veçanti, INDEP ka identifikuar këto mangësi:

Kapaciteti i rezervës automatike (aFRR):

Raporti sqaron se kapaciteti i rezervës automatike (aFRR) është rritur nga ± 25 MW në ± 40 MW për shkak të:

- Nevojës për balancim më të mirë të sistemit;
- Observimeve të ENTSO-E për devijimet në sistemin e ndërlidhur evropian;
- Kërkesave rregullative.

Megjithatë, raporti nuk jep një analizë të detajuar ekonomike për zgjedhjen e nivelit të ri të kapacitetit ± 40 MW, duke mos shpjeguar pse është zgjedhur pikërisht ky nivel dhe cili është ndikimi i tij ekonomik në strukturën e kostove. Gjithashtu, raporti sqaron që ky shërbim është siguruar ekskluzivisht përmes OST-së së Shqipërisë me anë të një ankandi javor, por nuk ofron:

- Arsyetim ekonomik pse ky kapacitet është kontraktuar vetëm nga OST-ja e Shqipërisë;
- Nëse janë konsideruar alternativa të tjera më ekonomike brenda tregut rajonal;
- Nëse ky proces tenderimi ka qenë i hapur dhe konkurrues në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar çmimet më të favorshme për konsumatorët e Kosovës.

Rezerva manuale (mFRR):

Raporti thekson se rezerva manuale (mFRR) për vitin 2025 është kontraktuar me KESH-in me kapacitete prej +196 MW(lart) dhe -50 MW(poshtë) për një shumë totale prej 14.62 milionë euro, që paraqet një rritje prej 63% krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa raporti deklaron që kjo kontratë është realizuar në bazë të procedurave të tenderimit, ai nuk jep detaje mbi:

- Transparencën dhe hapjen e këtij procesi tenderimi;

- Numrin e ofertuesve dhe kriteret e vlerësimit;
- Nëse OST/OT apo ZRRE kanë eksploruar opsione alternative ose kanë analizuar konkurrencën në treg për të minimizuar këtë rritje të kostove.

Kjo mungesë transparence dhe e analizës konkurruese ngre dyshime për efektivitetin e procesit të prokurimit dhe për potencialin e ngarkimit të konsumatorëve me kosto më të larta sesa ato që mund të arriheshin në një treg më konkurrues.

Analiza e munguar e faktorëve të çmimeve dhe impaktit në tarifat afatmesme:

Megjithëse raporti identifikon mekanizmat e përdorur për kontraktimin e shërbimeve ndihmëse (ankande javore për aFRR dhe tender për mFRR), ai nuk sqaron në mënyrë të detajuar:

- Cilët faktorë konkretë kanë kontribuar në përcaktimin e çmimeve për këto rezerva, përtej vetë procesit të ankandit apo tenderimit;
- Çfarë masash janë ndërmarrë për të kufizuar ndikimin e këtyre çmimeve në kostot e përgjithshme;

Në çfarë mase këto rritje të konsiderueshme të kostove janë reflektuar në një analizë afatmesme për tarifat finale që konsumatorët do të paguajnë, duke marrë parasysh vazhdimësinë e këtyre tendencave të rritjes.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.5

Arsyeja kryesore e rritjes së kostos së shërbimeve ndihmëse vjen nga rritja e kontraktimit të kapaciteteve aFRR dhe mFRR si pasojë e kërkesave të ENTSO-E për përmirësim të balancimit të sistemit. Rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga OST e Shqipërisë. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e marra për aFRR janë 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me Palën Ofruese të Shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MW për ngritje dhe -50 MW për zbritje.

Detyrimi për rezervën buron nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit) ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kushteve të tregut mbi të cilat ZRrE nuk ka kontrollë në pajtim me Nenin 13.2 i [Rregullave të Tregut](#).

Rezerva e obligueshme është reduktuar ngaqë është në një zonë rregulluese me Shqipërinë. Po të mos ishte në të njëjtën zonë rregulluese rezerva do të duhej të ishte më i lartë (265 MW).

Koment i INDEP 2.1.6:

Në kapitullin e tretë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) prezanton një shtesë (premium) prej 9.55% në çmimet mesatare të energjisë elektrike të referencës HUDEX, e cila është përdorur për parashikimin e kostove të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të OST gjatë vitit 2025. Ky premium është bazuar në analizën e të dhënave historike të diferencës mes çmimeve të tregut njëditor të HUPEX dhe ALPEX, dhe ka rezultuar në një çmim mesatar të importit prej 105.70 €/MWh për vitin 2025.

INDEP identifikon disa çështje kritike në këtë qasje:

Paqartësia metodologjike në përcaktimin e premiumit prej 9.55%

Raporti deklaron se ky premium prej 9.55% është kalkuluar në bazë të analizës së të dhënave historike të dallimit mes çmimeve të HUPEX dhe ALPEX. Megjithatë, në raport nuk janë sqaruar në mënyrë transparente:

- Periudha specifike kohore e analizuar për të nxjerrë këtë mesatare (përse nuk është marrë periudhë më e gjatë kohore e analizës);
- Metoda statistikore e përdorur për kalkulimin e kësaj mesatareje (p.sh., mesatare e thjeshtë, e ponderuar, analizë regresioni apo metoda tjetër);
- Nëse janë marrë parasysh dhe analizuar veçanërisht tendencat e fundit që tregojnë ulje të konsiderueshme të këtij dallimi (p.sh. nga 23% në shtator 2024 në 3% në shkurt 2025).

Mungesa e transparencës në përcaktimin e kësaj shifre dhe metodologjisë së përdorur dobëson besueshmërinë e kësaj qasjeje, veçanërisht duke marrë parasysh ndryshimet e konsiderueshme të fundit në tregjet rajonale të energjisë.

Mungesa e analizës së trendeve të ardhshme të diferencës së çmimeve (HUDEX/ALPEX)

Ndërsa raporti përdor historikun për të aplikuar këtë premium në parashikimet e vitit 2025, nuk ofrohet asnjë analizë ose parashikim për ndryshimet e mundshme gjatë vitit të ardhshëm. Duke pasur parasysh se diferenca mes HUDEX dhe ALPEX është duke u zvogëluar në mënyrë të dukshme (23% në shtator 2024 në 3% në shkurt 2025), ky premium prej 9.55% mund të mos jetë i përshtatshëm për vitin 2025, duke rezultuar potencialisht në kosto më të larta dhe të padrejta për konsumatorët.

Mungesa e mekanizmave korrigjues dhe alternativave për skenarë të ndryshëm

Raporti nuk ofron asnjë mekanizëm të qartë se si do të trajtohet situata në rast se diferenca reale gjatë vitit 2025 devijon në mënyrë të konsiderueshme nga shifra prej 9.55%. Në rast se diferenca rezulton më e ulët ose më e lartë nga ajo e aplikuar në parashikime, konsumatorët mund të përballen me tarifa të padrejta, duke u ngarkuar kështu me kosto shtesë të pajustificuara ose duke krijuar paqartësi financiare për OST/OT.

Mungesa e analizës së ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë në tarifat e konsumatorëve

Raporti nuk përmban asnjë analizë specifike lidhur me ndikimin afatmesëm dhe afatgjatë që ky premium prej 9.55% mund të ketë në tarifat finale që paguajnë konsumatorët. Duke qenë se kjo shtesë është një element i rëndësishëm në përcaktimin e kostove të importit, është thelbësore që ZRRE të ofrojë një analizë më të detajuar të impaktit afatgjatë në tarifat e konsumatorëve.


Përgjigjja e ZRrE për 2.1.6

Çmimi i referencës për humbjet është bazuar në vlerësimet e tregut për vitin 2025, duke përfshirë të dhënat nga bursat si për blerje afatgjate si HUDEX dhe dallimet strukturore të çmimeve në mes të HUPEX dhe ALPEX. Vlera e përshtatjes për 9.55% është marrë në bazë të dallimeve të çmimeve mesatare mujore në mes të HUPEX dhe ALPEX nga Shkurti i vitit 2023 deri në fund të Shkurtit 2024. ZRRE nuk konsideron se kjo normë mund të vlerësohet me analizë regresioni pasi që kjo do të mund të keqinterpretohet si ndërvarësi direkte në mes të çmimeve të HUPEX (si variabël e pavarur) në

çmimet në ALPEX (si variabël e varur). Megjithatë ZRrE mund të masë korrelacionin në mes të këtyre parametrave për këta muaj, që për periudhën në fjalë rezultojnë të jetë 98%.

ZRrE vlerëson rekomandimin e INDEP për këtë çështje dhe thekson se si rezultat i këtij komenti, vlera prej 9.55% është reviduar në 7.06%, duke përfshirë dallimet në mes të çmimeve mesatare gjatë 24 muajve të fundit, vlera e korrelacionit në këtë rast është 97%. ZRrE poashtu thekson se çdo ndryshim në normën e parashikimit reflektohet në çmimet totale të importit e cila në fund bashkërenditet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara.

Figura: Krahasimi i çmimeve mesatare mujore në mes të HUPEX dhe ALPEX



ZRrE poashtu qartëson se norma e llogaritur prej 7.06% (e reviduar nga 9.55%) nuk është ‘premium’, siç vlerësohet nga INDEP, por është vlerësim në mes të kostos së ALPEX dhe asaj të HUPEX, pasi që OST blerjet i bënë në ALPEX, por parashikimet bazohen në kontratat avanc në tregun HUDEX. Si e tillë, kjo normë e parashikuar bashkërenditet për të reflektuar ndryshimin në mes të vlerës së parashikuar dhe të realizuar të importit.

ZRrE kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo thekson se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e konsumatorëve në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm (nevojë) përmes përkrahjes financiare, neni 50 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Koment i INDEP 2.1.7:

Në seksionin 4 të Raportit, ZRrE trajton përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave për vitin e realizuar 2024, duke aplikuar një normë interesi prej 9.05% (EURIBOR 3.31% + premiumi 5.74%). Ky faktor korigjues (KREV) arrin shumën prej 0.85 milionë euro, që rezultojnë nga diferenca mes kostove të lejuara (54.24 milionë €) dhe të hyrave të realizuara (53.47 milionë €), duke përfshirë edhe interesin e aplikuar. INDEP vëren disa çështje shqetësuese lidhur me këtë qasje dhe normën e interesit të aplikuar:

Norma e lartë e interesit dhe implikimet për konsumatorët

Aplikimi i një norme interesi prej 9.05% (3.31% EURIBOR plus premiumi prej 5.74%) për përshtatjen e faktorit korrigjues përbën një kosto të konsiderueshme financiare që transferohet automatikisht tek konsumatorët. Raporti nuk përmban një analizë të detajuar që justifikon nevojën apo arsyeshmërinë e aplikimit të një premiumi kaq të lartë (5.74%) mbi normën EURIBOR. Në mungesë të shpjegimeve shtesë, kjo normë interesi mund të interpretohet si një ngarkesë e tepërt për konsumatorët, veçanërisht duke marrë parasysh që diferenca prej 0.77 milionë € (para interesit) rritet në 0.85 milionë € pikërisht për shkak të kësaj norme interesi.

Paqartësia mbi metodologjinë e përcaktimit të premiumit (S)

Raporti sqaron se premiumi prej 5.74% është vendosur nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik për të reflektuar kostot e huave afatshkurtra. Megjithatë, raporti nuk ofron asnjë detaj specifik lidhur me:

- Metodologjinë dhe kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë premium;
- Nëse janë konsideruar alternativa më të favorshme dhe ekonomike për konsumatorët gjatë përcaktimit të këtij premium;
- Nëse premiumi prej 5.74% është ende i përshtatshëm dhe i reflektueshëm i realitetit aktual të tregut financiar në Kosovë dhe Evropë.

Mungesa e alternativave dhe opsioneve më të favorshme për konsumatorët

ZRRE nuk duket të ketë eksploruar alternativa më të favorshme ose më të ulëta në kosto për konsumatorët, për shembull:

- Mundësinë e aplikimit të një premiumi më të ulët, duke reflektuar realitetin aktual financiar të tregut;
- Mekanizma alternativë financiarë që mund të kishin reduktuar ngarkesën e kësaj norme interesi te konsumatorët.

Mungesa e analizës së impaktit afatgjatë në tarifat e konsumatorëve

Raporti nuk ofron një analizë të impaktit që kjo normë interesi prej 9.05% ka në mënyrë afatgjatë mbi tarifat e konsumatorëve. Duke qenë se kjo praktikë mund të përsëritet edhe në të ardhmen, është e nevojshme që ZRRE të shqyrtojë implikimet afatgjata dhe të sigurojë transparencë lidhur me ndikimet potenciale në çmimet që konsumatorët paguajnë.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.7

Norma e interesit bazohet në pikën 2.1 të Shtojcës I të Rregullës për të Hyrat e Lejuara të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU)-së. Norma paraqet normën e interesit të realizuar në vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë përshtatjeve vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra.

Kjo normë e interesit reflektohet në mënyrë simetrike për të gjitha përshtatjet për të reflektuar koston afatshkurtë të kapitalit (ndryshimet në vlerën në kohë të parasë në mes të konsumatorëve dhe kompanive të rregulluara). Si e tillë, nuk mund të ndikojë njëanshëm në përfitim të asnjërës palë të ndikuar nga norma e interesit përderisa llogaritet në mënyrë konsistente nga ZRrE.

Sa i përket ndikimit në tarifa, ZRrE përsëritë se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e konsumatorëve në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të

konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Koment i INDEP 2.1.8:

Në kapitullin mbi "Indeksimin e Kostove Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimit të Lejuar dhe Kthimit të Lejuar në Kapital për vitin 2025", ZRRE ka miratuar kostot operative shtesë (OPEX) për OSSH-në në shumën prej 0.935 milionë € për shërbimet në katër komunat në veri të Kosovës. Nga kjo shumë, 0.362 milionë € lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit dhe kyçjet e reja, ndërsa 0.573 milionë € klasifikohen si "shërbime të tjera". INDEP ka disa vërejtje lidhur me transparencën, justifikimin dhe mekanizmat e monitorimit të këtyre kostove:

Mungesa e transparencës në lidhje me natyrën specifike të "shërbimeve të tjera" (0.573 milionë €)

Raporti nuk ofron detaje të qarta lidhur me përmbajtjen konkrete të këtyre "shërbimeve të tjera". Edhe pse këto shpenzime janë pjesë e kostove operative të lejuara, mungesa e një përshkrimi të qartë krijon paqartësi të konsiderueshme rreth nevojës dhe arsyeshmërisë së këtyre kostove.

Paqartësitë në metodologjinë e kalkulimit të kostove operative shtesë

Megjithëse raporti përmend se ZRRE ka bërë një analizë krahasuese mes kostove në veri dhe në pjesët e tjera të Kosovës, mungon një shpjegim konkret rreth metodës së kalkulimit të këtyre kostove operative shtesë. Nuk sqarohet nëse këto kosto janë bazuar në kontrata konkrete, marrëveshje specifike, apo janë supozime të bëra nga ZRRE, duke ngritur pikëpyetje mbi saktësinë dhe justifikimin e shifrës së aprovuar.

Mungesa e referencave konkrete nga Marrëveshjet e Brukselit dhe dokumente të tjera relevante në dialogun Kosovë-Serbi

Raporti përmend se kostot shtesë janë në linjë me "Udhëzuesin për Energji" dhe legjislacionin sekondar që rrjedh nga dialogu Kosovë-Serbi, por nuk jep citime konkrete apo referenca specifike nga dokumentet ose marrëveshjet e dialogut të Brukselit. Një lidhje më e qartë dhe më transparente midis këtyre kostove shtesë dhe detyrimeve të dala nga marrëveshjet në dialog do të ishte e nevojshme për të justifikuar plotësisht kalimin e këtyre kostove tek konsumatorët.

Mungesa e një mekanizmi të qartë monitorues dhe verifikues të efikasitetit të këtyre kostove

Megjithëse raporti thekson se OSSH ka mundësi teknike të monitorojë rrjedhën e energjisë në sistemin e shpërndarjes në veri, ai nuk ofron asnjë mekanizëm të qartë apo të detajuar për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të këtyre kostove operative shtesë. Pa një mekanizëm të tillë, konsumatorët mbeten të ekspozuar ndaj rrezikut që këto kosto të mos jenë plotësisht të justifikuara apo të optimizuara, duke rezultuar në tarifa më të larta të panevojshme.

Mungesa e analizës specifike se si këto kosto operative do të përkthehen në përfitime konkrete për konsumatorët

Raporti thekson në mënyrë të përgjithshme se kostot operative shtesë do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në reduktimin e humbjeve, por nuk ofron asnjë analizë të detajuar apo specifike mbi mënyrën se si këto kosto (sidomos pjesa prej 0.573 milionë € për "shërbime

të tjera") do të ndikojnë konkretisht në shërbimet për konsumatorët. Një mungesë e tillë e transparencës dhe detajeve analitike dobëson argumentin e ZRRE-së për kalimin automatik të këtyre kostove në tarifat e konsumatorëve.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.8

Sipas Metodologjive të ZRrE-së, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes vendosen gjatë shqyrtimeve periodike dhe nuk ndryshojnë përgjatë periudhës rregullative. Megjithatë, integrimi i sistemit energjetik në katër komunitat në veri të Kosovës ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative për të rregulluar furnizimin në atë zonë. Megjithatë, shpenzimet e lejuara nga ZRrE janë më të vogla se ato të kërkuara nga Elektroserver dhe KEDS.

Vlerësimi i ZRrE i shpenzimeve të arsyeshme të Elektroserver është bazuar në kostot e realizuara nga KEDS për të ofruar shërbime ekuivalente në një zonë të ngjashme për nga dendësia e popullsisë, numri i konsumatorëve dhe paga mesatare e realizuar.

Koment i INDEP 2.1.9:

Në kapitullin 4 të raportit, ZRRE propozon të Hyra të Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH-në prej 181.574 milionë € për vitin 2025, që është dukshëm më e ulët sesa kërkesa fillestare e OSSH-së prej 217.770 milionë €. Megjithëse raporti thekson se ky reduktim synon të "sigurojë një ekuilibër të drejtë mes operatorit dhe konsumatorëve," mungon një analizë e qartë se pse ky ekuilibër nuk mund të jetë edhe më shumë në favor të konsumatorëve, për shembull, përmes një uljeje shtesë të kostove që mbarten automatikisht tek konsumatori.

Për më tepër, diferenca prej 7.446 milionë € në faktorin korigjues të të hyrave (KREVT) midis propozimit të OSSH-së (33.610 milionë €) dhe atij të ZRRE-së (26.164 milionë €) nuk është sqaruar mjaftueshëm në raport. Nga perspektiva e konsumatorit, kjo mungesë transparence është problematike, pasi çdo llogaritje e paqartë e këtij faktori korigjues mund të rezultojë në tarifa më të larta për konsumatorët sesa ato të justifikueshme.

Gjithashtu, diferenca prej 1.015 milionë € lidhur me detyrimet ndaj KOSTT-it mes propozimit të OSSH-së (3.585 milionë €) dhe atij të ZRRE-së (2.570 milionë €), edhe pse thuhet se vjen nga ndryshimet mes parashikimit dhe realizimit të konsumit në vitin paraprak, nuk detajohet sa duhet për konsumatorët. Një qasje e tillë e paqartë ngre dyshime nëse kostot e shtuara të propozuara nga OSSH janë vërtet të arsyeshme apo përfaqësojnë një transferim automatik të kostove tek konsumatori pa një kontroll të plotë mbi efikasitetin e këtyre kostove.

Mbi të gjitha, raporti nuk trajton mjaftueshëm ndikimet afatgjata mbi konsumatorët nga kjo strukturë e tarifave. Ulja e propozuar nga ZRRE, edhe pse duket në interesin e konsumatorëve në afat të shkurtër, nuk është e qartë nëse kjo ulje do të mjaftojë për të parandaluar rritje të mëtejshme tarifore në vitet në vijim. Konsumatorët kanë nevojë për një mekanizëm më të qartë dhe më transparent që të sigurohen se reduktimi i propozuar është maksimalisht i mundshëm dhe jo thjesht një kompromis që ende mund të rezultojë në kosto të pajustificuara në të ardhmen.

Përgjigjja e ZRrE për 2.1.9

ZRrE thekson se nuk ka ulur MAR të OSSH në krahasim me vlerën e kërkuar por se vlera e propozuar nga ZRrE ndryshon për shkak të ndryshimeve në supozimet e përdorura dhe parametrat hyrës të tarifave.

KREV paraqet ndryshimet në të hyrat maksimale të lejuara që mund të ndodhin për shkak të ndryshimeve në mes të vëllimeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë që janë jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar. Llogaritja e përdorur nga ZRrE është konsistente me Rregullën për të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe me praktikat e mëparshme për llogaritjen e KREV.

2.2 Komente nga “Organizatet e Shoqërisë Civile”

Ky kapitull i përgjigjeve ndaj komenteve paraqet komentet dhe përgjigjet e ZRrE-së për komentet e “Organizatet e Shoqërisë Civile”, grup organizatash të përbëra nga *Balkan Green Foundation*, Instituti Musine Kokolari, FOL, *Open Data Kosovo*, germin, *Kosovo Local Government Institute*, *The Foundation House*, Qendra Për Raste Gjyqësore Strategjike dhe *hajde!*.

Koment nga Organizatat e Shoqërisë Civile 2.2.1:

Zbatimi i një rritjeje prej 15% të tarifave të energjisë elektrike do të rëndojë më tej barrën financiare mbi qytetarët dhe familjet në Kosovë, shumë prej të cilave tashmë përballen me të ardhura të ulëta. Një rritje e tillë do të rritë tutje rrezikun për varfëri energjetike. Për më tepër, bizneset, veçanërisht ato prodhuese, do të përballen me rritje të ndjeshme të kostove operative. Kjo do të ndikojë në rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, duke ulur konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve vendore dhe potencialisht duke sjellë humbje të vendeve të punës.

Përgjigjja e ZRrE për 2.2.1:

ZRrE kupton shqetësimin lidhur me ndikimin potencial në konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla. Megjithatë, vlerësimi i ndikimit social nuk është pjesë e mandatit të ZRrE-së sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

. ZRrE vepron mbi bazën e kostove të arsyeshme dhe nuk ka mandat të përcaktojë tarifa në bazë të aftësisë paguese të konsumatorëve.

Koment nga Organizatat e Shoqërisë Civile 2.2.2:

Kapitulli 1 i raportit konsultativ, ndër të tjera i referohet çmimeve të tregut të energjisë elektrike për të arsyetuar këtë rritje. Historikisht, çmimet e energjisë janë rregulluar në rritje si përgjigje ndaj kushteve të tregut dhe kostove të importeve. Megjithatë, ka shumë pak raste të uljes së çmimeve kur përmirësohen kushtet e tregut. Zbatimi i një strategjie të balancuar të çmimeve që përfshin mekanizma për uljen e çmimeve kur kushtet e tregut e lejojnë, do të sigurojë drejtësi dhe besim të konsumatorët.

Përgjigjja e ZRrE për 2.2.2:

Mekanizmi i përshtatjes së kostos së energjisë me shumicë është simetrik dhe siguron që ndryshimet në mes të kostove të lejuara të energjisë elektrike dhe atyre të realizuara të reflektohet në tarifën pasardhëse. Poashtu, çmimet më të ulëta të parashikuara të energjisë së importit ndikojnë në ulje të të hyrave maksimale të lejuara. Kjo është reflektuar, për shembull, në ulje të [tarifave në vitin 2024](#) në raport me [tarifat e vitit 2023](#).

Koment nga Organizatat e Shoqërisë Civile 2.2.3:

Krahasimi i çmimeve që po bëhet me shtetet tjera është gjithashtu i gabuar, dhe kjo shihet nëpërmjet prizmit të fuqisë blerëse. Sipas vlerësimeve të Eurostat për vitin 2024, PBB (prodhimi i brendshëm bruto) për banorë të Kosovës si fuqi blerëse (PPS) është më pak se gjysma e mesatares së BE-së. Kjo


do të thotë se, në terma relativë, qytetarët e Kosovës paguajnë shumë më tepër për energji elektrike sesa qytetarët evropianë, pasi faturat e energjisë përbëjnë një pjesë shumë më të madhe të të ardhurave të tyre. Prandaj, rritja e tarifave në një kontekst kaq të vështirë ekonomik është jo vetëm e pajustificuar, por thellësisht regresive.

Përgjigjja e ZRrE për 2.2.3:

Detyra e ZRrE-së është të sigurojë funksionim të qëndrueshëm të sektorit energjetik përmes përcaktimit të tarifave të cilat pasqyrojnë kostot e arsyeshme të operatorëve, të mbrojnë konsumatorët nga abuzimet në treg si dhe nga shpenzimet apo fitimet e pa arsyeshme të operatorëve të rregulluar. ZRrE nuk është përgjegjëse për përcaktimin e politikave të të ardhurave, pagave apo për masat mbrojtëse financiare për grupet në nevojë. ZRrE është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha institucionet për hartimin e programeve për konsumatorët e cenueshëm apo të prekur nga varfëria energjetike.

Në tregje të integruara, siç është tregu energjetik i Kosovës me vendet e rajonit, çmimet e produkteve të njëjta (energji elektrike në këtë rast) kanë tendencë të afrohen. Grafikoni i përdorur nga ZRrE në hapje të procesit konsultativ, si dhe figura më poshtë, paraqiten për të treguar se çmimet e energjisë në Kosovë, edhe pas rritjes janë në linjë me çmimet e energjisë në rajon, por dukshëm më ultë se çmimet e energjisë në tregjet Evropiane me të cilat synojmë të integrohemi.

Figura: Çmimi mesatar i energjisë elektrike në Ballkanin perëndimorë gjatë vitit 2024 (pa taksa)



Koment nga Organizatat e Shoqërisë Civile 2.2.4:

Privatizimi i ndërmarrjes për shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, KEDS, në vitin 2013, është shoqëruar me premtime për investime të mëdha për përmirësimin e rrjetit dhe efikasitetit. Megjithatë, shumica e këtyre premtimeve nuk janë përmbushur, me probleme infrastrukturore dhe ndërprerje të shpeshta që vazhdojnë të prekin konsumatorët. Është e padrejtë që qytetarët të përballen me rritje çmimesh në mungesë të përmirësimeve konkrete.

ZRrE ka mandat të mbrojë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë çmime të drejta në sektorin e energjisë. Rritjet e shpeshta të tarifave, sidomos kur mungojnë përmirësimet në shërbim, e minojnë besimin e qytetarëve në institucionet rregullative. Është jetike që ZRrE të vendosë transparencën dhe

Ilogaridhënie në qendër të vendimmarrjes së saj, duke siguruar që çdo propozim për rritje çmimesh të jetë i justifikuar, i drejtë dhe në interes të qytetarëve.

Përgjigja e ZRrE për 2.2.4:

ZRrE pajtohet se rritja e tarifave duhet të reflektojë investimet në sektor dhe kjo tashmë është realizuar përmes rishikimit dhe aprovimit të planit investiv dhe bazës së rregulluar të aseteve të cilën ZRrE e ka aprovuar gjatë Shqyrtimit Periodik. Legjislacioni sekondar i ZRrE nuk parasheh rishqyrtim të planit investiv gjatë Përshtatjeve të Rregullta (shih Kapitullin 2 të këtij raporti).

Koment nga Organizatat e Shoqërisë Civile 2.2.5

I bëjmë thirrje ZRRE-së që të pezullojë rritjen e propozuar të tarifave dhe të nisë një rishikim të gjithanshëm të faktorëve që po ndikojnë në vështirësitë financiare të sektorit energjetik. Ky rishikim duhet të përfshijë: Auditim të investimeve dhe shpenzimeve të KEDS-it që nga privatizimi.

- Publikimin e plotë të pasqyrave financiare të audituara të KEDS-it për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.
- Vlerësim të zgjidhjeve alternative për tejkalimin e mungesës financiare, pa rritur tarifat.
- Angazhim institucional e sistematik në arritjen e kontratave afatgjata për importim të qëndrueshëm e të përballueshëm të enegjisë elektrike.

Përgjigja e ZRrE për 2.2.5:

Në vlerësimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarve, ZRrE analizon të dhënat e dorëzuara nga të licencuarit për shpenzimet e realizuara, krahas vendimeve të ZRrE-së para çdo viti tarifor. Praktikant kontabël të ZRrE nuk përkojnë me stardardet e aplikuara nga të licencuarit prandaj pasqyrat financiare të kompanive, të përgaditura për qëllime statutore, dallojnë nga pasqyrat rregullative. Publikimi dhe auditimi i pasqyrave financiare statutore të operatorëve në Kosovë nuk është përgjegjësi e ZRrE, por e organeve kompetente për auditim dhe publikim.

ZRrE siguron se çdo propozim për rritje tarifore i nënshtrohet një analize të detajuar teknike dhe financiare, me qëllim që tarifat të jenë të bazuara, transparente dhe të qëndrueshme, duke ruajtur integritetin e sistemit energjetik dhe mbrojtur konsumatorët nga barrë e panevojshme.

ZRrE pajtohet se konsumatorët mund të përfitojnë nga kontratat afatgjata që stabilizojnë luhatjet e çmimeve në treg me kusht që këto të jenë konkurruese dhe të mos ndëshkojnë konsumatorët në rast të rënies së çmimeve. Parashikimet e ZRrE të kostos së blerjes së energjisë bazohen në të dhënat e çmimeve në avancë të publikuar në HUDEX. Megjithatë kontratat afatgjata përballen me rrezikun e uljes së çmimeve dhe kostove të mbetura të cilat nuk mund t'i faturohen konsumatorëve. ZRrE mirëpret çdo rekomandim apo përmirësim në metodologjinë e FSHU që mund të adresojë luhatjet e çmimeve në treg dhe të shërbejë në të mirë të konsumatorëve.

2.3 Komente nga Green Energy Kosova

Ky kapitull i përgjigjeve ndaj komenteve paraqet komentet dhe përgjigjet e ZRrE-së për komentet e *Green Energy Kosova*.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.1:

Ne besojmë se për të forcuar më tej mbikëqyrjen e rregullatorit, është thelbësore që Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të ruajë pavarësinë e saj dhe t'i rezistojë presioneve të jashtme për të

zhvendosur kostot në mënyrë të padrejtë midis grupeve të konsumatorëve ose ndërmjet operatorëve dhe konsumatorëve. Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) paralajmëron se ndërrime të tilla mund të shtrembërojnë sinjalet e eficiencës, duke rritur përfundimisht kostot e sistemit dhe duke minuar përballueshmërinë (ACER, 2025). Duke lidhur rritjen e shpenzimeve operative (OPEX) dhe objektivat e humbjeve me matjet e matshme të performancës, ZRRE mund të sigurojë që vetëm kostot e justifikuara t'u kalohen konsumatorëve, duke u harmonizuar me praktikën më të mira evropiane për integritetin e rregullatorit.

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.1:

Komenti është në përputhje të plotë me përgjegjësitë dhe mandatin e ZRrE-së. Faktori i efikasitetit në shpenzimet operative dhe caqet e reduktimit të humbjeve tashmë janë pjesë integrale e të hyrave maksimale të lejuara. Raporti për humbjet e lejuara është i publikuar në ueb-faqen e ZRrE-së dhe i njëjti mund të qaset [këtu](#). Raporti për faktorin e efikasitetit poashtu është i publikuar dhe konsultuar. Përgjigjet ndaj komenteve mund të aksesohen [këtu](#).

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.2:

Kërkesat e operatorëve për shpenzime më të larta operacionale (OPEX) përmendin kryesisht inflacionin, stafin e ri dhe detyrat e zgjeruara të mirëmbajtjes. Megjithatë, rritje të tilla mund të fryjnë drejtpërdrejt tarifën e konsumatorit përfundimtar, përveç nëse operatorët demonstronjë fitime në produktivitet. KEDS-i ka kërkuar për OPEX një rritje nga 29.25 milionë euro (2024) në 40.35 milionë euro (kërkesë 2025), duke përmendur pagat dhe inflacionin. Pa kontrolle, tarifën rriten pa nevojë. GEK propozon lidhjen e rritjes së OPEX me matje të performancës, duke siguruar që konsumatorët të përballojnë vetëm shpenzime të justifikuara.

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.2:

ZRrE pajtohet me komentin por thekson se ZRrE tashmë ka përfshirë faktorin e pritshëm të efikasitetit dhe kostot e lejuara të humbjeve në të hyrat e lejuara të të licencuarve (shih përgjigjen në 2.3.1). Këta parametra caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike, të cilin ZRrE e ka përcaktuar në vitin 2023 dhe vlerjën deri në 2027. Sipas legjislacionit sekondar të ZRrE këta parametra nuk mund të ndryshojnë gjatë Përshatjeve të Rregullta (shih Kapitullin 2 të këtij dokumenti).

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.3:

Historikisht, ZRRE ka aplikuar një “faktor efikasiteti” (zakonisht 1–2%) mbi inflacionin. Ky dokument mbron që ZRRE të mbajë apo edhe ta forcojë atë faktor, duke siguruar që OPEX-i nuk mund të rritet thjesht duke u lidhur me inflacionin. Në vend të kësaj, një pjesë e rritjes së kostos të bazuar në inflacion duhet të kompensohet nga përmirësimet e synuara të efikasitetit.

Shtërngimi i këtyre rregullave mund të zvogëlojë ndjeshëm presionin në rritje mbi tarifën, duke garantuar që vetëm përshkallëzimi i OPEX-it të vlefshëm të kalojë tek konsumatorët fundorë, pasi është përcaktuar nga ZRRE se OPEX duhet të mbulohet 50/50 nga operatori dhe konsumatorët. Kjo qasje mund të kursejë 5-10 milion € në vit, duke ulur tarifën me ~ €1/MWh (0,35 €/muaj për familje).

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.3:

ZRrE pajtohet me komentin por thekson se ZRrE tashmë ka përfshirë faktorin e pritshëm të efikasitetit dhe kostot e lejuara të humbjeve në të hyrat e lejuara të të licencuarve (shih përgjigjen në 2.3.1 dhe 2.3.2). Këta parametra caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike, të cilin ZRrE e ka përcaktuar në vitin 2023 dhe vlerjën deri në 2027. Sipas legjislacionit sekondar të ZRrE këta parametra nuk mund të ndryshojnë gjatë Përshtatjeve të Rregullta (shih Kapitullin 2 të këtij dokumenti).

Indeksi i kostove në terma historike me normën e inflacionit është parim themelor në rregullim. Për shmangje të dyshimit, ZRrE konfirmon se çdo reflektim në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes bazohet në ndikimin neto në rritjen e kostove për shkak të inflacionit dhe zbritjen e tyre për shkak të faktorit të pritshëm të efikasitetit.

Faktori i Efikasitetit nuk duhet të përdoret si vegël për të arritur një rezultat të caktuar të tarifave por duhet të reflektojë përmirësimin e pritshëm të kompanisë së rregulluar. Raporti i detajuar i përcaktimit të faktorit të efikasitetit për vitin 2023 është publik në faqen e ZRrE-së.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.4:

Humbjet në shpërndarje (teknike + komerciale) mbeten shtytësi kryesor i MAR-it të përgjithshëm të KEDS-it. Nëse humbjet e lejuara janë shumë të larta ose nëse supozimet e energjisë me shumicë për mbulimin e tyre janë të fryra, faturat e konsumatorëve final rriten ndjeshëm. Me 14.28% humbje (kërkesa e operatorit) dhe një çmim me shumicë prej 117.50 €/MWh, humbjet rritin ndjeshëm MAR-in. Një reduktim i humbjeve prej 0,78% kursen 13,23 milion € në vit, ose 2,64 €/MWh

Mekanizmat e propozuar

- Shkalla e reduktuar e humbjeve të lejuara: ZRRE-ja mund të vendoste një kufi prej 13.5%.
- Moslejimi i pjesshëm: Për çdo pikë përqindje mbi 13.5%, ZRRE nuk lejon gjysmën ose të gjithë koston e tepërt nga MAR e KEDS-it. Përndryshe, zbaton një qasje të ndarjes së kostos ku vetëm 50% e kostove të humbjeve të paplanifikuara kalojnë në faturat e konsumatorëve.
- Stimulimi: Kursimet e ndara në mes të KEDS-it dhe konsumatorëve

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.4:

ZRrE pajtohet me komentin por thekson se ZRrE tashmë ka përfshirë cakun për reduktimin e humbjeve në të hyrat maksimale të lejuara.

Tabela: Caku i reduktimit të humbjeve për OSSH (2023-2027)⁵

Viti	2022	2023	2024	PRR3		
				2025	2026	2027
Humbjet aktuale - parashikimi	16.9%					
Propozimi i OSSH-së (propozimi fillestar)		16.9%	16.9%	15.7%	14.5%	13.3%
Propozimi i OSSH-së (rishikim)		15.1%	15.1%	15.1%	14.2%	13.3%
Propozimi i ZRRE-së		15.1%	14.7%	13.3%	12.1%	11.1%
Caku vjetor i reduktimit të humbjeve		0	-0.4	-1.4	-1.2	-1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve		50%	0%	0%	0%	0%

Ju lutem referojuni [Raportit Konsultativ të OSSH](#), kapitulli 2.1 për nivelin e rishikuar të humbjeve, pas integritimit të sistemit energjetik me 4 komunat veriore të vendit.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.5:

Operatorët propozuan linja të shumtë të shpenzimeve kapitale (CAPEX). Disa janë urgjente (p.sh., zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara për të reduktuar ndërprerjet), ndërsa të tjerat janë më pak kritike. Pa një kosto-përfitim të plotë filtri, CAPEX-i mund të rrisë tarifën ndjeshëm pa përfitime të menjëhershme ose të garantuara për konsumatorin. Green Energy Kosova poashtu propozon që investimet të realizohen në mënyrë strategjike duke pasur prioritet investimet që i shërbejnë sistemit dhe kanë kthim më të shpejtë në investim. Poashtu, Green Energy Kosova propozon që ndryshimet në mes të niveleve të lejuara dhe të realizuara të investimeve kapitale.

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.5:

ZRrE pajtohet me komentin dhe konfirmon se plani investiv i nënshtrohet shqyrtimit dhe aprovimit në pajtim me Rregullën për Përgaditjen e Planeve Zhvillimore dhe Investive, që përbën pjesë e legjislacionit sekondar të ZRrE. Rregulla mund të qaset duke klikuar [këtu](#).

ZRrE poashtu rithekson se planet investive aprovohen gjatë shqyrtimeve periodike dhe ato që hyjnë në bazën e rregulluar të aseteve mbeten të tilla deri në fund të periudhës tarifore (shih Shtojcën e Bazës së Rregulluar të Aseteve për Tarifën e OSSH-së/OST-së). Ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara bashkërenditen me interes në fund të çdo Periudhe Tarifore. Ky nuk është proces që adresohet gjatë Përshatjeve të Rregullta.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.6:

Kostot ndihmëse të KOSTT-it u rritën nga 43.12 milionë euro (2023) në 50 milionë euro (kërkesë 2025). Kostot ndihmëse prej 43.12 milionë eurosh të KOSTT-it janë të larta krahasuar me 30 milionë euro të Shqipërisë për një sistem të ngjashëm. GEK propozon menaxhimin nga ana e kërkesës (DSM) dhe balancimin ndërkufitar.

Të inkurajohen përdoruesit e mëdhenj që të zhvendosin përdorimin jashtë pikut për kapacitete ose kredi balancuese, duke reduktuar volumin që KOSTT duhet të prokurojë nga ofruesit ndihmës. Të

⁵ Kapitulli 4.2 i Raportit Përfundimtar për Cakun e Humbjeve: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf

paguhen përdoruesit industrialë 50 €/kW-vit për të shkurtuar 10 MWkapacitet, që do të kushtonte rreth 0.5 milion €, por duke kursyer 1-2 milion € në rezerva më afatgjate.

Të eksplorohehen ndarjet afatshkurtër të rezervave me Shqipërinë ose fqinjët e tjerë për të frenuar varësinë nga rezervat lokale, shpesh më të shtrenjta. Të ndahen rezervat me Shqipërinë, duke ulur kostot me 10% (4.3 milionë euro).

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.6:

ZRrE pajtohet me komentin dhe thekson se arsyeja kryesore e rritjes së kostos së shërbimeve ndihmëse vjen nga rritja e kontraktimit të kapaciteteve aFRR dhe mFRR si pasojë e kërkesave të ENTSO-E për përmirësim të balancimit të sistemit. Rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT siguron këtë rezervë përmes ankandëve javore nga OST e Shqipërisë. Çmimet për këto shërbime janë të ndryshme për çdo muaj dhe ndryshojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e marra për aFRR janë 48.8 €/MW për ngritje dhe 45.8 €/MW për zbritje. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me Palën Ofruese të Shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MWpër ngritje dhe -50 MWpër zbritje.

Detyrimi për rezervën buron nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit) ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kushteve të tregut mbi të cilat ZRrE nuk ka kontrollë në pajtim me Nenin 13.2 i [Rregullave të Tregut](#).

Rezerva e obligueshme është reduktuar ngaqë është në një zonë rregulluese me Shqipërinë. Po të mos ishte në të njëjtën zonë rregulluese rezerva do të duhej të ishte më i lartë (265 MW).

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.7:

Faktorët e korigjimit të të hyrave (KREVT) luhaten në mënyrë të shpeshtë në raportet e MAR (p.sh., KEDS nga – 13.95 milion € në + 26.20 milion € në 2024 dhe 33.62 milion € në 2025) kur supozimet e parashikimit vjetor devijojnë nga çmimet/sasia aktuale e energjisë. Kjo paqëndrueshmëri rëndon ose konsumatorët ose operatorët në ciklet pasuese të tarifave. Sa i përket kërkesës për shitje me shumicë të KESCO-s prej 161.41 €/MWh rrezikon një rritje prej 15%. Lëkundjet e KREVT (p.sh. 26.20 milionë euro të KEDS-it) pasqyrojnë parashikimet e gabuara të çmimeve me shumicë. Me 161.41 €/MWh (kërkesa KESCO), tarifrat mund të rriten 15% që është e papranueshme. Rekomandime:

- Nëse kostot aktuale të importit ndryshojnë nga parashikimet për ±5%, ZRRE mund të rregullojë koston e kalimit çdo tremujor
- Të kufizohet KREV në ±5% të MAR të një operatori në çdo vit të caktuar. Çdo tepricë bartet, duke zbutur goditjet tarifore. (p.sh. 9.08 milionë euro për KEDS).
- Tavani i shitjes me shumicë: 80-100 €/MWh. (në përputhje me HUDEX).

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.7:

KREV paraqet ndryshimet në të hyrat maksimale të lejuara që mund të ndodhin për shkak të ndryshimeve në mes të vëllimeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë që janë jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar. ZRrE pajtohet në parim se zvogëlimi i KREV do të ndikonte në

stabilitet të çmimeve por thekson se kjo nuk duhet të arrihet duke cenuar likuiditetin e kompanive të rregulluara apo mbulimin e kostove të tyre. Specifikisht, ndryshimi i KREV në baza kuartale do të kërkonte tarifa 3 mujore ndërsa kufizimi i tij do të mund të sillte deri te nën-mbulim apo mbi-mbulim i të hyrave maksimale të lejuara.

KREV është i përkufizuar në Metodologjinë Tarifore, shqyrtimi i së cilës nuk është pjesë e kësaj shqyrtimi tarifar.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.8:

Nëse ZRRE vendos të reduktojë MAR nga 217.77 milion € në 181.57 milion € = 36.2 milion € kursim total. Pjestuar me 5,500 GWh = ~ 6,58 €/MWh, ose 0,66 cent/kWh. Për një familje që përdor 350 kWh/muaj, kjo është ~2,31 euro kursime mujore vetëm nga rregullimi i KEDS-it. Nëse ZRRE gjithashtu zvogëlon MAR-in e KOSTT-it për 5 milion € dhe të KESCO-s me 10 milion €, efekti i akumuluar mund t'i afrohet 20-25 milion € në kursimet totale të sistemit, potencialisht e barabartë me ~ 10-15 milion € në faturat e ekonomive familjare, si një mesatare e moderuar. Rrjedhmisht Green Energy Kosova propozon:

- Tarifat e linjës sociale për bllokun e parë të konsumit (p.sh. 0–200 kWh/muaj)
- Subvencione për klientët e cenueshëm, të financuara pjesërisht nga qeveria ose një shtesë e vogël (surcharge) për konsumatorët e mëdhenj

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.8:

ZRrE kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo thekson se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë qartë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar dhe nevojave për investime për përmirësimin e infrastrukturës energjetike. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Komenti për ndryshimin e strukturës tarifore është i mirëseardhur pavarësisht se ZRrE nuk beson se tarifa sociale është mekanizëm efikas i adresimit të nevojave të konsumatorëve të cenueshëm. Megjithatë ZRrE gjatë këtij procesi nuk është duke shqyrtuar ndryshim të strukturës tarifore. Një shqyrtim i tillë do të kërkonte një analizë të detajuar të koston së shërbimit gjë që nuk mund të realizohet gjatë përshtatjeve të rregullta.

Koment nga Green Energy Kosova 2.3.9:

Në fund të komenteve Green Energy Kosova ofron një sërë rekomandimesh. Ato të cilat nuk janë adresuar po i përmbledhim në vijim:

- “Fitness check” i Metodologjive Tarifore: Duke pasur parasysh evoluimin e shpejtë të sektorit energjetik të Kosovës, duke përfshirë rritjen e gjenerimit të shpërndarë të ripërtërishtëm (Distributed Energy Resource), ZRRE duhet të rishikojë kornizat tarifore çdo tre deri në pesë vjet. Raporti i ACER vë në dukje se dy të tretat e vendeve të BE-së kanë përditësuar ose planifikojnë të përditësojnë tarifat e tyre për të qëndruar të përshtatshme për qëllimin (ACER, 2025), duke siguruar përshtatshmëri ndaj ndryshimeve të sistemit

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies: Të publikohen ndarjet e detajuara të komponentëve tariforë - kategoritë e kostos, supozimet e shitjes me shumicë dhe justifikimet CAPEX - në një vend (repository) të centralizuar, siç rekomandohet nga ACER (ACER, 2025). Kjo nxit shqyrtimin dhe drejtësinë e palëve të interesuara. Angazhoni konsumatorët, operatorët dhe shoqërinë civile herët dhe në mënyrë transparente, duke ofruar arsytetime të qarta për rregullime. Ky është çelësi për të siguruar mbështetjen për reformat e nevojshme.
- Modernizimi i Dizajnit Tarifor: Të eksplorohehë tarifat e bazuara në energji, tarifat e kohës së përdorimit (ToU) dhe sinjalet e vendndodhjes, duke u mbështetur nga shembujt evropianë si tarifat maksimale të Belgjikës dhe çmimet dinamike të Sllovenisë (ACER, 2025). Këto optimizojnë përdorimin e rrjetit dhe reduktojnë nevojat për investime. Të vlerësohet kaskadimi i kostove, tarifat e energjisë reaktive dhe marrëveshjet e lidhjeve fleksibël (FCA) për të rritur reflektimin e kostos dhe për të menaxhuar mbingarkesën e rrjetit, siç praktikohet në Holandë (ACER, 2025)

Përgjigjja e ZRrE për 2.3.9:

ZRrE pajtohet se metodologjitë tarifore duhen rishikuar për të shqyrtuar përshtatshmërinë e tyre me zhvillimet në sektor, sidomos për shkak të procesit të decentralizimit dhe nevojës së rritjes së aftësisë së kërkesës për të reaguar ndaj sinjaleve të çmimeve në treg. Megjithatë stabiliteti i kornizës rregullative është e rëndësishme qenësore për qëndrueshmërinë financiare të sektorit. ZRrE fton Green Energy Kosova të merr pjesë në shqyrtimet e ardhshme të metodologjive tarifore.

ZRrE poashtu mirëpret rekomandimet e Green Energy Kosova dhe raportin e ACER-it për të krijuar një vend të centralizuar për të dhënat lidhur me vendimet e ZRrE. Të gjitha vendimet e ZRrE-së, dhe konsultimet publike të cilat ndërlidhen me to, tashmë janë të publikuara në faqen e konsultimeve të ZRrE. Në rastin e konsultimeve për shqyrtimet tarifore të energjisë elektrike, të gjitha konsultat nga viti 2007 janë të publikuara dhe mund të qasen [këtu](#).

ZRrE pajtohet me modernizimin e dizajnit tarifor por thekson se struktura ekzistuese tarifore e ZRrE-së tashmë reflekton tarifat e kohës së përdorimit (ToU) dhe këto janë të reflektuara në tarifat ditë-natë. Por ZRrE thekson se sinjalet e vendndodhjes nuk janë të përshtatshme për shtete të vogla si Kosova ku nuk ka kufizime ndërkufitare. Për më tepër, kjo do të ishte në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Neni 45 paragrafi 1).

2.4 Komente nga Federata e Sindikatave të Pavarura Elektro Kosova

Koment nga Sidikata e Pavarur ElektroKosova KEDS 2.4.1:

Sindikata e Pavarur ElektroKosova KEDS përmes kesaj letrë shpreh shqetesimin e saj lidhur me nevojën për ngritje të pagave për punonjësit e kompanis KEDS.

Ne emer te te gjithë punetoreve qe perfaqesojme, drejtojmë kete kerkese per t'ju sjelle ne vemendje ctisa 9eshtje te rendesishme qe kerkojne trajtim te drejte, si: Inflacioni dhe ndikimi i tij ne fuqine blerese, pagat e uleta dhe barazimi i pagave me sektoret e ngjashem, si dhe levishmeria e punonjesve.

Duke pasur parasysh se Zyra e Rregullatorit per Energji eshte nje institucion i pavarur dhe eshte pergjegjes per miratimin e te hyrave te kompanive te rregulluara ne sektorin e energjise, perfshire

shpenzimet operative, te cilat perfshijne edhe pagat, po ju drejtohem per te shqyrtuar kerkesen tone per rritjen e pagave gjate ketij procesi te shqyrtimit.

Rritja e çmimeve te artikujve te domosdoshem dhe sherbimeve kane renduar buxhetin e punetoreve. Inflacioni i larte ne Kosove ka bere qe fuqia blerese e pagave te mbetet e ulet, duke i veshtiresuar shume punetoreve perballimin e kostove te jeteses. Kjo ka krijuar nje hendek te madh ndermjet pages qe ata marrin dhe nevojave te perditshme.

Sipas Agjencise se statistikave te Kosoves indeksi i teresishem i harmonizuar i çmimeve te konsumit eshte me i larte ne nje mesa tare prej 1.1 % ne muaj in dhjetor 2024, krahasuar me muajin dhjetor 2023. Inflacioni mujor ishte 0.7% ne muajin dhjetor 2024. Ndersa norma mesatare vjetore e inflacionit per vitin 2024 eshte 1.6%.

Punetoret jane te angazhuar dhe kontribuojne me nje nivel te larte profesionalizmi, por ende pagat mbeten te uleta. Ky hendek i vazhdueshem ka sjelle demotivim dhe paqartesi, pasi shume punetore e ndiejne se nuk vleresohen per punen e tyre te palodhur. Si9 dihet punetoret e KEDS-it punojne ne kushte te jashtezakonshme ne aspektin e terrenit dhe kushteve atmosferike, gjithmone me qellim te sigurimit te furnizimit te qendrueshem me energji elektrike, por pagat e tyre nuk reflektojne mundin dhe veshtiresite me te cilat perballen. Nje tjetër, kemi pabarazi te pagave mes sektoreve te ngjashem. Sindikata e pavarur ElektroKosova KEDS edhe viteve te kaluara ka kerkuar qe pagat e punetoreve te KEDS-it te jene ne te njejtin nivel me operatorët tjerë ne sektorin e energjise, mirepo kjo kerkese nuk ka gjetui asnjehere mbeshtetjen e duhur. Perderisa volumi dhe presioni i punes per punetoret e KEDS-it eshte rritur vazhdimisht, pagat kane mbetur te pa-nivelizuara me punetoret ne sektorin e njejte duke ulur motivimin e punetoreve dhe duke i shtyre ata te levizin drejt ketyre kompanive.

Sindikata e pavarur ElektroKosova KEDS eshte shume e shqetesuar edhe me ikjen e numrit te madh te punetoreve profesional. Levizshmeria e punonjesve ka arritur nivel shqetesuese, me nje rritje te vazhdueshme qe ka tejkaluar 8% ne vit te largmit te punetoreve pergjate dy viteve te fund it. Nese marrim parasysh se kompania KEK vazhdon te kete moshen e latte mesatare te punetoreve, ne kuptojme rrezikun qe po i kanoset KEDS-it me punetoret. Kjo tashme eshte deshmuar ne disa runde te punesimit ne KEK. Arsye e kesaj ikje padyshim jane kushtet me te mira te punes dhe nje page me e mire per ta si ne tregun e brendshem ashtu edhe te jashtem. Po ashtu, sipas disa studimeve te realizuara nga institucionet te ndryshme mbi ndikimin e liberalizimit te vizave ne tregun e punes ne Kosove, pritet nje rritje prej rreth 22% ne qarkullimin e stafit, nje kerkese prej 64% per rritjen e pagave nga punonjesit aktual, si dhe nje renie prej 40% ne numrin e aplikuesve te rinj per vendet e punes.

Duke marre parasysh te latte thenat, kerkojme nga ZRRE, qe para manjes se çdo vendimi te rrelekttoj ngritja e pagave. Trajtimi me paga me dinjitoze eshte me se e domostoshme ne kete kohe kur buxheti i punonjesve tane eshte renduar shume dhe kjo po reflektohet 9do dite e me shume me presion te vazhdueshem dhe pakenaqesi duke e bere te veshtire mbarevajtjen e operimeve ditore te kompanise.

Mbesim me shprese qe do te vleresoni drejte kerkesen e prashtruara.

Përgjigjja e ZRrE për Sindikatën e Pavarur ElektroKosova KEDS 2.4.1:

Në kuadër të procesit të konsultimit publik ZRrE ka mbajtur edhe takim konsultativ me Sindikata e Pavarur ElektroKosova KEDS. ZRrE rithekson që vlerësimi i kostove operative bazë (ku përfshihen edhe pagat e punëtorëve) për operatorët e rregulluar nuk është pjesë e këtij procesi (përshtatjet e

rregullta), por e shqyrtimeve periodike. ZRRE gjatë çdo përshtatje të rregullt indeksin kostot operative për inflacion, ku përfshihen edhe pagat e punonjësve. Këtë vit ZRRE ka rishikuar edhe kostot që dalin si rrjedhojë e ndryshimeve për pagë minimale.

2.5 Komente nga Klubi i Historianëve të Kosovës

Komenti nga Klubi i Historianëve të Kosovës 2.5.1:

Në emër të Klubit të Historianëve të Kosovës, dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë të thellë lidhur me rritjen e paralajmëruar prej 15% të çmimit të energjisë elektrike. Një vendim i tillë do të ketë ndikim negativ jo vetëm në jetën e përditshme të qytetarëve, por edhe në funksionimin e organizatave joqeveritare dhe grupeve të shoqërisë civile si klubi ynë. Si një organizatë e re që synon të promovojë edukimin dhe historinë, ne jemi të varur nga burimet financiare të kufizuara për të realizuar aktivitetet tona. Rritja e kostove të energjisë elektrike do të rëndojë më tej buxhetin tonë dhe mund të pengojë organizimin e ngjarjeve edukative, seminareve dhe projekteve për të rinjtë. Ju bëjmë thirrje institucioneve përkatëse të shqyrtojnë me kujdes këtë vendim dhe të marrin në konsideratë ndikimin e tij në shoqëri, veçanërisht tek organizatat që kontribuojnë në zhvillimin arsimor dhe kulturor të vendit. Shpresojmë që të gjendet një zgjidhje më e balancuar që mbron interesat e qytetarëve dhe organizatave si e jona.

Përgjigjja e ZRRE për 2.5.1:

Në bazë të legjislacionit në fuqi ZRRE, përcaktimi i tarifave për energjinë elektrike bëhet mbi bazën e kostove të justifikueshme të operatorëve dhe analizave të balancuara të performancës së sistemit energjetik. Ligji për Rregullatorin e Energjisë gjithashtu obligon ZRRE të përcaktojë tarifa që do të reflektojnë plotësisht koston e furnizimit të energjisë.

ZRRE nuk ka mandat të ofrojë mbështetje direkte për kategori specifike të konsumatorëve, si OJQ-të.

3 Komentet nga Institucionet e Republikës së Kosovës

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka pranuar komente nga Presidenca e Republikës së Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Zyra e Deputetit Armend Muja. Përgjigjet ndaj këtyre komenteve janë dhënë më poshtë.

3.1 Komente nga Presidenca e Republikës së Kosovës

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.1:

Presidenca po ndjek me shqetësim zhvillimet e fundit në vend, të cilat paralajmërojnë një rritje të mundshme të çmimit të energjisë elektrike. Sipas raporteve të ZRrE-së, pritet një rritje mesatare prej 15% për tarifën e konsumatorëve, duke filluar nga muaji prill. Ky vlerësim fillestar është bazuar në propozimet e dorëzuara nga kompanitë e rregulluara, si dhe vendimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2023-2027 për OST/OT dhe OSSH. Në vazhdë të një rritjeje potenciale, rikujtojmë se rritja e tarifave nuk mund të bëhet si një proces i izoluar, por duhet të marrë parasysh kontekstin zhvillimor dhe aspektin e mirëqenies në vend. Kjo kërkon një analizë të mirëfilltë të rrethanave duke u fokusuar poashtu në mbrojtjen e konsumatorëve dhe situatën ekonomike aktuale.

Përgjigja e ZRrE për 3.1.1:

ZRrE kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo njofton se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë qartë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar dhe nevojave për investime për përmirësimin e infrastrukturës energjetike. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.2:

Në këtë moment, një vendim i mundshëm nga Rregullatori për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët do të ishte në kundërshtim edhe me kornizën ligjore, e cila obligon ZRrE-në që ta sigurojë mbrojtjen e konsumatorit (*Neni 1, Ligji për Rregullatorin e Energjisë*).

Përgjigja e ZRrE për 3.1.2:

ZRrE nuk e ka të qartë se si mund të jetë në shkelje ZRrE të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë kur kjo theksohet qartazi në nenet e këtij ligji:

Neni 15 i Ligjit parandalon vendosjen e tarifave që janë nën kosto të shërbimit (Neni 15.4.2):

(15.4) Në rastet kur Rregullatori rregullon çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë ai...

(4.2) siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit të çmimeve për qëllim të sigurimit të shërbimit universal ta reflektojnë koston

Për më tepër, ZRrE nuk duhet të lejojë ndër-subvencionim të tarifave në mes të grupeve të konsumatorëve (Neni 15.4.1)⁶:

(4.1) siguron që kategori të ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe mbrojtje, si dhe rregullimi i çmimit të konsumit fundor të jetë në dispozicion vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Ligji parasheh mbrojtje për konsumatorët në nevojë në formë të subvencionimit të tyre, por këtë përgjegjësi ia cakton Qeverisë, përkatësisht Ministrisë përgjegjëse për mirëqenie sociale, që është në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare. Neni 50:

(3) Qeveria, përmes programit të vet të përgjithshëm për kategoritë sociale të shoqërisë adreson çështjen e kategorive sociale të konsumatorëve të energjisë. Ky program duhet të zbatohet nga Ministria përgjegjëse për Mirëqenie Sociale.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.3:

Megjithëse synimi është që të rritet siguria dhe furnizimi me energji gjatë vitit 2025, në përputhje me nevojat energjetike të vendit, rritja e çmimit të energjisë elektrike po parashihet të bëhet në një periudhë kohore kur veçse po ballafaqohemi me çmime të larta të produkteve në treg. Ky veprim do të mund të shkaktojë një valë të re të inflacionit në vend, si dhe të ndikonte drejtpërdrejt në rënien e fuqisë blerëse të qytetarëve.

Rritja e çmimit të energjisë ka një efekt të drejtpërdrejtë dhe shumë të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Çmimi i energjisë është i lidhur ngushtë me inflacionin, si dhe me koston e jetesës. Prandaj, shprehim shqetësimin tonë për faktin se një rritje e tillë e çmimit të energjisë do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve, duke rritur barrën e tyre financiare. Kjo do të përfshinte edhe rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore dhe shërbimeve të tjera thelbësore.

Çmimet e ushqimeve, të cilat kanë pasur një rritje të ndjeshme, janë të lidhura ngushtë me koston e energjisë dhe inflacionin në përgjithësi. Kostoja e jetesës është bërë shumë më e rëndë për qytetarët, duke bërë që shpenzimet për energji të arrijnë përqindje të larta të të ardhurave, veçanërisht për ata me paga më të ulëta.

Në këtë kontekst, ndërsa disa mund të argumentojnë se Kosova ka çmimin më të lirë të energjisë në rajon, ky qëndrim do të ishte i saktë vetëm nëse analizohet në një kontekst të izoluar. Për një vlerësim real të koston së energjisë, duhet të merret parasysh fuqia blerëse e qytetarëve, të ardhurat mesatare dhe Bruto Produkti Vendor për kokë banori. Po ashtu, paga mesatare në Kosovë është shumë më e ulët krahasuar me vendet e tjera të Evropës, duke bërë që rritja e çmimit të energjisë të ketë një ndikim më të rëndë tek qytetarët kosovarë, për shkak të fuqisë së ulët blerëse. Për ta shmangur një valë të re inflacioni dhe për t'i mbrojtur qytetarët dhe ekonominë kosovare, Presidenca propozon një seri rekomandimesh për ta parandaluar rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët.

⁶ Këto kërkesa ligjore përforcohen më tutje në Nenin 45 të Ligjit, që ndalon ndër-subvencionimet e çmimeve.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.3:

Ndikimi makroekonomik i tarifave është jashtë mandatit të ZRrE-së, por komentet janë të vlefshme për institucione të tjera shtetërore që merren me politikat ekonomike dhe sociale. ZRrE, në përputhje me mandatin e saj, ka ndërmarrë hapa për të reduktuar ndikimin e rritjes përmes rishikimit të kërkesave të operatorëve dhe përmes instrumenteve për rritje të efikasiteti, reduktim të humbjeve dhe refuzim të shpenzimeve që nuk justifikohen.

ZRrE rithekson se kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo njofton se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Enregjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë qartë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar dhe nevojave për investime për përmirësimin e infrastrukturës energjetike. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.4:

Sipas aplikacioneve të operatorëve, një nga arsyet kryesore të kërkesës për rritjen e çmimeve të energjisë është dështimi i KEK-ut për ta realizuar prodhimin e energjisë sipas planeve të tij vjetore. Ky dështim ka detyruar KEDS-in, të importojë energji me çmim shumë më të lartë (mesatarisht pesë herë më i lartë se prodhimi vendor), duke rritur kostot. Sipas KEDS-it, po ashtu, OSSH-ja ka importuar mbi 37 milionë euro më shumë se sa niveli i lejuar nga ZRrE-ja për vitin 2024.

Nga ana tjetër, rritja e humbjeve të projektuara për vitin 2025 prej pothuajse 57%, në krahasim me vitin paraprak është justifikuar me faktin se KEK-u, nuk pritet të gjenerojë energji në kapacitet të plotë dhe se kostoja e importit do të jetë shumëfish më e lartë. Megjithatë, duhet theksuar se kostoja aktuale e importit nuk është më e lartë se në vitet e kaluara, veçanërisht kur krahasohet me kulmin e çmimeve në vitin 2022 (aktualisht çmimi mesatar i importit është rreth 145 euro), si dhe nuk pritet ndonjë përshkallëzim drastik i çmimit të energjisë në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2025.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.4:

ZRrE thekson se shpenzimet për furnizim të konsumatorëve për shërbim universal duhet të reflektojnë ndryshimet në mes të çmimeve dhe vëllimeve të energjisë së parashikuara dhe të realizuara. Kjo ndikon, në mes tjerash, edhe kontratat e blerjes së energjisë nga KEK, Burimet e Ripërtërishme të Energjisë dhe Importin.

Parashikimet e ZRrE për çmimin e importit (duke përfshirë kostot ndërkufitare) të vitit 2025 edhe pse janë më të larta se parashikimet e ZRrE për çmimet e vitit të vitit 2024 (mbi të cilat janë caktuar tarifatat e vitit 2024), ato janë më të ulëta se çmimet e realizuara (apo reale) gjatë vitit 2024, dhe reflektojnë gjendjen reale të pritshme të tregut.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.5:

Mirëpo, një rritje e tillë e çmimit të energjisë do të ketë edhe një ndikim zinxhiror. Respektivisht, siç është cekur më lart, rritja e çmimit të energjisë ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe shumë të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Rrjedhimisht, çmimi i energjisë është i lidhur ngushtë me inflacionin dhe me koston e jetesës. Në rastin e Kosovës, rritja e tarifave të energjisë, veçanërisht rritja e çmimit të rrymës, do të ndikonte ndjeshëm në fuqinë blerëse të qytetarëve.

Kjo rritje e çmimit të energjisë (një rritje kumulative prej pothuajse 126% në katër vite) do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në çmimet e mallrave dhe shërbimeve, duke shkaktuar në një valë të re inflacioni. Sipas ASK-së, gjatë vitit 2022 dhe 2023, kur çmimi i energjisë u rrit ndjeshëm, çmimet e ushqimeve dhe produkteve të tjera thelbësore gjithashtu u rritën në mënyrë drastike.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.5:

Llogaritja e rritjes së çmimit të energjisë është e pasaktë. Presidenca nuk reflekton çmimin e realizuar mesatar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Llogaritja e saktë e çmimeve mesatare është dhënë në Kapitullin 3.8.7 të [Raportit Vjetor të ZRrE për vitin 2024](#). Aty ofrohen edhe tarifat mesatare për konsumatorët shtëpiak që në vitin 2021 ishin 5.60 c/kWh ndërsa në vitin 2024 janë 7.39 c/kWh. Ky ndryshim është 31% që nuk përkon me llogaritjet e Presidencës prej 126% për vitin 2024.


Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.6:

Pas rritjes prej 15%, Kosova do të ketë një nga kostot më të larta të energjisë, jo vetëm në rajon, por edhe përtej.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.6:

Në tregje të integruara, siç është tregu energjetik i Kosovës me vendet e rajonit, çmimet e produkteve të njëjta (energji elektrike në këtë rast) kanë tendencë të afrohen. Grafikoni i përdorur nga ZRrE në hapje të procesit konsultativ, si dhe figura më poshtë paraqiten për të treguar që çmimet e energjisë në Kosovë, edhe pas rritjes janë në linjë me çmimet e energjisë në rajon, por dukshëm më ultë se çmimet e energjisë në tregjet Evropiane me të cilat synojmë të integrohemi.

Figura: Çmimi mesatar i energjisë elektrike në Ballkanin perëndimorë gjatë vitit 2024 (pa taksa)



Presidenca rekomandon një sërë masash të menjëhershme, afatshkurtëra dhe afatgjata, të cilave ZRrE u përgjigjet për aq sa ato masa janë brenda mandatit dhe kompetencave të saj:

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.7:

Mirëmenaxhimi i shpenzimeve dhe humbjeve: Presidenca vlerëson se të hyrat e lejuara për KEDS-in kanë hapësirë për balancim të mëtjeshëm, përderisa niveli i humbjeve do të mund të kufizohet në nivelin e humbjeve të vitit të kaluar (65.37 milionë euro). Kjo ka kuptim, sidomos pasi që sipas parashikimeve aktuale, nuk pritet një rritje e ndjeshme e çmimeve të importit gjatë vitit 2025. Për më tepër, duke pasur parasysh se disa kalkulime dhe kosto të planifikuara nuk janë paraqitur në mënyrë

transparente, Presidenca konsideron se ka hapësirë për një rishikim të tyre, duke kontribuar kështu në reduktimin e humbjeve të projektuara.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.7:

ZRrE pajtohet me komentin por thekson se ZRrE tashmë ka përfshirë cakun për reduktimin e humbjeve në të hyrat maksimale të lejuara. Raporti për humbjet e lejuara është i publikuar në ueb-faqen e ZRrE-së dhe i njëjti mund të qaset [këtu](#). Ju lutem referojuni Raportit Konsultativ të OSSH, kapitulli 2.1 për nivelin e rishikuar të humbjeve, pas integritit të sistemit energjetik me 4 komunat veriore të vendit.

Tabela: Caku i reduktimit të humbjeve për OSSH (2023-2027)⁷

Viti	PRR3					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Humbjet aktuale - parashikimi	16.9%					
Propozimi i OSSH-së (propozimi fillestar)		16.9%	16.9%	15.7%	14.5%	13.3%
Propozimi i OSSH-së (rishikim)		15.1%	15.1%	15.1%	14.2%	13.3%
Propozimi i ZRRE-së		15.1%	14.7%	13.3%	12.1%	11.1%
Caku vjetor i reduktimit të humbjeve		0	-0.4	-1.4	-1.2	-1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve		50%	0%	0%	0%	0%

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.8:

Subvencionimi i energjisë: ZRrE-ja duhet të insistojë për një dialog me Qeverinë për ta shqyrtuar mundësinë e subvencionimit të energjisë për konsumatorët, veçanërisht për ata që janë më të prekur nga rritja e çmimeve. Praktika të tilla janë përdorur edhe në vitin 2022 gjatë shqyrtimit të tarifave, ku pjesa e subvencionimit ishte përfshirë në llogaritjen finale të tarifave. Kostoja për Qeverinë do të kishte efekt më të vogël në krahasim me ndikimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për qytetarët dhe pasojat e saj në rritjen e inflacionit.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.8

Subvencionet e faturave të energjisë nuk janë në kompetencë të ZRrE.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.9:

Identifikimi i masave shtesë për obligimin e pagesës së faturave mujore në katër komunat veriore: Duke marrë parasysh se një pjesë e konsiderueshme e humbjeve komerciale vjen si pasojë e faturave të papaguara nga konsumatorët në katër komunat veriore të vendit, inkurajojmë ZRrE-në që, në bashkëpunim me institucionet relevante, të identifikojë masa shtesë që do të obligonin konsumatorët të përmbushin detyrimin e tyre për pagesën e faturave mujore të energjisë elektrike. Masa të tilla do të ishin në përputhje me parimet e sundimit të ligjit, do të lehtësonin barrën financiare për operatorët, si dhe do të ndihmonin në parandalimin e nevojës për rritje të tarifave, siç është rasti aktual.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.9:

Kjo është adresuar në vendimin e ZRrE-së konform Vendimit të Gjykatës Kushtetuese ku është vendosur që këto mjete t'ju kthehen qytetarëve. Vendimi i ZRrE-së është apeluar nga KEDS dhe është në proces gjyqësor.

⁷ Kapitulli 4.2 i Raportit Përfundimtar për Cakun e Humbjeve: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.10:

Largimi ose reduktimi i përkohshëm i TVSH-së për energjinë elektrike: Largimi i TVSH-së për energjinë elektrike është një masë që është propozuar tashmë nga akterë të ndryshëm. Presidenca konsideron se një masë e tillë do të kontribuonte në menaxhimin e situatës dhe do të ndihmonte në shmangien e rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Nëse largimi i plotë i TVSH-së për një periudhë të caktuar do të ishte sfiudes, mund të shqyrtohet reduktimi i TVSH-së për një periudhë të caktuar. Disa nga shtetet që e kanë praktikuar këtë mekanizëm në vitet e fundit janë: Gjermania, Franca, Italia, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar, Polonia, etj.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.10:

Politikat tatimore nuk janë në kompetencë të ZRrE.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.11:

Dizajnimi dhe prezantimi i programit të shtyrjes së pagesave: Në disa vende janë zbatuar masa alternative për të lehtësuar ndikimin e rritjes së çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët. Një masë e tillë mund të jetë krijimi i mundësisë për konsumatorët të paguajnë faturat e energjisë elektrike me këste, duke ofruar edhe opcionet për periudha të mospagimit (grace period). Ky program do të ndihmonte në lehtësimin e barrës financiare për familjet dhe bizneset që përballen me rritjen e kostove të energjisë. Në praktikë, kjo mund të realizohet përmes bashkëpunimit me akterët kryesorë në sektorin e energjisë dhe atë financiar. Ky bashkëpunim do të mundësonte që konsumatorët të ndajnë pagesat e faturave të energjisë elektrike në këste më të vogla dhe më të menaxhueshme, duke lehtësuar kështu barrën financiare përmes shpërndarjes së saj.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.11:

ZRRE përcakton tarifa të bazuara në kosto për të siguruar që operatorët e sistemit të kenë të hyra të mjaftueshme për të ofruar shërbim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë për të gjithë konsumatorët. ZRRE nuk mund të ndërmarrë hapa për shtyrje të pagesave të cilat mund të ndikojnë negativisht në stabilitetin financiar të sektorit.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.12:

Menaxhimi efikas i KEK-ut dhe planifikimi i burimeve energjetike: Një nga masat më të rëndësishme është menaxhimi efikas i KEK dhe planifikimi i duhur i burimeve energjetike. KEK-u duhet të sigurojë administrim më të mirë të kapaciteteve prodhuese dhe të optimizojë përdorimin e burimeve të energjisë, duke zvogëluar humbjet dhe kostot e prodhimit. Gjithashtu, operatorët energjetikë duhet të mbajnë përgjegjësi për eficiencën dhe transparencën e aktiviteteve të tyre, duke shmangur ngarkimin e kostove të panevojshme mbi konsumatorët.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.12:

ZRRE pajtohet që operatorët e rregulluar nuk duhet të ngarkojnë kostot e panevojshme ndaj konsumatorëve por thekson se tarifat e KEK nuk rregullohen nga ZRrE që nga viti 2017. Për më shumë informata ju lutem referojuni [Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut](#).

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.13:

Rritja e efikasitetit të furnizimit me energji: Një masë tjetër e rëndësishme është përmirësimi i sistemit të shpërndarjes dhe rritja e kapacitetit të rrjetit elektrik. Ky proces do të mundësonte shpërndarjen më efikase dhe më të sigurtë të energjisë në të gjithë vendin, duke reduktuar humbjet teknike dhe duke ulur kostot në përgjithësi, e rrjedhimisht duke mundësuar shmangien e nevojës për rritjen e çmimeve për konsumatorët.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.13:

ZRrE pajtohet me komentin dhe konfirmon se plani investiv i nënshtrohet shqyrtimit dhe aprovimit në pajtim me Rregullën për Përgaditjen e Planeve Zhvillimore dhe Investive, që përbën pjesë e legjislacionit sekondar të ZRrE. Rregulla mund të qaset duke klikuar [këtu](#).

ZRrE poashtu rithekson se planet investive aprovohen gjatë shqyrtimeve periodike dhe ato që hyjnë në bazën e rregulluar të aseteve mbeten të tilla deri në fund të periudhës tarifore (shih Shtojcën e Bazës së Rregulluar të Aseteve për Tarifat e OSSH-së/OST-së). Ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara bashkërenditen me interes në fund të çdo Periudhe Tarifore. Ky nuk është proces që adresohet gjatë Përshtatjeve të Rregullta.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.14:

Vazhdimi i programeve të efijencës së energjisë për konsumatorët: Një masë tjetër e rëndësishme për të shmangur rritjen e çmimit të energjisë është vazhdimi i implementimit të programeve për efijencën e energjisë për konsumatorët. Këto mund të përfshijnë edukimin e konsumatorëve për përdorimin më efikas të energjisë dhe inkurajimin e mbështetjen e tyre për të investuar në pajisje energjitike më efikase, si dhe përmirësimin e izolimit të ndërtesave dhe përdorimin e burimeve alternative të energjisë. Këto masa do të ndihmojnë në uljen e kërkesës për energji dhe do të lejojnë që konsumatorët të kenë faturat më të ulëta, duke ruajtur kështu stabilitetin e çmimeve.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.14:

Skemat subvencionuese për efijencë nuk janë kompetencë të ZRrE.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.15:

Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike në vend: Një nga hapat më të rëndësishëm për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në Kosovë është ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese. Rritja e kërkesës për energji, së bashku me sfidat e burimeve ekzistuese të prodhimit të energjisë, e bën të domosdoshëm investimin në burime të reja prodhuese të energjisë. Kosova ka nevojë për zhvillimin e projekteve të reja energjetike, duke u fokusuar në diversifikimin dhe sigurinë e furnizimit me energji. Kjo do të zvogëlonte varësinë nga burimet ekzistuese dhe do të mundësonte një stabilizim të furnizimit, duke ulur kështu pasigurinë që mund të sjellin ndodhitë e papritura në sektorin energjetik. Përveç investimeve në burime alternative të energjisë, duhet të eksplorohej mundësitë për prodhimin dhe përdorimin e energjisë nga gaz natyror dhe teknologji të reja, që mund të ofrojnë mundësi shtesë për diversifikim. Rregullatori mund të inkurajojë këto investime duke ofruar stimuj dhe politika mbështetëse, si dhe duke krijuar një kuadër të qartë ligjor për zhvillimin e energjisë alternative. Presidenca vlerëson se çdo skenar i zhvillimit të sektorit të energjisë duhet gjithashtu të reflektojë zhvillimet gjeopolitike dhe interesat e Kosovës në dritën e këtyre zhvillimeve, duke u përqendruar gjithnjë në garantimin e sigurisë energjetike

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.15:

Kuadri rregullativ i ZRrE është në pajtim me strategjinë energjisë dhe politikat shtetërore për diversifikim të burimeve energjetike. Ndërtimi i kapaciteteve të reja kërkon politika të qëndrueshme rregullative dhe çmime që përcaktohen në nivel që reflekton koston, në mënyrë të qartë, transparente dhe pa ndërhyrje politike. Gjatë vitit 2024, ZRrE ka vlerësuar çmimet maksimale të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë, përkatësisht nga energjia diellore dhe energjia e erës, që do të mundësojnë investime shtesë përmes procesit të ankandëve.

Megjithatë, për të shmangur shtrembërimet në treg, çmimet e energjisë në tregun me shumicë duhet të lëvizin në nivel të çmimeve të tregut ashtu që konsumatorët vendorë të kenë mundësi të përfitojnë nga çmimet më të lira në treg, pavarësisht burimit të saj.

Koment nga Presidenca e Republikës së Kosovës 3.1.16:

Marrëveshjet për tregtinë ndërkufitare të energjisë me shtete aleate: Kosova mund të përfitojë nga tregtia ndërkufitare e energjisë, duke diversifikuar burimet e furnizimit dhe duke mundësuar importin ose eksportin e energjisë në periudha të kërkesës së lartë. Kjo mund të ndihmojë në stabilizimin e çmimeve, duke mundësuar që Kosova të përfitojë nga çmimet më të ulëta në tregjet ndërkombëtare. Rregullatori mund të mbështesë këtë proces duke mundësuar marrëveshje të tilla dhe duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin ndërkombëtar. Një marrëveshje të tillë, Kosova e ka tashmë me Shqipërinë, dhe ngjashëm mund të shqyrtohet mundësia që kjo të realizohet edhe me shtete të tjera të rajonit të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Përgjigjja e ZRrE për 3.1.16:

Lidhja e marrëveshjeve ndërqeveritare për bashkëpunim në fushën e energjisë nuk është kompetencë e ZRrE-së. ZRrE dhe rregullatorët në regjion punojnë për krijimin e një kuadri rregullator që mundëson dhe lehtëson funksionimin efikas të tregut të energjisë elektrike dhe integrimin në tregun pan-Evropian, përfshirë edhe aspektet që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkufitare në përputhje me rregullat e Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit Evropian.

3.2 Komente nga Ministria e Ekonomisë

Koment nga Ministria e Ekonomisë 3.2.1:

Reflektimi i prodhimit të shtuar nga blloku B2 pas modernizimit të turbinës: Ne jemi të vetëdijshëm që ndalja e bllokut B2 për më se 4 muaj gjatë këtij viti ka rritur parashikimet e importit dhe rrjedhimisht edhe presionin për rritje të tarifave. Mirëpo, njëkohësisht ZRrE duhet të marrë parasysh efektet pozitive nga investimet në bllokun B2 të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për modernizim të turbinës dhe investimet tjera të planifikuara do rezultojnë me:

- rritje të kapacitetit e prodhimit për 14-17 MWqë nga fundi i shtatorit;
- rritje të prodhimit për rreth 30 GWh në periudhën tetor-dhjetor 2025.

Duke marrë parasysh që këta janë muajt më kritikë të vitit kur çmimet e blerjes së energjisë dhe tarifat e transmisionit janë më të larta, vijmë në përfundim se konsumatorët do të kursejnë së paku 6 milionë euro në import gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025, gjë që duhet të reflektohet në ulje të hyrave të lejuara dhe rrjedhimisht të propozimit për rritje të tarifave. të rrethanave duke u fokusuar poashtu në mbrojtjen e konsumatorëve dhe situatën ekonomike aktuale.

Përgjigjja e ZRrE për 3.2.1:

ZRrE pajtohet me komentin e Ministrisë por thekson se rritja e kapacitetit pas remontit tashmë është përfshirë në bilancin energjetik të përdorur nga ZRrE.

Koment nga Ministria e Ekonomisë 3.2.2:

Nevoja për import gjatë vitit 2024 identifikohet si një nga arsyet kryesore për propozimin e rritjes së tarifave. Nga analiza e të dhënave të sektorit shohim që:

- prodhimi i energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK) ka pasur një rritje prej 7% krahasuar me vitin paraprak, dhe ngjashëm edhe prodhimi i gjithëmbarshtëm vendor (sipas të dhënave nga KOSTT);
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga KEK-u ka mbetur i njëjtë;
- konsumi i gjithëmbarshtëm në vend është ulur për rreth 0.9% në krahasim me vitin paraprak (sipas të dhënave nga KOSTT); ndërsa konsumi i amvisërive është rritur për 0.85% (sipas të dhënave nga FSHU-KESCO);
- importi i gjithëmbarshtëm i energjisë elektrike në vend është ulur për 2.5% në krahasim me vitin paraprak (sipas të dhënave nga KESCO).

Megjithëse të dhënat e Bursës Hungareze të Energjisë Elektrike (HUPX) tregojnë se çmimi mesatar gjatë vitit ka mbetur përafërsisht i njëjtë. Me gjithë rritjen e dukshme të çmimi gjatë muajve të dimrit, p.sh., sipas HUPX çmimi mesatar ishte rreth 65% dhe 75% më i lartë krahasuar me muajt e njëjtë të vitit paraprak, nëse i shohim këto të dhëna si tërësi është e paqartë se si ka ardhur deri te një dallim kaq drastik i parashikimit në krahasim me procesin tarifor të vitit të kaluar kur jo vetëm që nuk kishte rritje, por kishte ulje të tarifave për bllokun mbi 800 kWh dhe për bizneset.

Rrjedhimisht, konsiderojmë që:

- çështja e kostos së importit duhet të analizohet seriozisht nga ZRrE, duke përfshirë komponentet që kanë rezultuar me rritje të vlerës së importit, dhe e njëjta të sqarohet për publikun;
- të vlerësohet nëse ato kanë mundur të menaxhohen më mirë nga operatorët dhe, në rast se po, të mos pranojë shpenzimet dhe/ose të detyrojë operatorët të ndërmarrin hapa për përmirësim;
- efektet e këtyre përmirësimeve të reflektohen në uljen e të hyrave të lejuara të operatorëve gjatë këtij viti, dhe rrjedhimisht zbutjen e efektit në rritjen e propozuar.

Përgjigjja e ZRrE për 3.2.2:


Para çdo viti tarifor, ZRrE bën llogaritjen e kostos së blerjes së energjisë me shumicë, duke marrë parasysh vëllimet e parashikuara të energjisë së ofruar nga KEK, BRE dhe energjisë së importuar. Krahas këtyre vëllimeve, kjo llogaritje parasheh edhe çmimet e energjisë nga burimet respektive, duke përfshirë edhe energjinë e importit. Kostoja e parashikuar e importit, si mesatare e ponderuar, për vitin 2024 ishte 97.79 EUR/MWh.

Në fund të çdo viti tarifor, ZRrE bën bashkërenditjen e kostos së blerjes së energjisë për vitin e kaluar tarifor. Këto llogaritje përfshijnë ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të

vëllimeve të energjisë nga burimet e furnizimit dhe çmimet e shitjes së energjisë. Në rastin e çmimeve, energjia e KEK dhe BRE furnizohet me kontrata afatgjata çmimet e të cilave nuk ndryshojnë brenda vitit. Në rastin e kostos së importit, çmimi i realizuar i blerjes së energjisë, që përfshinë importin e energjisë dhe kapacitetet transmetuese, ishte 181.34 EUR/MWh.


Ndryshimi në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë për FSHU në vitin e kaluar është €47.37 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifat e ardhshme të energjisë elektrike.

Figura: Ndryshimet në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (FSHU)




Në rastin e OSSH, kostoja e blerjes së energjisë ndikohet më ndjeshëm nga çmimet e importit ngaqë energjia në rrjet mund të blihet nga prodhimet vendore vetëm atëherë kur mbulohet tërësisht kërkesa për konsumatorët e shërbimit universal. Në rastet kur kërkesa e energjisë elektrike i tejkalon parashikimet, siç ka ndodhur për shembull në dhjetor të 2024, OSSH duhet të importojë më shumë energji elektrike ngaqë kapacitetet e KEK ngarkohen me furnizimin e shërbimit universal.

Kostoja e parashikuar e blerjes së energjisë nga OSSH ishte 96.13 EUR/MWh ndërsa ajo e realizuar ishte 147.15 EUR/MWh. Në kombinim me ndryshimet në vëllimin e energjisë së importuar, ky dallim në çmim ka rezultuar në rritje të kostos së blerjes së energjisë nga OSSH në vlerë prej €37.84 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifat e ardhshme të energjisë elektrike. Një përmbledhje e kostos së blerjes së energjisë së OSSH është dhënë në tabelën në vijim.

Figura: Ndryshimet në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (OSSH)


Kostoja e parashikuar e blerjes së energjisë poashtu u ndikua nga rritja e kostos së çmimeve të kapaciteteve ndërkufitare në Kosovë të cilët shënuan një rritje të ndjeshme në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak.

Figura: Çmimet e kapaciteteve ndërkufitare të realizuara (djathtas)


Koment nga Ministria e Ekonomisë 3.2.3:

Analizat tona të strukturës së konsumit (sipas të dhënave nga FSHU-KESCO) ndër vite tregojnë disa trende në strukturën e konsumit që konsiderojmë që janë pozitive:

- konsumi i amvisërive që po rritet me ritme jashtëzakonisht të larta prej mesatarisht 7.2% në vit në periudhën 2017-2021, duke rritur edhe nevojën për import, tashmë është stabilizuar. Në 3 vitet e fundit, konsumi i amvisërive është rritur për më pak se 0.2% mesatarisht;
- konsumi i bizneseve në treg të rregulluar është rritur mesatarisht për 6.5% në tri vitet e fundit;
- si rezultat, pjesëmarrja e bizneseve në konsumin e energjisë elektrike në treg të rregulluar është rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur rekordin prej 38% të konsumit, nga 31.9% e 32.9% sa ishte në vitet 2020-21;

- një pjesë e konsiderueshme e konsumit gjatë dimrit vjen nga një përqindje e vogël e konsumatorëve, p.sh.: në nëntor 2024, 12% e amvisërive (me konsum mbi 1000 kWh) kanë konsumuar 39% të energjisë elektrike të gjithëmbarshme; ose, në janar 2025, 9% e konsumatorëve (me konsum mbi 2000 kWh) kanë konsumuar 29% të energjisë së gjithëmbarshme elektrike, dhe më shumë se të gjithë konsumatorët që kanë shpenzuar nën 800 kWh së bashku.

Këto trende tregojnë që:

- vendosja e bllok-tarifës nga ZRrE dhe zbatimi e përkrahja e investimeve në efikasitet të energjisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës kanë pasur sukses në frenim të konsumit, dhe kjo përkundër kycjes në sistem të 63 mijë shtëpive e banesave të reja;
- rritja e konsumit për dallim nga e kaluara, tani po vije kryesisht nga bizneset që tregojnë rritje të aktivitetit ekonomik;
- mirëpo, megjithatë, ka një koncentrim tejet të lartë të konsumit tek një numër i vogël i konsumatorëve shtëpiakë që kanë nivel konsumi jashtëzakonisht të lartë (mbi 2000 kWhose edhe mbi 3000 kWh).

Duke marrë parasysh këto më lart, konsiderojmë që është e drejtë që:

- ZRrE në parashikimin e konsumit dhe importit të reflektojë saktë frenimin e rritjes së konsumit të amvisërive, dhe rritjen e konsumit të bizneseve, një pjesë e të cilave do të dalin në treg, duke ulur presionin në tarifa të rregulluara, duke ulur kështu të hyrat e lejuara dhe rrjedhimisht edhe rritjen e propozuar të tarifave.
- konsumatorët që konsumojnë më pak se 800 kWh në muaj të mos kenë rritje të tarifës;
- konsumi i amvisërive mbi 800 kWh të ndahet në më shumë breze (blloqe), dhe tarifatat të jenë progresive ashtu që të mbrojnë konsumatorët që shpenzojnë më pak dhe të nxisin kursimin te ata që kanë nivele jashtëzakonisht të larta konsumi;
- shpërndarja e barrës të merr parasysh trendet e konsumit (dhe rrjedhimisht nevojës për import) nga amvisëritë dhe bizneset që kanë ndryshuar, dhe faktin që gjatë viteve të kaluara amvisëritë e bartur barrë më të madhe të rritjes krahasuar me bizneset.

Përgjigjja e ZRrE për 3.2.3:

ZRrE e konsideron të rëndësishme se çmimet në çdo bllok të mbështeten në kosto dhe të mos krijojnë shtrembërime ose ndër-subvencione të paarsyeshme ndërmjet konsumatorëve. ZRrE pajtohet se kostoja mesatare e furnizimit për konsumin mbi prag mund të jetë më e lartë për shkak të nevojës për import. Megjithatë ZRrE e konsideron të rëndësishme që kostoja e shërbimit të reflektohet pavarësisht bllokut të konsumit, në pajtim me Kapitullin 6 të Përgjigjeve ndaj Komenteve.

3.3 Komente nga Zyra e Deputetit Armend Muja

Koment nga Zyra e Deputetit Armend Muja 3.3.1:

Deputeti Armend Muja ka ngritur një sërë vërejtjesh që kanë të bëjnë me kostot e OST-së, OSSH-së dhe borxhit të keq. Sipas deputetit Muja këto kosto hapin mundësi për inflacion të çmimeve transferuese në ndarjen e kostove të rrjetit. Më tutje Deputeti Muja thekson se shpenzimet operative të KESCO, KOSTT dhe KEDS janë të larta dhe duhet të reflektojnë dinamikën e ngjashme në rajon dhe

BE. Gjithashtu, kosto operative duhet të reduktohet pas liberalizimit të tregut, marrë në konsideratë numrin më të ulët të konsumatorëve (sidomos atyre të mëdhënj).

Deputeti Muja rekomandon Reduktimn e kostove operative (OPEX) duke optimizuar shpenzimet për personelin dhe mirëmbajtjen, përdorimi e teknologjive më të avancuara për monitorim dhe automatizim në rrjet për të ulur kostot administrative dhe teknike, ristrukturimin e shpenzimeve të stafit dhe eliminimi i shpenzimeve joefektive në sektorin e shpërndarjes dhe transmetimit dhe uljen e borxhit të keq.

Deputeti Muja rekomandon të porositen auditime të pavarura të komponentëve të kostove që tregojnë devijime të mëdha vjetore, veçanërisht ato që lidhen me rrjetin dhe humbjet.

Përgjigjja e ZRrE për 3.3.1:

ZRrE pajtohet që kostot operative duhen lejuar në nivel të arsyeshëm. Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes të kompanive të Rregulluara janë caktuar gjatë procesit të shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe të njëjtat indeksohen me normën e inflacionit dhe përmirësimet e pritshme përmes faktorit të efikasitetit. Kompanitë e rregulluara me detyrim të shërbimit publik duhet të jenë në gjendje të mbulojnë një nivel të arsyeshëm të Kostos së boxhit të keq, në pajtim me Nenin 48, paragrafi 3, nënparagrafi 3.8 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Raporti konsultativ për vlerat hyrëse mund të qaset [këtu](#) ndërkaq raporti përfundimtar pas përgjigjeve ndaj komenteve mund të qaset [këtu](#).

Koment nga Zyra e Deputetit Armend Muja 3.3.2:

Duke iu referuar humbjeve të energjisë elektrike në rrjet, Deputeti Muja vlerëson se ato u rritën nga 50.88 milionë € në vitin 2021 në 106.65 milionë € në vitin 2022, një rritje prej 109.5%. Kostot vazhdojnë të luhaten ndjeshëm (bien në 65.37 milionë € në 2024, pastaj rriten në 97.57 milionë € në 2025). Në përgjithësi, ka nevojë që të analizohet qasja ndaj humbjeve – konsumatori është ngarkuar me kosto enorme të humbjeve që nga viti 2018. Politika e zbatuar që nga viti 2018 nuk është e duhur nuk justifikohet me rritjen e cmimit të energjisë. Rrjedhimisht rekomandohet që:

- Ulja e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje është një faktor kyç për uljen e MAR. Nëse humbjet zvogëlohen, nevoja për tarifa më të larta do të reduktohet.
- Penalizimet për KESCO, KEDS dhe KOSTT për dështimet në parashikime dhe mos-realizimin e kontratave afatgjatë për blerje të energjisë për humbjet. Analizë e detajuar dhe auditim i posacëm për neglizhencë të qëllimshe
- Analizë e influencës potenciale të kontraktorëve të energjisë së importuar nga KESCO, KOSTT dhe KEDS për të sqaruar dyshimet në lidhje influencën e kontraktorëve.
- Monitorimi i investimeve në modernizimin e rrjetit për të zvogëluar rrjedhjet e paautorizuara dhe për të përmirësuar menaxhimin e ngarkesave.
- Monitorimi i investimeve në mirëmbajtje të rrjetit nga KEDS, KOSTT dhe ndikimin që ka mos-realizimi në humbjet teknike
- Monitorimi i humbjeve të pajustificuara dhe të koncentruara në distriktin e Pejës dhe nëse KESCO është duke eskivuar përgjegjësitë.

- Negocimi i marrëveshjeve më të favorshme për blerjen e energjisë, sidomos për importet dhe furnizimet afatgjata

Deputeti Muja rekomandon të aplikohen standarde më të rrepta dhe rrugëzime për uljen graduale të humbjeve teknike. Strategjia e Energjisë nuk parasheh humbje komerciale nga viti 2025. Gjithashtu, humbjet duhet të vlerësohen nëse janë përmbajtuar caqeve të Strategjisë së Energjisë, caqeve të ZRRE sipas % (khë), nëse është zbatuar kosto e drejtë sipas caqeve. Kostoja për mbulimin e humbjes përmes importit të energjisë apo tregut të hapur ka të gjitha predispozitat e dështimit spektakular për të zbatuar kontrata afatgjata, megjithë parashikimet. Nuk mund ti bartën konsumatorit, janë dështime tipike të KEDS. Arsyetimet se KEK nuk ka ofruar kaq energji nuk justifikojnë vendimin.

Përgjigjja e ZRrE për 3.3.2:

Reduktimi i humbjeve është një objektivi afatgjatë që reflektohet si në vlerësimin e performancës së operatorëve, ashtu edhe në procesin e përcaktimit të të hyrave të lejuara dhe në trajtimin e devijimeve vjetore. ZRrE tashmë ka përcaktuar caqe për reduktimin e humbjeve dhe ky raport mund të qaset [këtu](#). Caqet për reduktimin e humbjeve të lejuara në tarifa në vitin 2025 është 13.3% ndërkaq i njëjti duhet të ulet në 11.1% në vitin 2027. Ju lutem referojuni [Raportit Konsultativ të OSSH](#), kapitulli 2.1 për nivelin e rishikuar të humbjeve, pas integritimit të sistemit energjetik me katër komunitat në veri të Kosovës.

Tabela: Humbjet e lejuara të energjisë elektrike

Viti	PRR3					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Humbjet aktuale - parashikimi	16.9%					
Propozimi i OSSH-së (propozimi fillestar)		16.9%	16.9%	15.7%	14.5%	13.3%
Propozimi i OSSH-së (rishikim)		15.1%	15.1%	15.1%	14.2%	13.3%
Propozimi i ZRRE-së		15.1%	14.7%	13.3%	12.1%	11.1%
Caku vjetor i reduktimit të humbjeve		0	-0.4	-1.4	-1.2	-1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve		50%	0%	0%	0%	0%

ZRrE konfirmon se plani investiv i nënshtrohet shqyrtimit dhe aprovimit në pajtim me Rregullën për Përgaditjen e Planeve Zhvillimore dhe Investive, që përbën pjesë e legjislacionit sekondar të ZRrE. Rregulla mund të qaset duke klikuar [këtu](#).

ZRrE poashtu rithekson se planet investive aprovohen gjatë shqyrtimeve periodike dhe ato që hyjnë në bazën e rregulluar të aseteve mbeten të tilla deri në fund të periudhës tarifore (shih Shtojcën e Bazës së Rregulluar të Aseteve për Tarifat e OSSH-së/OST-së). Ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara bashkërenditen me interes në fund të çdo Periudhe Tarifore. Ky nuk është proces që adresohet gjatë Përshtatjeve të Rregullta.

ZRrE nuk ka kompetenca hetimore ose penale për ndikimin potencial të operatorëve të aluduar nga Deputeti Muja. Këto çështje duhet të trajtohen nga organet përkatëse mbikëqyrëse dhe hetimore.

ZRrE pajtohet se konsumatorët mund të përfitojnë nga kontratat afatgjata që stabilizojnë luhatjet e çmimeve në treg me kusht që këto të jenë konkurruese dhe të mos ndëshkojnë konsumatorët në rast të rënies së çmimeve. Parashikimet e ZRrE të koston së blerjes së energjisë bazohen në të dhënat e çmimeve në avancë të publikuar në HUDEX. Megjithatë kontratat afatgjata përballen me rrezikun e

uljes së çmimeve dhe kostove të mbetura të cilat nuk mund t'i faturohen konsumatorëve. ZRrE mirëpret çdo rekomandim apo përmirësim në metodologjinë e FSHU që mund të adresojë luhatjet e çmimeve në treg dhe të shërbejë në të mirë të konsumatorëve.

Koment nga Zyra e Deputetit Armend Muja 3.3.3:

Zyra e Armend Mujës e konsideron anomali rritjen e kostos së zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar nga 6.5 milionë € (2013) në 22.63 milionë € (2025) - Trendi i zhvlerësimit është me shumë anomali dhe kërkon verifikim të abuzimit potencial me vendimin e ZRRE të vitit 2018 për kategorizimin e aseteve të vjetra dhe të reja dhe zbatimin e normës së zhvlerësimit për to. Për këtë është e rëndësishme të verifikohen baza e aseteve, komisionimi i aseteve dhe zbatimi i normave të zhvlerësimit sipas vendimit të ZRRE dhe praktikave ndërkombëtare. Është evidente që nga viti 2018 janë rritur kostot e zhvlerësimit, potencialisht duke abuzuar me vendimin e ZRRE. Një analizë më e detajuar sikurse edhe kërkesa drejtuar Zyrës Kombëtare të Auditimit do të pasojnë pas sigurimit të të dhënave të plota të bazës së aseteve (RAB), politikës së zhvlerësimit, metodologjisë së përdorur dhe orarit të zhvlerësimit sipas datës së komisionimit të aseteve.

Luhatje të pajustificuara të humbjeve të lejuara, që mund të tregojnë joefikasitet ose mbivlerësim. Rritja e zhvlerësimit dhe kthimit kërkon verifikim në raport me bazën reale të aseteve (RAB). Ka një vendim të ZRRE (2018) mbi jetëgjatësinë e aseteve të vjetra dhe të reja. Ka nevojë që të analizohet dhe verifikohet sepse ekziston një anomali. Për këtë do të porositet një auditim i posaçëm. Normat e zhvlerësimit dhe kostoja nuk korrelojnë me investimet (Capex). Ekzistojnë dyshime në shikim të parë për rreth 4-5 milionë euro inflacion mbi tarifën që rezultojnë nga keq-zbatimi apo abuzimi me kostot e zhvlerësimit nga ana e KEDS/KOSTT.

Përgjigjja e ZRrE për 3.3.3:

ZRrE konfirmon se plani investiv i nënshtrohet shqyrtimit dhe aprovimit në pajtim me Rregullën për Përgaditjen e Planeve Zhvillimore dhe Investive, që përbën pjesë e legjislacionit sekondar të ZRrE.

Rregulla mund të qaset duke klikuar [këtu](#).

ZRrE poashtu rithekson se planet investive aprovohen gjatë shqyrtimeve periodike dhe ato që hyjnë në bazën e rregulluar të aseteve mbeten të tilla deri në fund të periudhës tarifore (shih Shtojcën e Bazës së Rregulluar të Aseteve për Tarifën e OSSH-së/OST-së). Ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara bashkërenditen me interes në fund të çdo Periudhe Tarifore. Ky nuk është proces që adresohet gjatë Përshtatjeve të Rregullta.

Rritja e kostos së zhvlerësimit dhe e kostos së kthimit të lejuar vjen si pasojë e rritjes së bazës së rregulluar të aseteve.

- Kostoja e zhvlerësimit llogaritet si herësi në mes të bazës së rregulluar të aseteve dhe jetëgjatësisë mesatare të ponderuar të aseteve. Nëse rritet baza e rregulluar e aseteve (rriten investimet), atëherë rritet edhe zhvlerësimi për to.
- Kostoja e kthimit të lejuar llogaritet si prodhimi në mes të bazës së rregulluar të aseteve dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Nëse rritet baza e rregulluar e aseteve (rriten investimet), rrjedhimisht rritet edhe kostoja e kapitalit. Raporti përfundimtar për koston e kapitalit

Raporti përfundimtar për koston e lejuar të kapitalit mund të qaset [këtu](#). Raporti i ZRrE për investimet kapitale dhe të hyrat maksimale të lejuara në kuadër të shqyrtimit periodik në rrjetin e shpërndarjes

mund të qaset [këtu](#). Raporti për investimet kapitalie dhe të hyrat maksimale të lejuara në kuadër të shqyrtimit periodik në rrjetin e transmisionit mund të qaset [këtu](#).

Koment nga Zyra e Deputetit Armend Muja 3.3.4:

Zyra e Armend Mujës i konsideron të paqëndrueshme kostot e burimeve të ripërtërishme të energjisë: nga 2.87 milionë € (2017) në 20.93 milionë € (2023), më pas bien në 17.34 milionë € (2025). Gjithashtu, tejkalimi i vazhdueshëm i të hyrave nga fondi i BRRE nga KOSTT kërkon një vlerësim, shpjegim dhe auditim të posaçëm. Deputeti Muja poashtu thekson se kostot e humbjeve të OST më shumë se dyfishohen nga 6.53 milionë € (2021) në 13.97 milionë € (2025).

Përgjigjja e ZRrE për 3.3.4:

Kostot e blerjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme ndryshojnë për shkak të rritjes së kapaciteteve të energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë që përfshihen në fondin e BRE. Këto mund të ndryshojnë edhe për shkak të ndryshimeve në mes të parashikimit të energjisë së prodhuar dhe vlerës së realizuar përgjatë viteve, që nuk varen nga operatorët e këtyre gjeneratorëve.

Humbjet e Lejuara të Rrjetit për Sistemin e Transmisionit në përqindje nuk janë rritur por janë vendosur në vitin 2023 të jenë 1.75% deri në vitin 2027 me një faktor ndarës 50%. Rritja e kostos së humbjeve që mund të shkaktohet nga kostoja e importit, dhe si e tillë është jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar, duhet të mbulohet në të hyrat e lejuara maksimale. Raporti i ZRrE për humbjet e lejuara mund të qaset [këtu](#).

Koment nga Zyra e Deputetit Armend Muja 3.3.5:

Duhet inciohet dhe zbatohet në afatin me të shkurtër një politikë progresive tarifore (ITB) në më shumë së dy breza. Të dhënat në konsultim publik nuk janë evidente se si bëhet shpërndarja e kostos nëpër breza tarifor. Konsumatorët familjarë me të ardhura të ulëta do të ndjejnë më shumë ndikimin e tarifave të reja, veçanërisht në dimër kur konsumi i energjisë është më i lartë. Rritja e çmimeve të energjisë do të ulë fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe mund të çojë në reduktim të shpenzimeve për mallra dhe shërbime të tjera.

Përgjigjja e ZRrE për 3.3.5:

Parimi themelor në përcaktimin e tarifave të energjisë elektrike është reflektimi i saktë i kostove të justifikueshme të kompanive të rregulluara.

ZRrE e konsideron të rëndësishme se çmimet në çdo bllok të mbështeten në kosto dhe të mos krijojnë shtrembërime ose ndër-subvencione të paarsyeshme ndërmjet konsumatorëve. ZRrE pajtohet se kostoja mesatare e furnizimit për konsumin mbi prag mund të jetë më e lartë për shkak të nevojës për import. Megjithatë ZRrE e konsideron të rëndësishme që kostoja e shërbimit të reflektohet pavarësisht bllokut të konsumit, në pajtim me kapitullin 6 të këtij raporti.

ZRrE gjithashtu kupton shqetësimin për ndikimin social dhe ekonomik të tarifave, mirëpo njofton se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë qartë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar dhe nevojave për investime

për përmirësimin e infrastrukturës energjetike. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

4 Komentet nga ndërmarrjet energjetike

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka pranuar komente nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesi i Shërbimit Publik dhe *Elektrosever*:

4.1 Komente nga OST

Koment nga OST 4.1.1:

KOSTT thekson se çmimi mesatar i parashikuar nga ZRrE për mbulimin e humbjeve, 105.70 €/MWh, është më i ulët se kostoja reale që është hasur gjatë muajve janar dhe shkurt 2025. Në këto muaj, kostoja totale për blerjen e humbjeve ka arritur vlerën 4,911,066.39 milionë euro, me çmim mesatar 154.01 €/MWh, që është dukshëm më i lartë se parashikimi. Për më tepër, krahasimi me çmimet e ALPEX për të njëjtën periudhë në vitin 2024 (janar 90.47 €/MWh dhe shkurt 74.75 €/MWh) tregon një tendencë të qartë rritëse të çmimeve të energjisë elektrike. Kjo tregon se ka një mundësi të madhe që çmimet të vazhdojnë të rriten edhe në muajt në vijim. KOSTT kërkon që ZRrE të përditësojë raportin duke përdorur çmimet aktuale të realizuara për muajt janar dhe shkurt dhe të përshtatë parashikimet për vitin 2025, sipas këtyre të dhënave reale.

Përgjigjja e ZRrE për 4.1.1:

ZRrE ka shqyrtuar komentet e KOSTT lidhur me koston e blerjes së humbjeve në transmetim për vitin 2025 dhe ka marrë parasysh se procesi i bilancit ka kaluar tashmë fazat e konsultimit me këto të dhëna të parashikuara të energjisë. Në përputhje me praktikën e zakonshme dhe procedurat rregullatore, kostoja e blerjes së humbjeve në transmetim për vitin 2025 do të merret parasysh dhe përditësohet gjatë periudhës së përshtatjeve të vitit të ardhshëm relevant tarifor. ZRrE është e angazhuar të sigurojë që këto kosto të përshtaten dhe përditësohen në përputhje me kushtet e tregut dhe ndryshimet që mund të ndodhin në nivelin e çmimeve të energjisë, si dhe me të dhënat më të fundit të disponueshme dhe të garantojnë një balancë të drejtë midis interesave të operatorëve dhe konsumatorëve.

Koment nga OST 4.1.2:

KOSTT përmend se ka vazhduar Marrëveshjen e Kyçjes (MK) me RGCE/ENTSO-E, duke siguruar që të përmbushë të gjitha detyrat teknike dhe financiare që dalin nga ky angazhim. Ky angazhim është kyç për KOSTT-in për të operuar si një Operator i Sistemit të Pavarur dhe për të menaxhuar balancimin e sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare. KOSTT nënvizon rëndësinë e shërbimeve të rezervave ndihmëse, të tilla si aFRR dhe mFRR, të cilat janë të domosdoshme për operimin e sigurt të sistemit. KOSTT kërkon që ZRrE të marrë parasysh nevojat financiare të shërbimeve ndihmëse dhe të bëjë një analizë të kujdesshme për të siguruar që shërbimet e rezervave të mos krijojnë ndonjë barrë të panevojshme për KOSTT dhe të mundësojnë operimin e qëndrueshëm të sistemit.

Përgjigjja e ZRrE për 4.1.2:

Në lidhje me kostot e shërbimeve ndihmëse, ZRrE e vlerëson si të rëndësishëm faktin që KOSTT ka vazhduar Marrëveshjen e Kyçjes me ENTSO-E për sigurimin e shërbimeve të nevojshme për balancimin

e sistemit. ZRrE do të shqyrtojë me kujdes parashikimin e kostove për shërbimet ndihmëse dhe do të sigurojë që ato të jenë të mbështetura nga dokumentacioni përkatës dhe të jenë të përshtatshme për realizimin e detyrave të KOSTT-së në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e ENTSO-E. ZRrE do të miratojë kostot për shërbimet ndihmëse prej 43.12 milion euro dhe do të monitoroj këto kosto se si do të realizohen gjatë kësaj periudhe.

Koment nga OST 4.1.3:

KOSTT shpreh pakënaqësinë me refuzimin e kërkesës për përfshirjen e projekteve të reja në Planin aktual Investiv. KOSTT ka theksuar rëndësinë e këtyre projekteve për zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit të transmetimit, si dhe përkrahjen e ngarkesës dhe sigurinë e furnizimit me energji për konsumatorët. KOSTT është e bindur se këto projekte janë të nevojshme për të përmbushur kërkesat e zhvillimit afatgjatë të sektorit energjetik dhe për të siguruar një furnizim të besueshëm dhe efikas me energji. KOSTT kërkon që ZRrE të shqyrtojë përfshirjen e këtyre projekteve në procesin e shqyrtimit të ardhshëm të radhës për Planin Zhvillimor dhe Investiv Pesëvjeçar dhe të marrë parasysh kërkesën e KOSTT për përfshirjen e shtatë projekteve të reja për realizim në vitin 2027. Këto projekte janë të miratuara nga Planin Zhvillimor Dhjetëvjeçar dhe kanë mbështetje të plotë nga dokumentacioni dhe planet zhvillimore të miratuara. Për të financuar këto projekte, KOSTT është në bisedime me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), e cila ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur projektet me një kredi të butë. KOSTT kërkon që ZRrE të rishqyrtojë refuzimin dhe të miratojë këto projekte të rëndësishme për sektorin e energjisë.

Përgjigjja e ZRrE për 4.1.3:

Në lidhje me kërkesën për përfshirjen e projekteve të reja në Planin Investiv, ZRrE ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT për përfshirjen e këtyre projekteve. Megjithatë, sipas rregullave të ZRrE, projektet kapital të propozuara duhet të shqyrtohen për aprovim nga ZRrE. Në përputhje me Rregullat për Përgatitjen dhe Vlerësimin e Planeve Zhvillimore dhe Investive të Operatorëve të Sistemeve në Sektorin e Energjisë, kërkesa e KOSTT nuk përmbush disa nga kriteret e përcaktuara për vlerësim të qëndrueshëm dhe të arsyetuar ekonomikisht:

1. Mungesa e Analizës së Kostos dhe Përfitimit:
2. Vlerësimi Ekonomik i Projekteve:
3. Përparësitë dhe Prioritetet:

Bazuar në pasqyrat financiare, Bilancin e Gjendjës për vitet 2023-2024 shihet se KOSTT ka para të gatshme të konsiderueshme që nuk janë të përdorura, dhe kërkesa për financim të investimeve mund të jetë e paarsyeshme dhe jo e justifikuar. Kjo është për disa arsye të rëndësishme që lidhen me menaxhimin e financave dhe vlerësimin e risqeve financiare.

ZRrE është e hapur për shqyrtimin e këtyre projekteve në periudhën e shqyrtimit të ardhshëm periodik dhe është e gatshme të marrë parasysh ndikimin e mundshëm që ato mund të kenë për konsumatorët dhe sistemin elektroenergjetik. Kërkesa për financim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është një faktor i rëndësishëm që do të merret parasysh në shqyrtimin e ardhshëm periodik kur do të kemi arsyesheri teknike dhe financiare. ZRrE do të vazhdojë të monitorojë ecurinë e këtyre projekteve dhe do të sigurohet që ato të përfshihen në mënyrë të përshtatshme në planin zhvillimor dhe investiv për vitet e ardhshme.

4.2 Komente nga OSSH

Koment nga OSSH 4.2.1:

Në aplikimin për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për vitin 2025, Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) propozoi rritje të kostove operative, duke theksuar rritjen e numrit të konsumatorëve, nevojën për përmirësim të cilësisë së shërbimeve dhe sfidat në mbajtjen e stafit profesional – duke kërkuar rritje të pagave. OSSH gjithashtu kërkoi nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) që të njohë OPEX-in e realizuar për vitin 2024, duke argumentuar se rritja e vazhdueshme e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve e tejkalon inflacionin dhe se pritshmëritë për paga nuk janë në përputhje me kufizimet rregullative. Kjo rritje nuk ishte e pranuar për vitin 2024 dhe nuk mori parasysh rritjen e pagave, duke e përshtatur OPEX-in vetëm në bazë të inflacionit. ZRRE ruajti nivelin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes nga periodha e mëparshme rregullative (2023–2027) dhe aplikoi një faktor efikasiteti prej 1.5%, duke mos marrë parasysh dëshmitë e OSSH-së për rritjen e kostove dhe presionet operative.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.1:

Faktori i efikasitetit është përcaktuar gjatë shqyrtimeve periodike në vitin 2023 në bazë të raportit konsultativ dhe përgjigjeve ndaj komenteve. Ky faktor reflekton përmirësimin e pritshëm në efikasitet për tërë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes dhe, si i tillë, i ndikon edhe shpenzimet e personelit. Kjo çështje nuk mund të adresohet gjatë Përshtatjeve të Rregullta.

Koment nga OSSH 4.2.2:

OSSH thekson se pagat aktuale mbeten të pamjaftueshme për të përmbushur pritshmëritë e punonjësve dhe për t'u barazuar me kompensimet që ofrohen nga entitetet tjera të licencuara në sektorin e energjisë. Duke marrë parasysh natyrën e rrezikshme të punës së tyre – nga ekspozimi ndaj rrymës elektrike dhe kushteve ekstreme atmosferike, deri te ndërhyrjet emergjente në rast të dëmtimeve në rrjet – punonjësit e KEDS përballen çdo ditë me sfida të mëdha që kërkojnë një rritje urgjente të pagave. Rastet e shumta të lëndimeve serioze dhe fatale dëshmojnë për rrezikun e vazhdueshëm me të cilin përballen për të siguruar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike. Për më tepër, KEDS luan një rol kritik në sigurinë energjetike të vendit, siç u dëshmuua gjatë dimrit të vitit 2024, kur ekipet e saj ndihmuan KOSTT-in në riparimin e dëmeve në infrastrukturë. Ky bashkëpunim, së bashku me rritjen e kërkesave operacionale, ka rritur ndjeshëm kostot e personelit përmes punës jashtë orarit. Në një treg pune gjithnjë e më konkurrues dhe me kosto të jetesës në rritje, ruajtja dhe tërheqja e stafit të kualifikuar është bërë sfidë pa përmirësim të pagave dhe përfitimeve. Prandaj, rritja e pagave nuk është vetëm çështje drejtësie dhe sigurie, por edhe domosdoshmëri strategjike për të ruajtur cilësinë e shërbimeve dhe efikasitetin operacional. Duke marrë parasysh këto realitete dhe rritjet e pagave që kanë ndodhur në ndërmarrjet publike dhe administratën publike në Kosovë, DSO i bën thirrje ZRRE-së që në vlerësimin përfundimtar për të Ardhurat Maksimale të Lejuara për vitin 2025, të marrë parasysh edhe rritjen e pagave për punonjësit e saj, në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë me ekspertët e tjerë të sektorit të energjisë dhe të ruhet një sistem i qëndrueshëm, i sigurt dhe efikas i shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.2:

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes, duke përfshirë edhe koston e personelit, përcaktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe nuk janë subjekt i shqyrtimit gjatë Përshtatjeve të Rregullta. ZRRE pajtohet se norma e inflacionit e aplikuar në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes në OSSH mund

të mos ketë reflektuar me saktësi rritjen e kostos së shpenzimeve të personelit. Kjo tashmë është reflektuar në kostot e FSHU-së gjatë procesit të shqyrtimit të Vlerave Hyrëse. ZRrE fton KEDS të reflektojë këto ndryshime në kosto gjatë procesit të ardhshëm të Shqyrtimit Periodik.

Koment nga OSSH 4.2.3:

Në aplikimin për të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin 2025, OSSH ka përfshirë edhe kostot operative për katër komunat në veri të Kosovës për periudhën prill–dhjetor 2024, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, për të cilën ZRrE ishte e njoftuar. Megjithatë, ZRRE nuk i ka përfshirë këto kosto në raportin konsultativ, edhe pse ato janë reale dhe të mbështetura me marrëveshje. Për më tepër, ZRRE ka propozuar për vitin 2025 një shumë prej vetëm 0.362 milionë eurosh për këto komuna, shumë që është dukshëm më e ulët se kërkesa e paraqitur nga OSSH dhe më e ulët se kostoja e aprovuar për vitin 2024. Duke qenë se viti 2024 ishte viti i parë i operimeve dhe vlerësimi i kostove ishte më i vështirë, ndërsa tani ekziston një pasqyrë më e qartë për aktivitetet dhe shpenzimet në atë zonë, zvogëlimi i kostove nga ana e ZRRE-së për vitin 2025 konsiderohet i pajustificuar. Prandaj, bazuar në sfidat operative dhe argumentet e paraqitura, OSSH kërkon që ZRRE në vlerësimin përfundimtar të MAR për vitin 2025 ta trajtojë këtë zonë si një rajon më vete dhe jo si nënbashki, duke marrë parasysh se mbulon një sipërfaqe të krahasueshme me rajonin e Gjilanit, si dhe të reflektojë vlerën e plotë të kërkuar nga OSSH.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.3:

Sipas Metodologjive të ZRRE-së, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes vendosen gjatë shqyrtimeve periodike dhe nuk ndryshojnë përgjatë periudhës rregullative. Megjithatë, integrimi i sistemit energjetik të katër komunave në veri të Kosovës ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative për të rregullarizuar furnizimin në atë zonë. Megjithatë, shpenzimet e lejuara nga ZRrE janë më të vogla se ato të kërkuara nga Elektroserver dhe KEDS.

Vlerësimi i ZRrE i shpenzimeve të arsyeshme të Elektroserver është bazuar në kostot e realizuara nga KEDS për të ofruar shërbime ekuivalente në një zonë të ngjashme për nga dendësia e popullsisë, numri i konsumatorëve dhe paga mesatare e realizuar.

Koment nga OSSH 4.2.4:

Nënshkrimi i marrëveshjes për furnizimin e katër komunave në veri të Kosovës me furnizuesin Elektroserver në vitin 2023 i ka mundësuar OSSH-së qasje për të operuar në atë zonë, por njëkohësisht paraqet edhe nevojën për investime shtesë nga ana e OSSH-së. Duke e marrë këtë parasysh, OSSH ka parashikuar investime edhe për vitin 2025, siç është përkrahur në aplikimin për MAR. Megjithatë, gjatë procesit, OSSH ka dorëzuar të dhëna shtesë në ZRRE që pasqyrojnë nevojën për investime të mëtejshme, të cilat duhet të njihen në vlerësimin përfundimtar.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.4:

Në pajtim me metodologjinë tarifore, investimet kapitale nuk shqyrtohen gjatë përshtatjeve të rregullta. Megjithatë, KEDS ftohet të dorëzojë në ZRrE informatat për investimet kapitale dhe vlerën të cilën ato shtojnë në ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, në linjë me Rregullën përkatëse për përgaditjen e planeve zhvillimore dhe investive në Kosovë. Ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara do të shqyrtohen gjatë Shqyrtimit të ardhshëm Periodik.

Koment nga OSSH 4.2.5:

KEDS thekson se gjatë shqyrtimit të vlerësimit të ZRRE-së të paraqitur në Raportin Konsultativ, është vërejtur se nuk është marrë parasysh niveli i plotë i energjisë së pritur të hyjë në nivelin e OSSH-së, gjë që nuk është në përputhje me metodologjinë e aprovuar në Bilancin e Energjisë dhe Rregullën për Çmimet e OSSH-së. Parashikimi më i ulët i energjisë hyrëse nënkupton subvencionim të një pjese të kostove nga OSSH në vitin përkatës dhe për rrjedhojë rregullime më të larta në vitin pasues, duke krijuar vështirësi financiare. OSSH do të llogarisë gjithë energjinë hyrëse sipas metodologjisë së miratuar në Bilancin e Energjisë. Gjithashtu, ZRRE nuk ka reflektuar humbjet e pritura për vitin 2025 në pjesën veriore të vendit dhe ka aplikuar një cak prej 3% pikë përqindjeje, gjë që për OSSH-në është e papranueshme, pasi operimi në këtë zonë ka nisur vetëm vitin e kaluar dhe ende jemi në fazën fillestare të identifikimit të investimeve, strukturës së rrjetit dhe sfidave operacionale. Përcaktimi i objektivave duhet të bëhet përmes një procesi transparent dhe të mirë-analizuar, përfshirë edhe cakun për humbje. Në vendimin V_1636_2022, ZRRE kishte përcaktuar se caku për zvogëlimin e humbjeve nuk vlen për sasinë e energjisë së pafaturuar në katër komunitat veriore. Duke marrë parasysh se kjo zonë nuk është përfshirë në objektivat e miratuara për zvogëlim të humbjeve dhe se ende nuk është hapur një proces rishikimi për këto parametra, OSSH kërkon që edhe për vitin 2025, kostoja e lejuar për humbje të reflektojë humbjet e përgjithshme të parashikuara në pjesën veriore të vendit.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.5:

Caku i humbjeve të operatorëve të rregulluar duhet të reflektojë stimuj për reduktim të humbjeve në mënyrë që konsumatorët të paguajnë vetëm atë nivel të humbjeve që konsiderohet i arsyeshëm duke marrë parasysh rrethanat specifike të operatorëve të caktuar. Përcaktimi i nivelit të humbjeve në nivelin e lejuar paraqet cak të arritshëm për përmirësim të shërbimit ndaj konsumatorëve. Një qasje e tillë është në përputhje të plotë me praktikën e mëparshme të ZRrE-së, ku humbjet e lejuara janë përcaktuar në nivele më të ulëta se ato të realizuara, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës.

Koment nga OSSH 4.2.6:

OSSH ka kërkuar ndryshimin e faktorit ndarës për të hyrat nga shërbimet e tjera, të klasifikuara si të hyra të parregulluara, për të cilat OSSH propozon një faktor ndarës prej 50%. Ndryshe nga ZRRE që ka propozuar zbritjen e plotë prej 5.41 milionë euro, OSSH sugjeron zbritje vetëm për gjysmën, përkatësisht 2.70 milionë euro. Kjo qasje ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit dhe inkurajon krijimin e të ardhurave shtesë. Zbritja e plotë, sipas OSSH-së, dekurajon diversifikimin e shërbimeve jo-tarifore. Zbatimi i faktorëve ndarës do të ndikonte pozitivisht në likuiditetin e OSSH-së dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit. Kjo do të mundësonte përmirësim të shërbimeve për konsumatorët dhe investime më të mëdha në infrastrukturë. Në këtë kontekst, OSSH i bën thirrje ZRRE-së që të shqyrtojë me objektivitet propozimin për aplikimin e faktorëve ndarës prej 50%, për të siguruar zhvillim afatgjatë dhe stabilitet në sektorin energjetik.

Përgjigjja e ZRrE për 4.2.6:

ZRrE rithekson se politika e saj për faktorin ndarës për shërbimet shtesë nuk ka ndryshuar dhe se të hyrat e parregulluara nga aktivitete të përkrahura nga kosto dhe asete të rregulluara duhen kthyer konsumatorëve.

4.3 Komente nga Elektroserver

Elektroserver ka theksuar se komentet e tyre janë dorëzuar për shkak se ndikimi i tarifave të shpërndarjes dhe transmisionit të energjisë elektrike ndikojnë direkt në tarifat e aplikuar nga kjo ndërmarrje.

Koment nga Elektroserver 4.4.1:

Në Raportin Konsultativ (faqe 7) thuhet se ZRrE ka analizuar në detaje të gjitha kostot që lidhen me ofrimin e shërbimeve për katër komunat në veri në krahasim me kostot e shërbimeve të ngjashme në zonat e mbuluara nga OSSH, dhe në përputhje me këtë janë aprovuar 362,000 € për shërbime që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit dhe lidhjet e reja, si dhe 573,000 € për shërbime të tjera brenda kuadrit të OSSH-së – që në total arrin shumën prej 935,000 €. Kjo nënkupton që kompensimi për shërbimet shpërndarëse të ofruara nga Elektroserver është parashikuar në vlerë vjetore prej 362,000 €, përkatësisht 30,166.66 € në muaj. Në Raport nuk është paraqitur arsyeja përse kompensimi për shërbimet shpërndarëse, i cili në periudhën e mëparshme tarifore ka qenë 41,666.67 € në muaj, është ulur për më shumë se 10,000 €.

Kjo është veçanërisht e paqartë duke pasur parasysh që shoqërisë “Elektroserver”, gjatë takimit të mbajtur më 11.07.2024, i është komunikuar se kompensimi për vitin 2024 është zvogëluar për shkak se në kohën e vendimmarrjes Elektroserver nuk kishte të punësuar, dhe se ZRrE nuk kishte të dhëna mbi shkallën e aktiviteteve dhe punëve që po realizoheshin nga Elektroserver. Për këtë arsye, për qëllimet e përgatitjes së Raportit Konsultativ, i kemi dorëzuar KEDS-it të dhënat mbi shpenzimet operative në lidhje me ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes gjatë vitit 2024, të cilat KEDS i ka shqyrtuar dhe i ka përcjellë tek rregullatori për vendimmarrje.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.1

Sipas Metodologjive të ZRrE-së, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes vendosen gjatë shqyrtimeve periodike dhe nuk ndryshojnë përgjatë periudhës rregullative. Megjithatë, integrimi i sistemit energjetik të katër komunave në veri të Kosovës ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative për të rregullarizuar furnizimin në atë zonë. Megjithatë, shpenzimet e lejuara nga ZRrE janë më të vogla se ato të kërkuara nga Elektroserver dhe KEDS.

Vlerësimi i ZRrE i shpenzimeve të arsyeshme të Elektroserver është bazuar në kostot e realizuara nga KEDS për të ofruar shërbime ekuivalente në një zonë të ngjashme për nga dendësia e popullsisë, numri i konsumatorëve dhe paga mesatare e realizuar.

Koment nga Elektroserver 4.4.2:

Kostot e Elektroserver-it, që lidhen me ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes, kanë arritur në rreth 2.7 milionë euro gjatë vitit 2024, dhe përfshijnë, përveç kostove për pagat e 135 të punësuarve (2,106,000 €), edhe shpenzime për blerjen e materialeve, veglave dhe pajisjeve mbrojtëse (103,000 €), shpenzime për automjetet (76,016 € për karburant dhe 29,617 € për mirëmbajtje), si dhe shpenzime për pajisjen e punëtorëve me licenca të nevojshme, kontrolle shëndetësore etj. (Shtojcë: Struktura e të punësuarve që kryejnë punë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes).

Megjithatë, janë aprovuar mjete që nuk përfaqësojnë as 15% të kostove reale, të cilat gjatë vitit 2025 pritet të jenë edhe më të larta për shkak të inflacionit dhe rritjes së çmimeve në treg.

Në Raport nuk tregohet se me cilën pjesë të konsumit është bërë krahasimi në zonën ku Elektroserver ofron shërbimet e veta, e as se sa të punësuar janë pranuar nga ZRrE. Megjithatë, duke pasur parasysh mjetet e propozuara, mendojmë se, gjatë vlerësimit të kostove të ofrimit të shërbimeve të shpërndarjes, nuk janë marrë parasysh rrethanat specifike të punës në katër komunat në veri, dhe veçanërisht fakti se Elektroserver njëkohësisht kryen aktivitete të ndryshme, që përfshijnë instalimin/zëvendësimin e matësve elektrikë, mirëmbajtjen e rrjetit (riparime), leximin e matësve që realizohet çdo muaj dhe zgjat 8 ditë, lidhje të reja, si dhe ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët që nuk i përmbushin obligimet e tyre financiare, e të tjera.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.2:

Procesi i përshtatjeve të rregullta nuk parasheh shqyrtim të shpenzimeve të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes. Këto përcaktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe mbesin të njëjta përgjatë periudhës rregullative (2023-2027). Vlerësimi i kostove të Elektroserver-it është bërë në bazë të kostove të krahasueshme të shërbimeve të ngjashme të ofruara nga KEDS. Rregullatori nuk mund të pranojë shpenzime në bazë të kostove të realizuara por në bazë të kostove të arsyeshme të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga ZRrE.

Koment nga Elektroserver 4.4.2:

Në Kapitullin 1, pika 2, tabela 3 (investimet e OSSH-së në katër komunat në veri), në faqen 8 të Raportit, thuhet se në territorin e katër komunave në veri të Kosovës gjatë vitit 2024 janë realizuar investime në shumën totale prej 3.45 milionë euro. Megjithatë, investimet që realisht janë zbatuar nuk korrespondojnë me këtë vlerë të deklaruar, përkatësisht kanë qenë të papërfillshme.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.2:

ZRrE thekson se ndryshimet në mes të vlerave të propozuara dhe atyre të realizuara të investimeve kapitale përshtaten gjatë shqyrtimeve periodike. ZRrE fton Elektroserverin të përditësojë rregullatorin me rastin e bashkërenditjes së vlerave të investimeve në RAB me rastin e adresimit të ndryshimeve në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara. Përsërisim, kjo është pjesë e Shqyrtimeve Periodike dhe jo e procesit të Përshtatjeve të Rregullta (shih Kapitullin 2 të dokumentit për Përgjigjet ndaj Komenteve për dallimet në mes të shqyrtimeve periodike dhe përshtatjeve të rregullta).

Koment nga Elektroserver 4.4.3:

Lidhur me humbjet e energjisë, në Raportin Konsultativ (faqet 9 dhe 10) thuhet se, në aplikimin fillestar, OSSH ka propozuar një vlerë prej 49.50 GWh për humbjet e energjisë në komunat në veri, ndërsa pas shqyrtimit të të dhënave dhe analizës, ka përditësuar të dhënat duke rritur vlerën e humbjeve në 80.25 GWh (38% në raport me humbjet totale). Megjithatë, propozimi përfundimtar i rregullatorit për humbjet e aprovuara është 61.67 GWh. Humbjet e energjisë elektrike në katër komunat në veri, në raport me humbjet totale të OSSH-së gjatë vitit 2024, kanë qenë 24.50%, ndërsa ZRrE propozon që këto humbje të ulen në 21.5% gjatë vitit 2025, përmes investimeve të lejuara.

Elektroserver konsideron se humbjet e propozuara nga KEDS, prej 80.25 GWh, përfaqësojnë një objektiv realist, duke marrë parasysh që aktualisht janë në zhvillim aktivitetet për zëvendësimin e matësve, të cilat pritet të sjellin në uljen e humbjeve. Po ashtu, meqenëse gjatë vitit 2024 nuk janë realizuar investime të rëndësishme nga ana e KEDS-it, nuk janë krijuar as kushtet për një ulje domethënëse të humbjeve gjatë vitit 2025.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.3:

Caku i humbjeve të operatorëve të rregulluar duhet të reflektojë stimuj për reduktim të humbjeve në mënyrë që konsumatorët të paguajnë vetëm atë nivel të humbjeve që konsiderohet i arsyeshëm duke marrë parasysh rrethanat specifike të operatorëve të caktuar. Përcaktimi i nivelit të humbjeve në nivelin e lejuar paraqet cak të arritshëm për përmirësim të shërbimit ndaj konsumatorëve. Një qasje e tillë është në përputhje të plotë me praktikën e mëparshme të ZRrE-së, ku humbjet e lejuara janë përcaktuar në nivele më të ulëta se ato të realizuara, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës.

Koment nga Elektroserver 4.4.4:

Lidhur me bilancin e energjisë, nga tabela nr. 5, faqja 9 e Raportit, në pjesën që i referohet realizimit për vitin 2024, nuk është e qartë nëse është marrë parasysh e gjithë sasia e energjisë elektrike që është importuar nga Elektroserver, për të cilën është paguar tarifa për rrjet ndaj KOSTT-it, përkatësisht KEDS-it, si dhe taksa për import ndaj rregullatorit.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.3:

ZRrE konfirmon se këtu është marrë parasysh e gjithë sasia e energjisë elektrike në nivel vendi.

4.4 Komente nga FSHU

Koment nga FSHU 4.4.1:

ZRRE, me vendimin nr. V_2637_2025, ka miratuar OPEX-in për vitin 2025 në vlerë prej 6.7 milionë euro, duke aplikuar një faktor efikasiteti prej 0.75%, ndërkohë që FSHU kishte propozuar rritje të kostove operative për periudhën 2025–2027 për të reflektuar realitetin ekonomik, inflacionin, ndryshimet ligjore dhe të tregut. Megjithëse u miratua një rritje e pjesshme, ajo konsiderohet e pamjaftueshme për të mbuluar kostot reale të operatorit. ZRRE nuk ka marrë parasysh OPEX-in e realizuar për vitin 2024 dhe ka injoruar kostot shtesë jashtë kontrollit të FSHU-së, si rritja e pagës minimale, kostot më të larta bankare dhe çmimet e rritura për shërbime teknike. Kjo qasje, e aplikuar pa analizë të detajuar dhe në mënyrë të njëanshme, jo vetëm që cenon cilësinë e shërbimeve dhe krijon vështirësi operationale, por gjithashtu bie ndesh me parimin e trajtimit të drejtë dhe proporcional rregullator, duke rrezikuar funksionimin e qëndrueshëm të FSHU-së si ofrues i shërbimit universal.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.1:

ZRrE ka parasyshë kërkesën e FSHU për Shpenzimet e Operative dhe të Mirëmbajtjes. Njëkohësisht ZRrE thekson se të njëjtat janë trajtuar gjatë Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse për FSHU-në nuk përcaktohen gjatë kësaj Përshtatjeje Tarifore.

Koment nga FSHU 4.4.2:

FSHU, në aplikimin për Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2025, ka kërkuar investime kapitale në vlerë prej 8.39 milionë euro për periudhën 2025–2027, të cilat konsiderohen thelbësore për përmirësimin e shërbimeve, rritjen e efikasitetit operativ dhe përmbushjen e standardeve moderne. Megjithatë, ZRRE nuk i ka përfshirë këto investime në vlerësimin e saj për shkak të mungesës së analizës për ndikimin e procesit të derregullimit. FSHU ka theksuar nevojën urgjente për përditësimin e sistemit të vjetëruar të faturimit, i cili nuk mbështet integrimin me sisteme moderne si SAP-i dhe nuk ofron fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me kërkesat e tregut dhe reformat në sektor. Sipas FSHU-së, modernizimi i këtij sistemi do të përmirësonte ndërvëprimin me konsumatorët, do të rriste

transparencën dhe do të siguronte shërbime të pandërprera, veçanërisht në kontekstin e reformave të pritshme. Investimet përfshijnë edhe pajisje teknike dhe kompjuterike të domosdoshme për funksionimin e pandërprerë të sistemit dhe përmbushjen e detyrimeve të licencës.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.2:

ZRRE vlerëson përkushtimin e FSHU-së për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve por pa analizë të kostos së njësisë dhe vlerësim të detajuar të shpenzimeve ZRrE nuk e konsideron të arsyeshme përfshirjen e tyre në vlerësimin përfundimtar të të Hyrave të Lejuara Maksimale për këtë periudhë. Kjo bazohet në mungesën e analizave të detajuara dhe objektive që dëshmojnë ndikimin e këtyre investimeve në përmirësimin e drejtpërdrejtë të shërbimit për konsumatorët, si dhe në mungesën e një vlerësimi të qartë të përfitimeve të konsumatorëve.

Koment nga FSHU 4.4.3:

Gjatë vitit 2024 dhe fillimit të vitit 2025, Furnizuesi është përballur me sfida të mëdha operationale dhe financiare si pasojë e kufizimeve në tregun e përbashkët Shqipëri-Kosovë, mungesës së likuiditetit në bursën ALPEX dhe veprimeve të vonuara nga KOSTT që kanë penguar tregtimin efektiv të energjisë. Këto kufizime kanë sjellë rritje të kostove operative dhe kanë kufizuar fleksibilitetin tregtar të KESCO, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë për të siguruar furnizim të pandërprerë. Për më tepër, çmimet e larta të kapaciteteve ndërkufitare, që arritën në 30 €/MWnë 2024, kanë shkaktuar një barrë financiare të konsiderueshme për KESCO, në kontrast me vitin 2023 kur çmimi mesatar ishte vetëm 5 €/MW. Në përpjekje për të përmbushur kërkesat e tregut, Furnizuesi ka importuar 168 GWh energji elektrike me një kosto totale prej 47.8 milionë euro, nga të cilat 35.6 milionë janë realizuar vetëm në muajt e fundit të vitit, duke rezultuar në një tejkalim prej 39.51 milionë euro ndaj kostove të lejuara. Kostoja e jobalanceve duhet të njihet në të hyrat maksimale të FSHU-së.

Përgjigjja e ZRrE për 4.4.3:

ZRrE është në proces të vlerësimit të jobalanceve të FSHU-së. Vendimi final për mbulimin e këtyre kostove do të merret pas përfundimit të vlerësimit të detajuar të ZRrE.

5 Komentet nga bizneset dhe shoqatat e bizneseve

Gjatë procesit të konsultimit publik ZRrE ka pranuar komente nga biznese në lidhje me procesin përshtatjeve të rregullta të tarifave. Komentet nga Bizneset gjithashtu i adresohen edhe procesit të liberalizimit të tregut me pakicë, proces i cili është i ndarë nga procesi i rishikimit të tariave.

5.1 Komente nga Project Office – Gjakova

Koment nga Project Office – Gjakova 5.1:

Si qytetar dhe konsumator i KEDS'it, dëshiroj të shpreh shqetësimin tim të thellë në lidhje me mundësinë e ngritjes së çmimit të energjisë elektrike.

Besoj jeni të vetëdijshëm që çdo ngritje e çmimi të energjisë do të ketë efekt zinxhirë, ngritje të çmimeve në çdo lëmi tjetër, duke e bërë jetën e qytetarëve të rëndomtë të papërballueshme.

Duhet të keni parasysh, që edhe pse çmimi i energjisë është veç i lartë, tensioni i rrymës asnjëherë nuk arrin nivel e paraparë, d.m.th ne paguajmë por pajisjet elektrike nuk mund të funksionojnë siç janë të parapara.

Një gjë tjetër shqetësues të cilën duhet ta rishikoni, është e ashtuquajtura “bllok tarif”, d.m.th, tejkalimi i 800 kW, ku çmimi dyfishohet.

Është absurde që të ndëshkohesh për konsumim ose shpenzim të një produkti. Është e drejtë e konsumatorit të shpenzojë aq sa ka nevojë, e jo t’i imponohen kufizime ndëshkuese.

I pakuptimtë mbetet edhe fakti, që në njërën anë qeveria subvencionon pajisje elektrike eficiente, në anën tjetër operatorë elektrike të ndëshkojnë për konsumim të energjisë.

Përgjigjja e ZRrE për 5.1:

ZRrE thekson se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve ekonomike dhe sociale përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084. Neni 45 pika 1, e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, obligon ZRRE që të vendos tarifa që reflektojnë plotësisht koston e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorin fundor nga ndërmarrja përkatëse e energjisë.

Implementimi i bllok tarifave është bërë me synim që të promovohet eficiency e energjisë, dhe të bëhet alokim i drejtë për të gjithë qytetarët i energjisë së prodhuar nga KEK, si dhe të reflektohen çmimet e importit tek konsumatorët që shpenzojnë më shumë se sasia e alokuar e kapaciteve vendore.

5.2 Komente nga Lidhja e Bizneseve të Kosovës

Koment nga Lidhja e Bizneseve të Kosovës 5.2:

Lidhja e Bizneseve të Kosovës, si përfaqësuese e komunitetit të biznesit vendor, shpreh shqetësimin e thellë dhe kundërshtimin e vendosur ndaj paralajmërimit të fundit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për rritjen e tarifave të energjisë elektrike në nivel prej 15%. Ky propozim është i papranueshëm dhe ekonomikisht i dëmshëm, duke marrë parasysh gjendjen e rënduar ekonomike të vendit dhe ndikimin që do të ketë mbi bizneset, prodhimin vendor dhe mirëqenien e qytetarëve.

Rritja e çmimit të energjisë elektrike, në këtë periudhë të ndjeshme për ekonominë e Kosovës, përbën barrë shtesë për sektorin privat dhe për të gjithë konsumatorët. Ky vendim pritet të ketë pasoja të drejtpërdrejta në rritjen e kostove të jetesës, uljen e fuqisë blerëse të qytetarëve dhe tkurrjen e aktivitetit ekonomik vendor.

Sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për periudhën shkurt 2025 krahasuar me shkurt 2024:

- Eksportet kanë pësuar rënie prej -8.9%.
- Importet kanë shënuar rritje prej +12.7%.

Ky disbalancë tregon qartë përkeqësimin e bilancit tregtar dhe dobësimin e sektorit të prodhimit vendor, i cili tashmë përballlet me sfida të shumta si mungesa e përkrahjes, kostoja e lartë e lëndës së parë dhe fuqisë punëtore, dhe tani edhe me rritje të çmimit të energjisë.

Rritja e tarifave të energjisë elektrike pritet të ndikojë negativisht në:

- Rritjen e koston së prodhimit për bizneset vendore;
- Uljen e konkurrueshmërisë së produkteve tona në tregun vendor dhe ndërkombëtar;

- Rritjen e çmimeve për konsumatorët fundorë;
- Zvogëlimin e investimeve të reja dhe largimin e investitorëve potencialë;
- Rritjen e papunësisë si rezultat i vështirësive në sektorin privat.

Për më tepër, ky vendim do të ndikojë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve, të cilët tashmë po përballen me kosto të lartë jetese dhe rritje të vazhdueshme të çmimeve në sektorët esencialë.

LBK kërkon me ngulm nga ZRrE që:

1. Të tërheqë menjëherë këtë propozim për rritje të tarifave.
2. Të zhvillojë konsultime të hapura dhe gjithëpërfshirëse me komunitetin e biznesit dhe palët e interesuara për të identifikuar zgjidhje që nuk dëmtojnë ekonominë vendore.
3. Të ketë parasysh ndikimin ekonomik dhe social që ky vendim do të ketë mbi sektorin privat, konsumatorët dhe ekonominë e përgjithshme të vendit.

Kosova ka nevojë për politika që nxisin zhvillimin ekonomik, fuqizojnë prodhimin vendor dhe mbrojnë mirëqenien e qytetarëve, e jo për masa që rëndojnë më tej situatën ekonomike.

Përgjigjja e ZRrE për 5.2:

Propozimi për përshtatjen e të hyrave të lejuara bazohet në analizat e shpenzimeve kapitale dhe operative, koston së kapitalit, normave të zhvlerësimit dhe përmirësimit të efikasitetit gjatë shqyrtimeve periodike. Neni 48, paragrafi 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, obligon ZRrE që gjatë caktimit të tarifave të të sigurojë që të licencuarve t’iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme.

ZRrE nuk mund të përcaktojë tarifatat duke u bazuar në të ardhura individuale apo struktura sociale. ZRrE nuk ka mandat për të përcaktuar politika ekonomike, fiskale, sociale apo subvencione.

ZRrE ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Raportet konsultative me argumente mbështetëse janë publikuar nga ZRrE si dhe janë ftuar të gjitha palët për të dhënë komentet e tyre. ZRrE ka pranuar mbi 400 komente nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sindikatat, bizneset, institucionet vendore dhe deputetët dhe nga të licensuarit. ZRrE e vlerëson lartë kontributin e të gjithë komentuesve në proces dhe të gjitha komentet e dërguara janë shqyrtuar në detaje si dhe janë përfshirë në vendimmarrjen përfundimtare. Rregullatori gjithashtu ka mbajtur takime bilaterale me organizatat e shoqërisë civile, mediat, Avokatin e Popullit, institucionet vendore, dhe të licensuarit. Komentet gjatë këtyre diskutimeve janë marrë parasysh gjatë hartimit të këtij raporti.

5.3 Komente nga Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës

Koment nga Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës 5.3:

Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës ka ngritur shqetësimin e saj të arsyeshëm lidhur me rritjen e paralajmëruar të çmimit të energjisë elektrike, duke kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme të Qeverisë së Kosovës për ta ndalur këtë proces. Rritja e koston së energjisë paraqet një kërcënim serioz për sektorin e prodhimit të qumështit, i cili është ndër sektorët më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm të ekonomisë agrare në vend.

Prodhimi i qumështit përfshin një zinxhir kompleks procesesh, nga grumbullimi, ruajtja, pasterizimi, përpunimi deri te paketimi – të gjitha këto varen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga energjia elektrike. Një shtrenjtim i saj do të çojë në rritje të menjëhershme të kostove të prodhimit, duke ulur përfitueshmërinë e bizneseve vendore dhe duke rrezikuar mbylljen e shumë kapaciteteve të vogla dhe të mesme.

Për më tepër, një kosto më e lartë e prodhimit përkthehet në çmime më të larta për konsumatorin final, duke e rënduar barrën ekonomike për qytetarët dhe duke ndikuar negativisht në inflacionin e brendshëm. Në këtë kontekst, ndërhyrja e Qeverisë konsiderohet e domosdoshme për të mbrojtur prodhimin vendor, për të ruajtur stabilitetin ekonomik dhe për të siguruar që tregu të mos mbushet me produkte të importuara që sfidojnë konkurrencën e drejtë.

Në një kohë kur Kosova synon të forcojë kapacitetet e saj prodhuese dhe të zhvillojë sektorin bujqësor si shtyllë të ekonomisë, ruajtja e stabilitetit të kostove operative për prodhuesit lokalë është më e rëndësishme se kurrë.

Përgjigjja e ZRrE për 5.3:

Propozimi për përshtatjen e të hyrave të lejuara bazohet në analizat e shpenzimeve kapitale dhe operative, koston së kapitalit, normave të zhvlerësimit dhe përmirësimit të efikasitetit gjatë shqyrtimeve periodike. Neni 48 paragrafi 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, obligon ZRrE që gjatë caktimit të tarifave të të sigurojë që të licencuarve t’iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme. Për më tepër neni 47 paragrafi 3, nënparagrafi 3.5 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nuk lejon ZRrE të përcaktoj tarifa nën koston reale të ofrimit të shërbimit, përfshirë edhe një normë të arsyeshme të fitimit;

ZRrE nuk ka mandat për të përcaktuar politika ekonomike, fiskale, sociale apo subvencione.

5.4 Komente nga ITBrooklyn Technology

Koment nga ITBrooklyn Technology 5.4.1:

ITBrooklyn, një kompani në fushën e energjisë dhe teknologjisë, shpreh kundërshtimin ndaj rritjes së propozuar të çmimit të energjisë në Kosovë, duke theksuar ndikimet negative që kjo do të ketë në ekonominë, stabilitetin social dhe konkurrueshmërinë rajonale. Kompania kritikon mungesën e transparencës dhe rastet e humbura në strategjinë energjetike të vendit, duke theksuar përjashtimin e saj nga diskutimet kyçe, pavarësisht historikut të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe gatishmërisë për investime. ITBrooklyn propozon një blerje strategjike të KEDS-it me një ngrirje të çmimeve për 12 vjet dhe bën thirrje për anulimin e privatizimit të Shpërndarjes. Gjithashtu, shpreh shqetësime për praktika të anashkalimeve për kompanitë amerikane në sektorin energjetik të Kosovës, duke kërkuar një angazhim më të drejtë dhe bashkëpunues për një të ardhme të qëndrueshme energjetike në vend.

Përgjigjja e ZRrE për 5.4.1:

Shkresa adreson shumë çështje që nuk janë kompetencë e ZRrE-së. Sa i përket ndikimit social të tarifave, ZRrE thekson se vlerësimi i drejtpërdrejtë i ndikimeve sociale dhe mbrojtja e shtresave në nevojë përmes tarifave nuk janë brenda mandatit të saj sipas Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, veçanërisht në përputhje me nenin 15 dhe nenin 45, të cilat përcaktojnë kompetencat e ZRrE-së në përcaktimin e tarifave bazuar në kosto të arsyeshme dhe jo në kriterin e gjendjes sociale të konsumatorëve. Vendimmarrja për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) bazohet në

një analizë të detajuar të kostove të arsyeshme të operimit të operatorëve të licencuar. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm përmes përkrahjes financiare, neni 50 i ligjit për rregullatorin, këto kompetenca ia bartë Qeverisë.

6 Komentet nga mediat

Koment nga Mediat 6.1:

Në takimin me mediat më 7 prill, një nga gazetarët prezent në takim ka kërkuar sqarime shtesë për koston e kapaciteteve ndërkufitare dhe ndikimin që këto mund të kenë në koston e importit. Gjatë takimit, ZRrE është pajtuar që të ofrojë sqarime shtesë për koston e kapaciteteve ndërkufitare.


Përgjigjja e ZRrE për 6.1:

Para çdo viti tarifor, ZRrE bën llogaritjen e koston së blerjes së energjisë me shumicë, duke marrë parasysh vëllimet e parashikuara të energjisë së ofruar nga KEK, BRE dhe energjisë së importuar. Krahas këtyre vëllimeve, kjo llogaritje parasheh edhe çmimet e energjisë nga burimet respektive, duke përfshirë edhe energjinë e importit. Kostoja e parashikuar e importit, si mesatare e ponderuar, për vitin 2024 ishte 97.79 EUR/MWh.

Në fund të çdo viti tarifor, ZRrE bën bashkërenditjen e koston së blerjes së energjisë për vitin e kaluar tarifor. Këto llogaritje përfshijnë ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të vëllimeve të energjisë nga burimet e furnizimit dhe çmimet e shitjes së energjisë. Në rastin e çmimeve, energjia e KEK dhe BRE furnizohet me kontrata afatgjata çmimet e të cilave nuk ndryshojnë brenda vitit. Në rastin e koston së importit, çmimi i realizuar i blerjes së energjisë, që përfshinë importin e energjisë dhe kapacitetet transmetuese, ishte 181.34 EUR/MWh.

Ndryshimi në mes të koston së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë për FSHU në vitin e kaluar është €47.37 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifatat e ardhshme të energjisë elektrike.

Figura: Ndryshimet në mes të koston së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (FSHU)




Në rastin e OSSH, kostoja e blerjes së energjisë ndikohet më ndjeshëm nga çmimet e importit ngaqë energjia në rrjet mund të blihet nga prodhimet vendore vetëm atëherë kur mbulohet tërësisht kërkesa

për konsumatorët e shërbimit universal. Në rastet kur kërkesa e energjisë elektrike i tejkalon parashikimet, siç ka ndodhur për shembull në dhjetor të 2024, OSSH duhet të importojë më shumë energji elektrike ngaqë kapacitetet e KEK ngarkohen me furnizimin e shërbimit universal.


Kostoja e parashikuar e blerjes së energjisë nga OSSH ishte 96.13 EUR/MWh ndërsa ajo e realizuar ishte 147.15 EUR/MWh. Në kombinim me ndryshimet në vëllimin e energjisë së importuar, ky dallim në çmim ka rezultuar në rritje të kostos së blerjes së energjisë nga OSSH në vlerë prej €37.84 milionë. Ky ndryshim duhet të mbulohet në tarifat e ardhshme të energjisë elektrike. Një përmbledhje e kostos së blerjes së energjisë së OSSH është dhënë në tabelën në vijim.

Figura: Ndryshimet në mes të kostos së parashikuar dhe të realizuar të blerjes së energjisë (OSSH)



Kostoja e parashikuar e blerjes së energjisë poashtu u ndikua nga rritja e kostos së çmimeve të kapaciteteve ndërkufitare në Kosovë të cilët shënuan një rritje të ndjeshme në vitin 2024 krahasuar me vitin paraprak.

Figura: Çmimet e kapaciteteve ndërkufitare të realizuara në Kosovë (2022, 2023, 2024)



Kostot e kapaciteteve ndërkufitare në vitin 2024 për OSSH ishte €13.67 milionë (nga totali i kostove të importit prej €83.06 milionë). Për FSHU kostoja e kapaciteteve ndërkufitare ishte €9.06 milionë totali i kostove të importit prej €68.97 milionë.

7 Komentet në lidhje me procesin e liberalizimit të energjisë në Kosovë

Gjatë procesit të konsultimit publik për shqyrtimin e rregullt të të hyrave të lejuara për OST, OSSH dhe FSHU, ZRrE ka pranuar komente nga Oda Ekonomike e Kosovës, dhe disa biznese e qytetarë në lidhje me procesin e liberalizimit të tregut me pakicë. Procesi i liberalizimit të tregut është proces i ndarë nga ky konsultim publik.